



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 72 regjistër (JR)
Datë 23.11.2021

Nr. 13 i vendimit
Datë 05.04.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|------------------------|------------------|
| Ina Rama | Kryesuese |
| Natasha Mulaj | Relatore |
| Albana Shtylla | Anëtare |
| Rezarta Schuetz | Anëtare |
| Sokol Çomo | Anëtar |

– shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 05.04.2024, ditën e premte, në orën 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 72/2021 (JR), datë 23.11.2021, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Lënia në fuqi ose ndryshimi i vendimit nr. 442, datë 14.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik, të paraqitura në ankim, në parashtrime, si dhe me bisedimet përfundimtare, i cili kërkoi: *1. Ndryshimin e vendimit nr. 442,*

datë 14.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka. 2. Pezullimin e tij nga detyra për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, dhe transferimin e çështjeve penale që i përkasin përkatësisht, procedimit penal nr. {***}, datë 16.07.2018 dhe nr. {***}, datë 1.10.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në organin kompetent, shqyrtoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1 ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. 183/27 prot., datë 26.06.2019, në të cilin ka konstatuar se: *i. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë; iv. nuk ka kryer deklarim të rremë; v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 01.12.2020, deklasifikuar pjesërisht, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit Juljan Çafka, nga *përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.*

2.3 KLP-ja, bazuar në analizimin e tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave të formularit sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 442, datë 14.09.2021, lidhur me të tria kriteret e rivlerësimit, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka:
 - Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
 - Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se për subjektin e rivlerësimit Juljan Çafka nuk u arrit të provohet papërshtatshmëria për vijimin e ushtrimit të detyrës dhe, për rrjedhojë, subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
 - Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i çështjeve të hetuara nga subjekti është i pamjaftueshëm për të arritur në vlerësimin e tij, sipas germave “b” dhe “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues, sipas neneve 44/a dhe 59/c të ligjit nr. 84/2016.
4. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni, me vendimin nr. 442, datë 14.09.2021, vendosi: 1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. 2. Transferimin e çështjeve penale që i përkasin përkatësisht, procedimit penal nr. {***}, datë 16.07.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pezulluar me vendimin e kësaj prokurorie në datën 7.8.2020, dhe procedimit penal nr. {***}, datë 01.10.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për të cilin është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal”, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore”, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

III. Ankimi i Komisionerit Publik dhe shkaqet e ankimit për hetim të mëtejshëm

5. Më datë 11.11.2021¹, Komisioneri Publik Florjan Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”) ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 442, datë 14.09.2021, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Juljan Çafka.
6. Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën kushtetuese dhe ligjore, ka kërkuar nga Kolegji që të riçelë hetimin gjyqësor për hetimin e disa prej çështjeve penale të adresuara në denoncimin e paraqitur pranë tij pas shpalljes së vendimit të Komisionit, nga shtetasi A. Ll., administrator i studios ligjore “{***}”, që i përkasin: (i) procedimit penal me nr. {***}, datë 05.06.2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; (ii) ekzekutimit të

¹ Ankimi i Komisionerit Publik është regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 11.11.2021.

dy vendimeve penale në ngarkim të shtetasit K. K., përkatësisht, vendimit nr. {***}, datë 26.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 07.03.2018, të Gjykatës së Apelit Gjyqësor dhe vendimit penal nr. {***}, datë 19.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; (iii) procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasit K. K.; (iv) procedimit penal për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve E., F. dhe S. L.. Shkaqet e ankimit për hetim të mëtejshëm lidhur me këto çështje penale të parashtruara në ankim, paraqiten si vijojnë.

6.1 Në lidhje me procedimin penal me nr. {***}, datë 5.6.2017, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, nevojitet hetim i mëtejshëm lidhur me: (i) shkaqet që kanë sjellë kohëzgjatjen e hetimit nga momenti i regjistrimit të procedimit penal nr. {***}, datë 05.06.2017 deri në paraqitjen e kërkesës për pushimin e procedimit penal datë 23.11.2020, referuar nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) subjektet të cilave u atribuohet vepra penale, regjistrimi i tyre referuar nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe zbatimi eventual i dispozitës së nenit 75/a, lidhur me nenin 80 të Kodit të Procedurës Penale, në përcaktimin e kompetencës lëndore në hetimin e procedimit penal, referuar edhe detyrave të lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në vendimin nr. {***}, datë 25.02.2021.

6.2 Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale në ngarkim të shtetasit K. K., nevojitet hetim i mëtejshëm lidhur me faktin nëse veprimet procedurale janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe nëse është zbatuar në mënyrë korrekte legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale, ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar.

6.3 Në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasit K. K., nevojitet hetim i mëtejshëm lidhur me faktin nëse është subjekti i rivlerësimit, prokurori i çështjes në procedimin penal nr. {***} të vitit 2017 dhe respektimin e afateve të saj, në kuptim të neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale.

6.4 Në lidhje me procedimin penal për veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, nevojitet hetim i mëtejshëm lidhur me ecurinë e procedimit penal për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit në drejtim të sekuestros së pasurisë dhe vendimmarrjes eventuale të gjykatës gjatë kontrollit të këtij vendimi .

7. Veç sa më sipër, sipas Komisionerit Publik, gjetjet e Komisionit për dy çështjet penale të transferuara organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, që lidhen përkatësisht, me procedimin penal nr. {***}, datë 16.07.2018, dhe procedimin penal nr. {***}, datë 01.10.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në varësi edhe të rezultateve të hetimit gjyqësor, do të ndikonin në vlerësimin përfundimtar të çështjes.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegji, më datë 17.01.2024, parashtrim² për kundërshtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 442, datë 14.09.2021, të Komisionit, duke pretenduar ndër të tjera se Kolegji nuk legjitimohet *ratione materiae* në shqyrtimin e ankimit. Sipas tij, Komisioneri Publik nuk ka ngritur shkaqe ankimi kundër vendimit të Komisionit, duke bërë që vendimi nr. 442, datë 14.09.2021, të mos jetë kundërshtuar në afatin dhe në formën e përcaktuar nga ligji, duke cenuar parimin e sigurisë juridike. Gjithashtu, sipas tij, vendosja në themel të ankimit e fakteve të reja, del jashtë juridiksionit rivlerësues dhe bie në fushën e veprimtarisë së legjislacionit që rregullon vlerësimin e zakonshëm e periodik të magjistratëve.
9. Në vlerësim të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) sjell në vëmendje se Kushtetuta, në nenin 179/b, pika 5 e saj, si dhe Aneksi i Kushtetutës, në nenin F, pikat 1 dhe 2, i atribuojnë Kolegjit kompetencën e shqyrtimit të ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashkuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, por ndërkohë nga ana e Komisionit, janë evidentuar shkaqe që mund të përbëjnë në dy raste shkelje disiplinore, të cilat institucioni rivlerësues i konsideron jo të asaj shkalle dhe rëndësie, sa të vetme e në mënyrë të pavarur të përbëjnë shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016. Sa i takon pretendimit se Komisioneri Publik nuk e ka kundërshtuar vendimin e Komisionit pasi ai nuk ka ngritur shkaqe ankimi ndaj tij, në vlerësimin e trupit gjykues, është i pabazuar, për sa kohë Komisioneri Publik në ankim ka kërkuar nga Kolegji që në vlerësimin tërësor të çështjes, të vlerësojë edhe ndikimin e konkluzioneve të Komisionit lidhur me dy çështjet penale të transferuara për inspektim organit kompetent. Ndërsa, sa i takon pretendimit tjetër se vendosja e fakteve të reja në themel të ankimit del jashtë juridiksionit të rivlerësimit kalimtar dhe duhet t’i nënshtrohet juridiksionit të zakonshëm disiplinor, trupi gjykues e gjen të pabazuar, për sa kohë Komisioneri Publik, në referencë të nenit 179/b të Kushtetutës, si një ndër institucionet rivlerësuese dhe përfaqësues i interesit publik, por që nuk është pjesë e hetimit administrativ, me marrjen dijeni të një fakti me të cilin është njohur për herë të parë pas shpalljes së vendimit të Komisionit, përmes një denoncimi të publikut të pashqyrtuar në Komision, në harmoni edhe me nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, dhe duke qenë brenda afatit 15-ditor të ankimit të përcaktuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka

² Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit janë regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 17.01.2024.

paraqitur ankim duke vlerësuar se vetëm pas hetimeve të mëtejshme mbi disa çështje konkrete, Kolegji mund të vendosë lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit të Komisionit.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit në datën 11.11.2021, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit³, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 442, datë 14.09.2021, për subjektin e rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve, në datat 18.01.2024, 26.01.2024, 02.02.2024, 23.02.2024 dhe 04.03.2024.
12. Trupi gjykues, në zbatim të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm të datës 18.01.2024, vendosi të pranojë kërkesën e Komisionerit Publik dhe të çelë hetimin gjyqësor duke kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë (në vijim “Prokuroria Gjirokastrë”), administrimin e dosjeve penale dhe dokumentacionit, si vijon: (1) dosjen penale që i përket procedimit penal nr. {***}, datë 05.06.2017; (2) praktikën dokumentare të nxjerrjes së urdhrimit të ekzekutimit të vendimit penal në ngarkim të të dënuarit K. K. për vendimin penal nr. {***}, datë 26.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 07.03.2018, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, si dhe për vendimin nr. {***}, datë 19.09.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; (3) dosjen penale që i përket procedimit penal nr. {***} të vitit 2017; (4) dosjen penale që i përket procedimit penal për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, në ngarkim të shtetasve E. L., F. L. dhe S. L..
13. Në Kolegji, pas regjistrimit të çështjes objekt gjykimi, për subjektin e rivlerësimit janë administruar disa denoncime nga publiku, paraqitur si gjatë periudhës së përgatitjes së çështjes⁴, nga denoncuesit V. Ç., K. Zh., F. M. e L. P., ashtu dhe me nisjen e shqyrtimit gjyqësor⁵, nga

³ Vendimi i Komisionit nr. 442, datë 14.09.2021, i është njoftuar Institucionit të Komisionerëve Publikë, sipas dokumentit lajmërimarrje, regjistruar me nr. {***} prot., datë 27.10.2021.

⁴ 1) Denoncime nga V. Ç., regjistruar në Kolegji përkatësisht me nr. {***} prot., datë 02.05.2018; nr. {***} prot., datë 09.08.2019; nr. {***} prot., datë 14.10.2019; nr. {***} prot., datë 20.02.2020 dhe nr. {***} prot., datë 30.07.2020; 2) denoncime nga K. Zh., regjistruar në Kolegji përkatësisht me nr. {***} prot., datë 23.09.2021 dhe nr. {***} prot., datë 04.01.2024; 3) denoncim nga F. M., regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 30.06.2023; 4) denoncim nga L. P., regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 16.01.2024.

⁵ 1) Denoncuesi A. Ll. ka paraqitur në Kolegji, në datat 18.01.2024, 22.01.2024 dhe 02.02.2024, disa denoncime, përkatësisht si vijojnë. a. Më datë 18.01.2024 janë paraqitur denoncimet e regjistruara në Kolegji me nr. {***} prot.,

denoncuesit A. Ll. dhe M. Sh.. Denoncimet iu vunë paraprakisht në dispozicion Komisionerit Publik, subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Për këto denoncime, palët mbajtën qëndrimet e tyre në seancat gjyqësore publike të datave 26.01.2024 dhe 02.02.2024, si dhe paraqitën parashtrimet e tyre me shkrim.

14. Trupi gjykues, mbështetur në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, në seancat gjyqësore të datave 26.01.2024 dhe 02.02.2024, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi denoncimet e paraqitura në Kolegj, edhe në raport me shpjegimet dhe aktet që paraqiti subjekti i rivlerësimit lidhur me to, me vendime të ndërmjetme të datave 26.01.2024 dhe 02.02.2024, vendosi të kërkojë nga Prokuroria Gjirokastër: (i) dosjet penale që u përkasin procedimeve penale me nr. {***/2019 dhe nr. {***/2020, në funksion të hetimit të denoncimeve të shtetaseve F. M. e L. P.; (ii) aktin që pasqyron hedhjen e shortit për materialet e kallëzimit penal me nr. {***} të vitit 2019 dhe aktet mbi të cilat subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin e mosfillimit të datës 14.10.2019, lidhur me materialin kallëzues të regjistruar me nr. {***/2019, në funksion të hetimit të denoncimit të shtetasit A. Ll., regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 22.01.2024; (iii) të mos vijojë me hetimin e mëtejshëm të denoncimeve të paraqitura në Kolegj përgjatë periudhës së përgatitjes së çështjes dhe ato të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor të saj, në datat 18.01.2024 dhe 22.01.2024, pasi ato nuk plotësojnë kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.
15. Në përgjigje të kërkesave të Kolegjit, Prokuroria Gjirokastër përcolli aktet e kërkuara me shkresat nr. {***} prot., datë 08.02.2024, nr. {***} prot., datë 14.02.2024, nr. {***} prot., datë 16.02.2024, nr. {***} prot., datë 08.02.2024 dhe nr. {***} prot., datë 08.02.2024. Këto akte, pasi iu përcollën paraprakisht Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit, u administruan në cilësinë e provës nga trupi gjykues dhe iu nënshtruan gjithashtu debatit gjyqësor në seancën gjyqësore të datës 23.02.2024 .
16. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues analizoi të gjitha kërkimet e paraqitura nga Komisioneri Publik në ankim, gjatë gjykimit dhe në bisedimet përfundimtare, të lidhura vetëm me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, prapësimet dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë seancave gjyqësore publike, shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje gjatë hetimit administrativ dhe atij gjyqësor, si edhe vlerësoi të dhënat e përfutuara prej akteve të administruara në funksion të hetimit gjyqësor, të denoncimeve nga publiku të paraqitura në Kolegj.

A. Çështjet penale të referuara në ankim nga Komisioneri Publik

*datë 18.01.2024; nr. {***} prot., datë 18.01.2024; nr. {***} prot., datë 18.01.2024; nr. {***} prot., datë 18.01.2024; nr. {***} prot., datë 18.01.2024; nr. {***} prot., datë 18.01.2024 dhe nr. {***} prot., datë 18.01.2024. b. Më datë 22.01.2024, janë paraqitur denoncimet e regjistruara në Kolegj përkatësisht: nr. {***} prot., datë 22.01.2024; nr. {***} prot., datë 22.01.2024; nr. {***} prot., datë 22.01.2024; nr. {***} prot., datë 22.01.2024; nr. {***} prot., datë 22.01.2024; nr. {***} prot., datë 22.01.2024. c. Më datë 02.02.2024, është paraqitur denoncimi i regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 02.02.2024. 2) Denoncimi nga M. Sh. është regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 25.01.2024.*

Lidhur me procedimin penal nr. {}, datë 5.6.2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal***

17. Në ankim, Komisioneri Publik ka parashtruar nevojën për hetim të mëtejshëm, lidhur me: (i) shkaqet që kanë sjellë kohëzgjatjen e hetimit nga momenti i regjistrimit të procedimit penal nr. {***}, datë 05.06.2017, deri në paraqitjen e kërkesës për pushimin e procedimit penal datë 23.11.2020, referuar nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) subjektet të cilëve u atribuohet vepra penale, regjistrimi i tyre referuar nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe zbatimi eventual i dispozitës së nenit 75/a, lidhur me nenin 80 të Kodit të Procedurës Penale, në përcaktimin e kompetencës lëndore në hetimin e procedimit penal, referuar edhe detyrave të lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në vendimin nr. {***}, datë 25.02.2021.
18. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në parashtrimet e datës 23.02.2024, pas njohjes me aktet e procedimit penal, Komisioneri Publik parashtrroi se nga momenti i regjistrimit të këtij procedimi penal më datë 05.06.2017 e deri në paraqitjen e kërkesës së parë për pushimin e çështjes më datë 27.10.2020, subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore, por duket se mbeten për t’u vlerësuar shkaqet eventuale të një kohëzgjatjeje të tillë. Ndërsa lidhur me zbatimin e dispozitave të parashikuara nga nenet 75/a, 80 dhe 287 të Kodit të Procedurës Penale, sipas Komisionerit Publik, për sa kohë nuk ka gjetur zbatim neni 287 për regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, nuk kanë zbatim as dispozitat e neneve 75/a dhe 80 të Kodit të Procedurës Penale.
19. Në bisedimet përfundimtare të datës 04.03.2024, Komisioneri Publik parashtrroi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e verifikimit të mangësive profesionale në raport me: (i) përballimin e ngarkesës në punë; (ii) kryerjen në mënyrë të efektshme të procedurave hetimore; (iii) kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit të caktuar, sipas nënindikatorëve të parashikuar nga neni 74, “Aftësitë organizative”, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
20. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj më datë 29.02.2024⁶, në vijim të qëndrimit të mbajtur në seancën gjyqësore të datës 23.02.2024, duke sjellë në vëmendje jurisprudencën e GjEDNj-së lidhur me konceptin e “afatit të arsyeshëm”, parashtrroi se kohëzgjatja e hetimit nga data 05.06.2017, kur është bërë regjistrimi i procedimit penal, deri në datën 27.10.2020, kur është përpiluar kërkesa për pushimin e procedimit penal, nuk mund të vlerësohet si tejkalim i afatit të arsyeshëm, për sa kohë që në regjistrin e njoftimit të veprave penale, nuk është shënuar emri i ndonjë personi të dyshuar si autor i veprës penale, e për pasojë nuk gjejnë zbatim afatet maksimale të hetimit, sipas neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas tij, në vlerësimin e kohëzgjatjes së kësaj çështjeje, duhen mbajtur në konsideratë një sërë faktorësh, të tillë si: (i) kompleksiteti i çështjes në drejtim të volumit të provave shkresore (1947 faqe), fakteve

⁶ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 29.02.2024.

që lidhen me kryerjen e disa ekspertimeve, pyetjes së personave, këqyrjes dhe analizës së tyre, si dhe analizimit të shumë aspekteve ligjore që kishin të bënin me një tërësi ligjesh; (ii) ngarkesa e lartë në punë për shkak të mungesës së prokurorëve në organikën e Prokurorisë Gjyrokastër që prej vitit 2019 e në vijim, si dhe prioritetet e vendosura në trajtimin e çështjeve në kushtet e një veprimtarie të tillë; (iii) reduktimi i veprimtarisë së organit të prokurorisë për shkak të pandemisë së Covid-19. Ndërsa lidhur me aplikimin e nenit 75/a, 80 dhe 287 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit, duke iu referuar udhëzimit nr. 9, datë 10.12.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm⁷, parashtroi se nga hetimi nuk lindën dyshime mbi persona konkretë për kryerjen e veprës penale dhe në kushtet kur nuk është regjistruar emër personi në regjistrin e njoftimit të veprave penale, çështja nuk mund të transferohej për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar e Korrupsionit (në vijim “SPAK”). Subjekti sjell në vëmendje faktin që kjo çështje, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi A. Ll., është shqyrtuar edhe në SPAK, i cili ia ka dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, ku kjo e fundit me vendimin e datës 22.11.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. {***} të vitit 2021. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një sërë aktesh shkresore⁸ në cilësinë e provës, cituar në poshtëshënim. Ai ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në diskutimet përfundimtare të datës 04.03.2024.

21. Veç sa më sipër, në seancën gjyqësore të datës 23.02.2024, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një sërë aktesh⁹ lidhur me strukturën organike të Prokurorisë Gjyrokastër dhe numrin e prokurorëve që

⁷ Në nenin 9 të këtij udhëzimi, përcaktohet se: “Prokurori i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, për aktet, procedimin apo çështjen penale, të regjistruar për vepra penale dhe/ose ndaj subjekteve të listuara në nenin 75/a Kodit të Procedurës Penale i ndryshuar, të cilët janë në fazën e hetimeve paraprake, vendos transferimin e çështjes për kompetencë lëndore Prokurorisë së Posaçme, duke njoftuar menjëherë gjykatën përkatëse në rastet kur ndaj personit nën hetim ose të pandehurit është disponuar me vendim të gjykatës në këtë fazë”.

⁸ 1. Vendim nr. {***}, datë 25.02.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, përmes të cilit është vendosur mosmiratimi i kërkesës për pushimin e çështjes dhe kthimi i akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve; 2. kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. {***}, e datës 16.05.2022, të Prokurorisë Gjyrokastër; 3. vendim nr. {***}, datë 04.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, i formës së prerë, përmes të cilit është vendosur pushimi i procedimit penal nr. {***} të vitit 2017; 4. kopje e fletës së librit të dorëzimit të akteve në gjykatë, datë 10.11.2020, në të cilën evidentohet fakti se shkresa me nr. {***} (me anë të së cilës dërgohet kërkesa e pushimit e datës 27.10.2020) drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, është dorëzuar në këtë institucion më datë 10.11.2020; 5. kopje e faqes së parë të fashikullit të gjykatës, në të cilën është shënuar vula e pranimit të akteve në prokurori më datë 11.05.2021; 6. shkresë nr. {***}, datë 24.12.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë dhe bashkëlidhur vendimi i mosfillimit të procedimit penal për materialin kallëzues nr. {***} të vitit 2021, të përcjellë për kompetencë nga SPAK, që i përket kallëzimit penal të shtetasit A. Ll. ndaj ish-kryetares së Bashkisë Gjyrokastër; 7. shkresë nr. {***}, datë 01.01.2024, e Prokurorisë Gjyrokastër, në të cilën pasqyrohet ngarkesa e punës së subjektit të rivlerësimit për periudhën 2017 - 2023; 8. shkresë nr. {***}, datë 24.01.2024, e Prokurorisë Gjyrokastër, në të cilën pasqyrohet numri i procedimeve dhe materialeve kallëzuese të kësaj prokurorie prej vitit 2017 deri në vitin 2023.

⁹ 1. Shkresë e Prokurorisë së Përgjithshme nr. {***} prot., datë 21.02.2019, “Dërgohet urdhër nr. 27, datë 21.02.2019, i Prokurorit të Përgjithshëm për strukturën e prokurorive të rretheve gjyqësore dhe prokurorive të apeleve”; 2. shkresë nr. {***} prot., datë 29.01.2020, “Dërgohet struktura organike për vitin 2020”, e Prokurorisë së Përgjithshme,

kanë ushtruar efektivisht detyrën në këtë prokurori në periudhën 2019 - 2023, ngarkesën e tij për periudhën 2017 – 2023, si dhe kërkesat për shtim organike drejtuar organeve kompetente në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë.

22. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 5.6.2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të referuar nga Komisioneri Publik, nga aktet e administruara sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë Gjyrokastër, trupi gjykues konstaton se:

22.1 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka regjistruar më datë 05.06.2017, procedimin penal për veprën penale “Shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit P. V. të datës 31.05.2017¹⁰. Referuar urdhrorit për regjistrimin e procedimit penal, parashtrohet se: [...] në kallëzimin e tij, shtetasi P. V. dyshon se shefi i INUV Gjyrokastër, ka shpërdoruar detyrën me mosveprimet e tij, pasi ka lejuar fillimin dhe vazhdimin e punimeve duke mos marrë asnjë masë për ndalimin e tyre. Arkitekti i cili ka punuar për llogari të Bashkisë Gjyrokastër, duke hartuar plan-vendosjen e zhvillimit të objektit “Ndërtim i tregut industrial”, në plan-vendosje ka falsifikuar hartën duke fshirë objekte të ndërtuara dhe duke i pasqyruar ato jo në gjendjen reale, por si rrugë kalimi. Bashkia Gjyrokastër, nëpërmjet falsifikimit dhe duke shpërdoruar detyrën, kanë arritur të miratojnë kontraktimin e marrjes me qira të një prone private dhe më pas tenderimin dhe miratimin e ndërtimit të tregut industrial, duke shkelur çdo rregull urbanistik dhe duke kryer procedura tenderimi në mënyrë të dyshimtë [...]. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe nëpunësit e saj kanë ndryshuar hartat duke i falsifikuar ato në favor të pronarit të truallit dhe Bashkisë Gjyrokastër. Gjithashtu, kallëzuesi ka dyshime për miratimin e dhënë nga PMNZSH dhe UK Gjyrokastër, të cilët, në kundërshtim me ligjin, kanë dhënë miratimin duke treguar se ndërtimi i tregut i plotëson kriteret si nga ana e sigurisë dhe rregullat për mbrojtjen nga zjarri, ashtu edhe kriteret për pajisje dhe furnizim me ujë [...].

drejtuar Prokurorisë Gjyrokastër; 3. shkresë nr. {***} prot., datë 2.02.2021, “Miratim i numrit të punonjësve për vitin 2021”, e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave; 4. shkresë nr. {***} prot., datë 31.01.2022, “Dërgohet struktura organike për vitin 2022”, e Prokurorisë së Përgjithshme; 5. shkresë nr. {***} prot., datë 26.06.2023, nr. {***} prot., datë 24.04.2023, si dhe {***} prot., datë 19.01.2023, e Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Prokurorisë Gjyrokastër; 6. shkresë nr. {***} prot., datë 03.06.2019, e Prokurorisë Gjyrokastër drejtuar KLP-së; 7. shkresë nr. {***} prot., datë 25.07.2019, e Prokurorisë Gjyrokastër drejtuar KLP-së; 8. shkresë nr. {***} prot., datë 08.10.2019, e Prokurorisë Gjyrokastër drejtuar KLP-së; 9. shkresë nr. {***} prot., datë 28.10.2019, e Prokurorisë Gjyrokastër drejtuar KLP-së; 10. vendim i KLP-së nr. {***}, datë 27.09.2019, “Për ndërprerjen e caktimit të përkohshëm”; 11. shkresë nr. {***} prot., datë 31.12.2019, e Prokurorisë Gjyrokastër drejtuar KLP-së; 12. shkresë nr. {***} prot., datë 02.06.2020, e Prokurorisë Gjyrokastër drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm; 13. shkresë nr. {***} prot., datë 19.10.2021, e Prokurorisë Gjyrokastër drejtuar KLP-së; 14. shkresë nr. {***} prot., datë 05.04.2022; 15. shkresë nr. {***} prot., datë 09.05.2022, e Prokurorisë Gjyrokastër drejtuar KLP-së; 16. shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 04.01.2024, e Prokurorisë Gjyrokastër drejtuar subjektit të rivlerësimit; 17. shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 08.01.2024, e Prokurorisë Gjyrokastër drejtuar subjektit të rivlerësimit;

¹⁰ Drejtoria Vendore e Policisë Gjyrokastër ka përcjellë me shkresën nr. {***}, datë 02.06.2017, materialet procedurale për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, bazuar në kallëzimin e shtetasit P. V..

22.2 Me urdhrin “Për delegimin e veprimeve hetimore” të datës 10.06.2017, subjekti i rivlerësimit i ka deleguar Oficerit të Policisë Gjyqësore kryerjen brenda datës 30.09.2017 të veprimeve procedurale si vijojnë: (i) të këqyret vendi ku po ndërtohet tregu i qytetit; (ii) të këqyret dhe të merret gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor i ndërtimit; (iii) të kryhet ekspertimi topografik për të përcaktuar pronësinë e objekteve, distancat urbane, rrugët e kalimit etj.; (iv) të pyeten kryetari i KKT-së në Bashkinë Gjirokastrë; (v) të pyetet pronari i tokës ku bëhet investimi; (vi) të kryhen veprime të tjera hetimore që do të dalin të nevojshme gjatë hetimeve. Në zbatim të këtij urdhri, rezultojnë të jenë kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) më datë 10.06.2017, janë marrë deklaratimet e shtetasit Ll. B. (pronar i truallit mbi të cilin po kryhej ndërtimi); (ii) në datat 10.06.2017, 11.06.2017, 05.07.2017 dhe 28.07.2017, janë marrë deklaratime nga shtetasi P. V. (kallëzuesi) dhe është administruar dokumentacioni i paraqitur prej tij; (iii) më datë 29.06.2017, janë këqyruar dhe janë marrë dokumente (kërkesa për aplikim, relacione, projektvendim për marrjen me qira të truallit me destinacion ndërtimin e tregut, studim për ndërtimin e tregut, planvendosje etj.) nga Bashkia Gjirokastrë; (iv) më datë 30.06.2017, janë këqyruar dhe janë marrë dokumente në zyrën e prokurimeve publike pranë Bashkisë Gjirokastrë; (v) më datë 03.07.2017, janë këqyruar dhe janë marrë dokumente nga ZVRPP Gjirokastrë; (vi) më datë 17.07.2017, u këqyr vendi i ngjarjes në lagjen “{***}” në qytetin e Gjirokastrës; (vii) më datë 28.07.2017, është marrë nga shtetasi P. V., leja e zhvillimit nr. {***}, datë 22.06.2017, e Bashkisë Gjirokastrë;

22.3 Veprimtaria hetimore ka vijuar në vitet 2018 dhe 2019, përmes kryerjes së veprimeve si vijojnë: (i) më datë 11.01.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të këqyret dhe të merret dokumentacioni i dorëzuar nga Bashkia Gjirokastrë pranë Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi Gjirokastrë (në vijim “PMNZSh Gjirokastrë”), dokumentacioni i cili është administruar më datë 12.01.2018; (ii) më datë 15.01.2018, është vendosur të këqyren dhe të merren pamjet filmike të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Gjirokastrë; (iii) më datë 15.01.2018, është kërkuar nga Bashkia Gjirokastrë lista emërore e anëtarëve të Këshillit Bashkiak Gjirokastrë për legjislaturën 2015-2019, e cila është administruar në organin e prokurorisë më datë 18.01.2018; (iv) më datë 23.01.2018, është vendosur kryerja e ekspertimit topografik brenda datës 31.01.2018, duke thirrur ekspertët K. M. dhe Xh. Ll.¹¹; (v) më datë 16.04.2018, është sekuestruar harta e punës e ndodhur në ZVRPP Gjirokastrë, në të cilën ndodhet tregu i ri industrial në lagjen “{***}” dhe më datë 18.04.2018, është urdhëruar kthimi i saj; (vi) më datë 18.04.2018, u këqyr dhe u mor kopje e fragmentit të hartës kadastrale të pasurisë; (vii) më datë 01.08.2019, është kërkuar nga Bashkia Gjirokastrë dokumentacioni i procedurës së tenderimit të truallit të marrë me qira për ndërtimin e tregut, informacioni i përcjellë në organin e prokurorisë më datë 16.08.2019; (viii) më datë 15.09.2019, është vendosur kryerja brenda datës 20.10.2019, e ekspertimit tekniko-vlerësues, duke thirrur ekspertët A. Ç. dhe L. B.¹².

¹¹ Akti i ekspertimit topografik i administruar në dosje mban datën 10.12.2018

¹² Në dosje janë administruar akti ekspertimi i ekspertës L. B. me datë 10.06.2020 dhe akti ekspertimi i ekspertës A. Ç., datë 7.12.2019.

22.4 Me kërkesë të datës 27.10.2020, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 05.06.2017, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak të mungesës së elementeve të veprës penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 25.02.2021, ka vendosur mosmiratimin e kësaj kërkesë dhe kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve¹³. Në këtë vendim, ndër të tjera, arsyetohet se: *Gjykata vlerëson se ndryshe nga prokurori, personat të cilët kanë inicuar, lejuar, referuar dhe miratuar procedurën e marrjes me qira të truallit për ndërtimin e tregut të qytetit mbi pasurinë nr. {***}, në pronësi të Ll. B., kanë kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokurori duhet të hetojë përgjegjësinë e gjithsecilit, punonjës i Bashkisë Gjirokastrë, i përfshirë në këtë procedurë të kundërligjshme dhe ta vendosë përpara përgjegjësisë penale. Nëse konstatohet veprimtari e kundërligjshme e Kryetarit të Bashkisë, atëherë çështja duhet të referohet për kompetencë në prokurorinë përkatëse, kompetente. Përpara përgjegjësisë ligjore penale, të vihen të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak, të cilët kanë votuar “pro” vendimit për lidhjen e kontratës së qirasë. [...] gjykata konstaton veprime abuzive dhe të kundërligjshme nga administrata e Bashkisë dhe ekspertët e kontraktuar apo të referuar nga organi i akuzës, me qëllim fshehjen dhe manipulimin e së vërtetës dhe ndërtimin e tregut me paracaktueshmëri, në pronën e z. Ll. B. [...] grupi i punës i caktuar me vendim të Kryetarit të Bashkisë, nuk ka kryer asnjë procedurë informimi publik dhe dokumentimi të çmimit të tregut, njoftimin, marrjen dijeni dhe dhënien e ofertave nga personat fizikë. Akti i ekspertimit të ekspertit B. A., administruar nga prokuroria, jep të dhëna të ndryshme nga ekspertimet e ekspertëve K. M. dhe Xh. Ll.. Të verifikohet në terren vërtetësia e këtyre akteve dhe të vihen përpara përgjegjësisë penale, ekspertët të cilët, haptazi dhe me qëllim, kanë bërë ekspertim të rremë, duke dhënë të dhëna jo të vërteta. Arkitekti F. Ç. dyshohet se ka kryer falsifikim dokumentesh, pasi nuk ka treguar në planvendosje, ndërtesën e z. R. B., duke treguar në mënyrë të pavërtetë se në vend të ndërtimit, është rrugë kalimi automjetesh. Ky ekspertim ka shërbyer për dhënien e lejes së shfrytëzimit të pronës, pasi më parë ishte refuzuar nga Kryetari i Bashkisë. Ekspertja vlerësuese A. Ç., vlerësohet nga gjykata se ka kryer një ekspertim jo të saktë, me qëllim mbulimin e së vërtetës dhe të tregojë se çmimi i qirasë së kontraktuar nga Bashkia ishte brenda çmimit të tregut dhe, si pasojë, nuk ka dëm të shkaktuar nga veprimet e Bashkisë Gjirokastrë. Veprimet e mësipërme të dyshuara të kundërligjshme, duhet të hetohen nga prokurori, në funksion të veprimtarisë së çdo personi, i cili drejtpërdrejt apo në mënyrë indirekte ka ndikuar, miratuar ose përpjekur të fshehtë, veprimtarinë e kundërligjshme të Bashkisë Gjirokastrë në lidhjen e kontratës së qirasë me z. Ll. B..*

22.5 Në zbatim të detyrave të caktuara nga gjykata, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) më datë 02.11.2021, është vendosur të kryhet riekspertimi topografik, brenda datës 15.12.2021, nga eksperti topograf R. B.; (ii) më datë 02.11.2021, është vendosur këqyrja dhe marrja e pamjeve

¹³ Me vendimin “Për vënien në lëvizje të çështjes së pezulluar” të datës 8.2.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur vënien në lëvizje të çështjes penale të pezulluar duke marrë në konsideratë pezullimin e gjykimeve në gjykata, për shkak të pandemisë nga “Covid 19”.

filmike të mbledhjes së Këshillit Bashkiak Gjirokastrë të datës 04.10.2016, pamje të cilat u këqyrën dhe u morën po në këtë datë; (iii) më datë 02.11.2021, është kërkuar informacion nga Bashkia Gjirokastrë mbi anëtarët e Këshillit Bashkiak të cilët kanë votuar “pro” ndërtimit të tregut industrial në lagjen “{***}” etj., informacion i cili u administrua në prokurori më datë 22.11.2021; (iv) më datë 16.11.2021, u morën deklaratimet e shtetasit F. Ç..

22.6 Me kërkesë të datës 16.05.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar sërish pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 05.06.2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi ka arritur në konkluzionin se nga hetimet, nuk rezultuan elemente të kësaj vepre penale e, për pasojë, hetimet nuk u shtrinë më tej në drejtim të personave konkretë funksionarë të kësaj njësie vendore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 04.07.2022, ka pranuar kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: *[...] në kushtet kur deri në këto momente, nuk konstatohet kryerja e veprimeve të qëllimshme në shkelje të ligjit dhe me dashje, nga ndonjë punonjës i Bashkisë Gjirokastrë, gjykata do të pranojë kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal. Gjykata sjell në vëmendje se vendimmarrja e saj për pushim, mund të revokohet në çdo kohë në varësi të rrethanave, fakteve dhe provave të reja që do të dalin në vijim. Me interes, paraqitet situata pas zgjidhjes së kontratës së qirasë dhe kryerja e analizës ekonomike të një veprimtarie të tillë nga Bashkia Gjirokastrë dhe Këshilli Bashkiak. Referuar kopjes së këtij vendimi të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit së bashku me parashtrimet e datës 29.02.2024, ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 12.06.2023, pasi nuk është ankimuar.*

- 23.** Nga verifikimi i veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, trupi gjykues konstaton se hetimet paraprake të këtij procedimi penal, nga data e regjistrimit të tij, më datë 05.06.2017, e deri në datën e kërkesës për pushimin e çështjes, datë 27.10.2020, kanë zgjatur 3 vjet, 4 muaj e 22 ditë. Ndonëse për shkak të faktit se procedimi penal është regjistruar pa u shënuar emër personi që i atribuohet vepra penale në regjistrin e njoftimit të veprave penale sipas parashikimit të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, edhe pse në kallëzimin penal përmendeshin disa funksionarë të dyshuar, dhe kjo rrethanë nuk kushtëzon respektimin e ndonjë afati, sërish duket se subjekti i rivlerësimit e ka zgjatur tej një afati të arsyeshëm hetimin e kësaj çështjeje. Nga faktet e përmendura më lart, trupi gjykues konstaton disa periudha kohore, disamujore (28.7.2017 – 11.01.2018; 23.01.2018 – 17.04.2018; 18.4.2018 – 10.12.2018; 10.12.2018 – 1.8.2019 dhe 15.09.2019 – 7.12.2019 dhe 7.12.2019 – 10.06.2020), brenda të cilave nuk janë kryer veprime hetimore, ndërsa konstaton edhe mosrespektim të afateve të caktuara në urdhrat apo vendimet e nxjerra prej tij, siç është rasti i kryerjes me vonesë të aktit të ekspertimit topografik të datës 10.12.2018, i cili ishte përcaktuar të kryhej brenda datës 30.09.2017, apo moskryerja në afat e ekspertimit tekniko-vlerësues¹⁴, parashikuar për t’u kryer brenda datës 15.09.2019. Trupi gjykues konstaton se mosveprimi në kohë i subjektit të rivlerësimit, ka vijuar

¹⁴ Nga ekspertët janë përgatitur dy akte të veçanta që mbajnë përkatësisht datat 7.12.2019 dhe 10.06.2020.

edhe pas vendimit nr. {***}, datë 25.02.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila vendosi kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve, pasi edhe referuar datës së administrimit të dosjes gjyqësore në prokurori, më datë 11.05.2021, sërish subjekti i rivlerësimit duket se ka nisur me vonesë, pas rreth 6 (gjashtë) muajsh, zbatimin e detyrave të caktuara nga gjykata, me marrjen e vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit më datë 02.11.2021.

24. Nga pikëpamja e kompleksitetit të këtij procedimi penal, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në parashtrime, trupi gjykues konstaton se dosja e procedimit penal përbëhet nga tre fashikuj, me një volum të konsiderueshëm aktesh shkresore, edhe pse disa prej tyre rezultojnë të përsëritur¹⁵. Veprimet hetimore të kryera janë shtrirë në disa drejtime: *së pari*, në mbledhje dokumentacioni përmes këqyrjes dhe marrjes së informacionit lidhur me procedurën e ndërtimit të tregut të ri në Gjirokastrë nga një sërë institucionesh, të tilla si: ZVRPP Gjirokastrë, Bashkia Gjirokastrë, PMNZSh Gjirokastrë dhe Televizioni i Gjirokastrës; *së dyti*, në kryerjen dhe administrimin e dy akteve ekspertimi topografik, si dhe dy akteve ekspertimi tekniko-vlerësues (nga dy ekspertë të ndryshëm), të cilat janë kryer përkatësisht në vitet 2018 dhe 2021, si dhe 2019 e 2020; *së treti*, në pyetje personash, përmes marrjes së deklarimeve të disa shtetasve. Ndonëse këto veprime hetimore nuk i përkasin një natyre të vështirë, që kërkon teknika të veçanta hetimi, trupi gjykues vlerëson natyrën komplekse të çështjes në drejtim të volumit të provave të administruara dhe analizimit të një numri të konsiderueshëm faktesh.
25. Në lidhje me pretendimet mbi ngarkesën në punë të subjektit të rivlerësimit, për shkak të mungesave në vazhdimësi të prokurorëve në organikën e Prokurorisë Gjirokastrë dhe angazhimeve të tjera, nga dokumentacioni i depozituar në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton faktet si vijojnë: *(i)* referuar strukturës organike të kësaj prokurorie për vitet 2019 - 2023, numri i prokurorëve ka qenë si vijon: për vitin 2019 – 5 prokurorë; për vitet 2020, 2021, 2022 – 7 prokurorë; për vitin 2023 (gjysma e parë e vitit) – 7 prokurorë; *(ii)* numri i prokurorëve që ka ushtruar efektivisht detyrën në këtë prokurori, ka qenë si vijon: *në vitin 2017*, kanë ushtruar detyrën 5 prokurorë deri më datë 17.10.2017, ndërsa pas kësaj date, kanë vijuar detyrën 4 prokurorë; *në vitin 2018*, kanë ushtruar detyrën 4 prokurorë deri më datë 12.10.2018, ndërsa pas kësaj date, kanë vijuar detyrën 5 prokurorë; *në vitin 2019*, kanë ushtruar detyrën 5 prokurorë deri më datë 24.01.2019, në vijim deri më datë 16.05.2019, kanë ushtruar detyrën 4 prokurorë, në vijim deri më datë 27.09.2019, kanë ushtruar detyrën 3 prokurorë, dhe pas datës 27.09.2019, kanë ushtruar detyrën 2 prokurorë; *në vitin 2020*, kanë ushtruar detyrën 2 prokurorë deri më datë 11.02.2020, dhe pas kësaj date, kanë ushtruar detyrën 4 prokurorë; *në vitin 2021*, kanë ushtruar detyrën 4 prokurorë deri më datë 04.10.2021, dhe pas kësaj date, kanë ushtruar detyrën 3 prokurorë; *në vitin 2022*, kanë ushtruar detyrën 3 prokurorë deri më 09.05.2022, në vijim deri në datën 27.07.2022, kanë ushtruar detyrën 2 prokurorë, dhe pas kësaj date, kanë ushtruar detyrën 4 prokurorë; *në vitin*

¹⁵ Relacioni “Mbi marrjen me qira të një sipërfaqeje trualli 1000 m², me destinacion ndërtimin e tregut të qytetit Gjirokastrë”; studimi “Ngritja e tregut të qytetit Gjirokastrë”; vendimi nr. {***}, datë 04.10.2016, për marrjen me qira të truallit me destinacion ndërtimin e tregut të qytetit; leja e zhvillimit nr. {***}, datë 09.06. 2017.

2023, kanë ushtruar efektivisht detyrën 4 prokurorë dhe prej muajit shkurt të këtij viti, 5 prokurorë¹⁶; (iii) ngarkesa e subjektit të rivlerësimit në vitet 2017 – 2023, ka qenë si vijon: *për vitin 2017*, ka hetuar gjithsej 312 procedime penale; *për vitin 2018*, ka hetuar gjithsej 325 procedime penale; *për vitin 2019*, ka hetuar gjithsej 328 procedime penale; *për vitin 2020*, ka hetuar gjithsej 501 procedime penale; *për vitin 2021*, ka hetuar gjithsej 411 procedime penale; *për vitin 2022*, ka hetuar gjithsej 416 procedime penale; *për vitin 2023* (gjashtëmujori), ka hetuar 30 procedime penale; (iv) subjekti i rivlerësimit për periudhën 2019 - 2022, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, i ka adresuar KLP-së një sërë kërkesash, në të cilat ka ngritur shqetësimin mbi numrin e ulët të prokurorëve të kësaj prokurorie dhe pasojat që mund të sjellë kjo në punën e organit të prokurorisë, duke u shprehur: [...] *Për shkak të numrit të ulët të prokurorëve dhe ngarkesës së lartë në punë, rrezikohet të tejkalohen afatet ligjore të hetimit të çështjeve penale, të zvarritet hetimi i këtyre çështjeve si dhe të mos ketë mundësi fizike që të përfaqësohen çështjet në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Situata është rënduar shumë edhe për shkak të procedimeve penale të mbartura nga prokurorët e larguar apo ata që janë në statusin “i pezulluar”. [...] kërkojmë nga KLP që në ushtrim të kompetencave të veta, të bëjë plotësimin me prokurorë sipas strukturës së miratuar [...];* (v) nga angazhimi në seksionin e ekzekutimit të vendimeve penale rezulton se: në vitin 2019 janë nxjerrë 317 urdhra ekzekutimi; për periudhën janar deri më datën 02.04.2020, janë nxjerrë 26 urdhra ekzekutimi; për periudhën 09.06.2021 – 15.06.2021, janë nxjerrë 7 urdhra ekzekutimi; për periudhën 06.10.2021 – 13.12.2021, janë nxjerrë 11 urdhra ekzekutimi; për periudhën janar 2022 – 21.10.2022, janë nxjerrë 125 urdhra ekzekutimi.

26. Referuar të dhënave të raporteve të Prokurorit të Përgjithshëm mbi ngarkesën e Punës së Prokurorisë për vitet 2021 dhe 2022, të publikuara në faqen zyrtare në internet të Prokurorisë së Përgjithshme¹⁷, trupi gjykues vëren se në Prokurorinë Gjirokastrë, referuar volumit në hetim, mesatarja e çështjeve për prokuror në periudhën 2017 – 2022, sipas numrit organik të prokurorëve¹⁸, ka qenë si vijon: *viti 2017 – 315 çështje; viti 2018 – 297 çështje; viti 2019 – 357 çështje; viti 2020 – 279 çështje; viti 2021 – 266 çështje; viti 2022 – 245 çështje*, ndërsa mesatarja e ngarkesës për prokuror, sipas numrit faktik të prokurorëve¹⁹, ka qenë: *viti 2017 – 315 çështje;*

¹⁶ Me vendimin nr. {***}, datë 03.07.2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur caktimin e prokurorit Juljan Çafka në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

¹⁷ Shih:

https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_2022_Mbi_ngarkesen_e_punes_se_prokurorive_viti_2022_31_Mars_2_3_perf_6949.pdf,

si dhe:

https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_2021_Mbi_ngarkesen_e_punes_se_prokurorive_viti_2021_4_prill_64_10.pdf.

¹⁸ Numri organik i prokurorëve në periudhën 2017 – 2022, ka qenë si vijon: *viti 2017 – 5 prokurorë, viti 2018 – 5 prokurorë, viti 2019 – 5 prokurorë, viti 2020 – 7 prokurorë, viti 2021 – 7 prokurorë dhe viti 2022 – 7 prokurorë.*

¹⁹ Numri faktik i prokurorëve në periudhën 2017 – 2022 ka qenë si vijon: *viti 2017 - 5 prokurorë, viti 2018 – 5 prokurorë, viti 2019 – 5 prokurorë, viti 2020 – 4 prokurorë, viti 2021 – 4 prokurorë, viti 2022 – 6 prokurorë.*

viti 2018 – 297 çështje; viti 2019 – 357 çështje; viti 2020 – 489 çështje; viti 2021 – 465 çështje; viti 2022 – 286 çështje.

27. Nga analiza e të dhënave mbi ngarkesën në punë të subjektit të rivlerësimit në raport me të dhënat mbi mesataren e ngarkesës për prokuror sipas numrit faktik të prokurorëve, cituar në paragrafin më sipër, trupi gjykues vëren se ngarkesa në punë e subjektit të rivlerësimit për vitet 2018, 2020 dhe 2022, ka qenë dukshëm mbi mesataren e ngarkesës për prokuror, ndërsa për vitet 2017, 2019 dhe 2021 ka qenë e përafërt me mesataren e ngarkesës për prokuror. Nëse mbahet parasysh edhe fakti që numri faktik i prokurorëve përgjatë një viti, nuk ka qenë i njëjtë përgjatë gjithë vitit, por në periudha disamujore brenda një viti ka qenë edhe më i ulët, siç ka ndodhur në vitet 2017, 2019 apo 2021, sikurse cituar në paragrafin 25/ii të këtij vendimi, ngarkesa reale e përballuar nga subjekti i rivlerësimit do të ishte edhe më e lartë. Në rastin konkret, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në periudhën e kohëzgjatjes së hetimeve paraprake të procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, të shtrirë në periudhën 05.06.2017 deri në 27.10.2020, për dy vite të kësaj periudhe, 2018, 2020 dhe gjatë kryerjes së hetimeve shtesë në vitin 2022, ka pasur një ngarkesë të konsiderueshme pune.
28. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se situata e pandemisë së shkaktuar nga Covid - 19 ka ndikuar në këtë kohëzgjatje, referuar akteve normative të Këshillit të Ministrave²⁰ dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm²¹, trupi gjykues konstaton se masat kufizuese në veprimtarinë gjyqësore dhe atë të prokurorisë për shkak të kësaj situatë, kanë nisur në muajin mars të vitit 2020 dhe kanë vijuar përgjatë tij. Trupi gjykues vëren se këto akte parashikonin vetëm reduktim të veprimtarisë hetimore, duke caktuar prioritete në drejtim të veprimeve hetimore që kishin të bënin me çështjet penale lidhur me masat e sigurimit apo çështjet penale me afat të caktuar, ndërsa në fazën e hetimeve paraprake, kufizohej kryerja e veprimeve hetimore që lidheshin kryesisht me marrjen e deklarimeve të personave. Ndonëse në rastin konkret, situata e pandemisë përkon me periudhën fundore të hetimeve paraprake, nga muaji mars, kur nisën kufizimet për shkak të kësaj situatë, deri në muajin tetor të vitit 2020, kur u kërkua nga subjekti pushimi i procedimit penal, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit,

²⁰ Akt normativ nr. 3, datë 15.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”; VKM nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”; akt normativ nr. 9, datë 25.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; akt normativ nr. 21, datë 27.5.2020, “Për disa ndryshime në aktin normativ nr. 9, datë 25.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”.

²¹ Udhëzim i Përgjithshëm nr. 3, datë 19.03.2020, “Për disa masa procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, në funksion të parandalimit të përhapjes Covid-19”; udhëzim i përgjithshëm nr. 04, datë 24.03.2020, “Mbi masat administrative për mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga Covid-19”; udhëzim nr. 6, datë 27.04.2020, “Për masat procedurale dhe administrative në veprimtarinë funksionale në mbarëvajtjen e punës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në funksion të parandalimit të përhapjes së infeksionit nga Covid-19”.

duke vlerësuar se kjo situatë nuk mund të ketë pasur ndikim në atë masë sa të justifikojë shtrirjen e hetimeve në një hark kohor të tillë.

29. Lidhur me verifikimin e subjekteve të cilëve u atribuohet vepra penale sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe zbatimi eventual i dispozitës së nenit 75/a, lidhur me nenin 80 të Kodit të Procedurës Penale, në përcaktimin e kompetencës lëndore në hetimin e procedimit penal, referuar urdhrit për regjistrimin e procedimit penal, trupi gjykues konstaton se procedimi penal nr. {***}, datë 05.06.2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, është regjistruar pa emër personi që i atribuohet vepra penale sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, si në fillimet e veprimtarisë hetimore dhe gjatë zhvillimit të saj. Trupi gjykues vëren se veprimtaria e subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim, ndonëse fillimisht është gjetur e pamjaftueshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me vendimin nr. {***}, datë 25.02.2021, pas përmbushjes së detyrave të caktuara prej saj nga subjekti i rivlerësimit, është gjetur e drejtë nga kjo gjykatë me vendimin nr. {***}, datë 04.07.2022, vendimmarrje e cila ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët. Në rastin konkret, nisur nga fakti që Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë nuk rezulton të ketë marrë cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime apo të jetë marrë në përgjegjësi penale, trupi gjykues vlerëson se nuk aplikohen parashikimet e nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale²².
30. Në përfundim, lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 05.06.2017, të regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, trupi gjykues konstaton kohëzgjatje të hetimeve tej një afati të arsyeshëm, e cila ka ardhur si pasojë edhe e mungesës së veprimeve hetimore në periudha kohore disamujore, moszbatimit të afateve të caktuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes nga ana e ekspertëve të caktuar, përkatësisht për kryerjen e aktit të ekspertimit topografik dhe aktit të ekspertimit tekniko-vlerësues, si dhe nisjes së zbatimit me vonesë të detyrave të lëna nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Këto mangësi konsiderohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, që lidhen me aftësitë organizative të prokurorit, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me ekzekutimin e dy vendimeve penale në ngarkim të shtetasit K. K.

31. Në ankim, Komisioneri Publik ka parashtruar nevojën e hetimit të mëtejshëm lidhur me faktin nëse veprimet procedurale të nxjerrjes së urdhrave për ekzekutimin e vendimeve penale nr. {***}, datë 26.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 7.3.2018, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe vendimin nr. {***}, datë 19.06.2019, të Gjykatës

²² “Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon: [...] c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura, te përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj”.

së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe nëse është zbatuar në mënyrë korrekte legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale, ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar.

32. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në parashtrimet e datës 23.02.2024, pas njohjes me aktet e administruara nga Kolegji lidhur me këto dy praktika, Komisioneri Publik parashtrroi se nuk konstatohen problematika në veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në procedurën e ekzekutimit të këtyre dy vendimeve penale. Ndërsa në bisedimet përfundimtare të datës 04.03.2024, Komisioneri Publik mbajti qëndrimin se lidhur me ekzekutimin e vendimit penal nr. {***}, datë 26.10.2017, si dhe vendimit penal nr. {***}, datë 19.06.2019, konstatohet tejkalim i afateve vetëm me disa ditë referuar udhëzimit të përbashkët “Për shpalljen në kërkim ndërkombëtar” i Ministrit të Brendshëm me nr. {***} prot., datë 1.6.2010 dhe Prokurorit të Përgjithshëm me nr. {***} prot., datë 3.6.2010 (në vijim “udhëzimi i përbashkët”), mangësi të cilat, marrë në konsideratë rrethanat objektive të konstatuara, duket se janë jorelevante në nxjerrjen e urdhrave, duke mos cenuar në tërësi procedurën e ekzekutimit të këtyre dy vendimeve penale.
33. Subjekti i rivlerësimit, si në parashtrimet e datës 29.02.2024, ashtu dhe në bisedimet përfundimtare, ka parashtruar se për këto praktika, është vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8831 datë 21.04.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.
34. Nga aktet e administruara në Kolegj që u përkasin dy praktikave të referuara nga Komisioneri Publik, të administruara në gjykim sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë Gjirokastër, trupi gjykues konstaton se:

34.1 Me vendimin nr. {***}, datë 26.10.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit K. K. për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimit gjyqësor”, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 7.3.2018, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Subjekti i rivlerësimit, me urdhrin nr. {***}, datë 08.5.2018, ka urdhëruar ekzekutimin e këtij vendimi. Ky urdhër iu përcoll Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër me shkresën nr. {***} prot., datë 08.05.2018, të Prokurorisë Gjirokastër.

34.2 Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.05.2019, i ka përcjellë Prokurorisë Gjirokastër, materialet për shpalljen në kërkim ndërkombëtar. Kjo e fundit, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.05.2019, pasi ka konstatuar se bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 14.05.2019, nuk ishte bashkëngjitur praktika për shpalljen në kërkim kombëtar, si procesverbali për kontrollin e vendeve dhe banesës së shtetasit K. K., dhe referuar faktit që në procesverbal shkruhej se “*nuk u gjet asnjë send apo provë materiale*” e nuk përmendej kërkimi i të dënuarit K. K., i ka kërkuar Komisarariatit të Policisë Gjirokastër që, në zbatim të udhëzimit të përbashkët, t’i përcjellë praktikën e ndjekur për shpalljen në kërkim ndërkombëtar,

procesverbalet për kërkimet e bëra në shkallë kombëtare, me qëllim lokalizimin dhe arrestimin e të dënuarit K. K. etj. Në përgjigje të kësaj kërkese, Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, me shkresën nr. {***} prot., datë 18.06.2019, me lëndë: “Dërgohen materialet për shpalljen në kërkim ndërkombëtar”, i ka përcjellë Prokurorisë Gjirokastër, materialet përkatëse për shpalljen në kërkim ndërkombëtar. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të ekzekutimit, më datë 25.06.2019, ka lëshuar urdhër kërkimi ndërkombëtar për shtetasin K. K.. Ky urdhër është përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme me shkresën nr. {***} prot., datë 25.06.2019.

34.3 Me vendimin nr. {***}, datë 19.06.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, të shtetasit nën hetim K. K., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Mashtrimit”, veprë e parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit, me urdhrin e datës 24.06.2019, në cilësinë e prokurorit të ekzekutimit, ka urdhëruar ekzekutimin e këtij vendimi duke e shpallur shtetasin K. K. në kërkim kombëtar dhe ka ngarkuar për ekzekutimin e tij shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër. Nga aktet në dosje, nuk evidentohet data e përcjelljes së këtij urdhri pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër.

34.4 Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.11.2019, “Njoftim për shpalljen në kërkim ndërkombëtar”, drejtuar Prokurorisë Gjirokastër, ka informuar se nga kërkimet e bëra, nuk është bërë e mundur gjetja e shtetasit K. K. brenda territorit kombëtar, si dhe nga informacionet që disponohen, ky shtetas ndodhet jashtë shtetit shqiptar. Prokuroria Gjirokastër, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.12.2019, pasi ka konstatuar se shkresës me nr. {***} prot., datë 27.11.2019, nuk i është bashkëngjitur procesverbali për kërkimet e bëra për gjetjen dhe kapjen e tij, në zbatim të udhëzimit të përbashkët, ka kërkuar të vihet në dispozicion praktika e ndjekur për kërkimet e bëra në shkallë kombëtare. Nga aktet në dosje, nuk evidentohet se kur i janë vendosur në dispozicion këto akte Prokurorisë Gjirokastër. Megjithatë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, më datë 11.12.2019, ka lëshuar “Urdhrin për kërkim ndërkombëtar” për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit për caktimin e masës së sigurimit në ngarkim të shtetasit K. K..

35. Nga analizimi i akteve të mësipërme, trupi gjykues konstaton se për të dyja praktikat e referuara nga Komisioneri Publik, veprimet procedurale janë kryer nga subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka, në cilësinë e prokurorit të ekzekutimit. Në drejtim të verifikimit të zbatueshmërisë së legjislacionit në fuqi, trupi gjykues sjell në vëmendje se referuar legjislacionit të zbatueshëm të kohës, procedurat dhe afatet e nxjerrjes dhe vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit rregullohen nga ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, si dhe ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018, i cili, në nenet 22 dhe 23 parashikonte se: *Vendimet me burgim, me marrjen formë të prerë, i dërgohen prokurorit nga gjykata menjëherë ose tërhiqen prej tij për vënien në ekzekutim. [...] Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe të veprimeve sipas nenit 22 të këtij ligji, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit dhe ia dërgon Policisë së Shtetit të vendit ku ka vendbanimin, qëndrimin e përhershëm ose*

*vendqëndrimin e të dënuarit [...]. Në referencë të këtyre dispozitave, trupi gjykues konstaton se në procedurën e parë, që i përket ekzekutimit të vendimit penal nr. {***}, datë 26.10.2017, i cili është një vendim dënimi me burgim që ka marrë formë të prerë më datë 7.03.2018, urdhri i ekzekutimit të prokurorit Juljan Çafka është lëshuar në të njëjtën datë, 08.05.2018, që është administruar vendimi i gjykatës në organin e prokurorisë dhe brenda së njëjtës datë i është përcjellë për ekzekutim Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, në përputhje me dispozitat ligjore të cituara. Në procedurën e dytë, që i përket ekzekutimit të vendimit penal nr. {***}, datë 19.06.2019, trupi gjykues vëren se me anë të këtij vendimi, është miratuar kërkesa e prokurorit për vendosjen e masës së sigurimit arrest me burg, ekzekutimi i të cilit, referuar përcaktimeve të nenit 21 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, i ndryshuar²³, është i menjëhershëm dhe gjykata i njofton menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit. Nga aktet e administruara në Kolegj, trupi gjykues konstaton që urdhri i ekzekutimit të këtij vendimi nga ana e prokurorit Juljan Çafka, është lëshuar më datë 24.06.2019, pra brenda 5 (pesë) ditëve nga data e vendimit të gjykatës dhe jo menjëherë me marrjen e vendimit, ndërkohë që nga aktet nuk evidentohet data e përcjelljes së këtij urdhri pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër.*

36. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vëren se veprimet e prokurorit lidhur me shpalljen në kërkim ndërkombëtar, afatet dhe institucionet e përfshira në këtë proces, rregullohen nga ligji nr. 10193, datë 03.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar me ligjin nr. 100/2013, si dhe udhëzimi i përbashkët. Në nenin 48 të ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009, i ndryshuar, përcaktohet se: *1. Prokurori i ekzekutimit, nëse ka të dhëna se i dënuari nuk gjendet brenda territorit shqiptar, mund të nxjerrë urdhrin për kërkimin ndërkombëtar të tij për qëllime të ekzekutimit të vendimit penal me burgim të formës së prerë. 2. Prokurori i çështjes, nëse ka të dhëna se personi i kërkuar nuk gjendet brenda territorit shqiptar, mund të nxjerrë urdhrin për kërkimin ndërkombëtar të tij për qëllim të ekzekutimit të masës së sigurimit për kufizimin e lirisë personale. [...] 4. Prokurori ia dërgon menjëherë urdhrin e kërkimit ndërkombëtar Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ia përcjell Zyrës së Interpolit për komunikimin ndërkombëtar të urdhrin. Në udhëzimin e përbashkët përcaktohet se: 6. Drejtoritë e Policive në Qarqe ose Komisarariatet e Policisë, nga momenti i marrjes së urdhrin të ekzekutimit nga prokurori,*

²³ Neni 21 i ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, i ndryshuar, përcakton se: “Ekzekutohen me urdhër të gjykatës menjëherë pas shpalljes së vendimit: 1. Vendimet penale që përmbajnë pafajësi, përjashtimin e të gjykuarit nga dënimi ose pushimin e gjykimit të çështjes sipas pikës 2 të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kur gjendet i paligjshëm arresti në flagrancë ose ndalimi, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm, përveç kur ka një masë sigurim me arrest për shkak tjetër, si dhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë. 2. Për ekzekutimin e menjëhershëm, gjykata i njofton menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit. Prokurori nxjerr urdhrin e lirit të menjëhershëm, i cili vihet në ekzekutim nga organet përgjegjëse, pasi të kenë verifikuar më parë që ndaj të njëjtit person ose së njëjtës pasuri nuk janë në fuqi vendime të tjera penale që legjitimojnë vazhdimin e mbajtjes së personit nën arrest, ndalim, paraburgim ose burgim apo mbajtjes së pasurisë nën sekuestro ose konfiskim. 3. Vendimi penal që përmban burgim dhe miratim të kërkesës së prokurorit për masën e sigurimit me arrest. 4. Vendimet penale që përmbajnë sekuestrim si masë provizore kur jepet një dënim me konfiskim. Për ekzekutimin e menjëhershëm, gjykata i jep paraprakisht organit përkatës urdhrin me shkrim dhe brenda 3 ditëve nga shpallja, i dërgon vendimin penal”.

garantojnë që strukturat përkatëse të policisë, brenda 3 muajve, duhet të përfundojnë të gjitha veprimet për kërkimin në shkallë kombëtare, me qëllim lokalizimin dhe arrestimin e personit në kërkim. 7. Në përfundim të afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij udhëzimi dhe kur rezulton se personi i kërkuar nuk gjendet brenda territorit kombëtar, drejtoritë e Policisë në qarqe ose Komisaritet e Policisë njoftojnë prokurorin, i cili urdhëron për shpalljen e personit në kërkim ndërkombëtar. [...] Prokurori urdhëron shpalljen e personit në kërkim ndërkombëtar edhe përpara përfundimit të afatit 3-mujor të kërkimit kombëtar, kur strukturat e policisë së shtetit njoftojnë të dhëna mbi lokalizimin jashtë vendit të këtyre personave apo disponojnë informacion mbi largimin e tyre nga Shqipëria. 10. Prokurori i çështjes, apo prokurori i ekzekutimeve penale, brenda 5 ditëve nga marrja e dokumentacionit të plotësuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut apo Komisaritetit të Policisë, materialet bashkëlidhur ia dërgon Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë.

37. Referuar dispozitave të cituara më sipër, trupi gjykues konstaton se në praktikën e parë që lidhet me vendimin gjyqësor nr. {***}, datë 26.10.2017, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të ekzekutimit, ka përcjellë urdhrin e ekzekutimit të këtij vendimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër në të njëjtën datë që ka administruar vendimin gjyqësor, pra më datë 08.05.2018. Pasi ka marrë dijeni mbi njoftimin për shpallje në kërkim ndërkombëtar më datë 14.05.2019 dhe ka administruar materialet përkatëse nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër më datë 18.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhrin për kërkimin ndërkombëtar më datë 25.06.2019 e në po këtë datë, ky urdhër i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, pra 2 (dy) ditë me vonesë nga afati 5- (pesë-) ditor i parashikuar në pikën 10 të udhëzimit të përbashkët. Në këtë rast, duket se veprimet nga ana e organit të policisë janë kryer në tejkalim të afatit 3- (tre-) mujor të parashikuar në pikën 6 të udhëzimit të cituar më sipër. Sa i takon praktikës së dytë, që i përket vendimit nr. {***}, datë 19.06.2019, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit më datë 24.06.2019. Ndonëse në dosje nuk evidentohet data e dërgimit të këtij urdhri pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, trupi gjykues konstaton se kjo e fundit ka përcjellë në prokurori njoftimin mbi faktin që personi nuk gjendet brenda territorit të vendit më datë 27.11.2019. Më datë 05.12.2019, nga organi i prokurorisë është kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni i plotësuar, dhe referuar kësaj date (në pamundësi të evidentimit të datës se kur është administruar dosja e plotësuar në prokurori), rezulton që urdhër kërkimi ndërkombëtar është nxjerrë nga subjekti i rivlerësimit më datë 11.12.2019, pra 1 (një) ditë me vonesë nga afati 5- (pesë-) ditor, dhe në po këtë datë i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme.
38. Në përfundim, lidhur me ekzekutimin e dy vendimeve penale, përkatësisht vendimit nr. {***}, datë 26.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 07.03.2018, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, si dhe vendimit nr. {***}, datë 19.06.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, nga verifikimi i veprimtarisë procedurale mbi ekzekutimin e vendimeve penale të rregulluar nga ligji nr. 8331, datë 21.04.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” i ndryshuar, si dhe legjislacionit mbi shpalljen në kërkim

ndërkombëtar të rregulluar nga ligji nr. 10193, datë 03.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar dhe nga udhëzimi i përbashkët, trupi gjykues konstaton tejkallim të afateve të përcaktuara nga legjislacioni i sipërcituar vetëm me disa ditë vonesë, të cilat u vlerësuan si jorelevante në kontekstin e rrethanave të faktit dhe që nuk afektojnë në tërësinë e tyre veprimet e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje.

Në lidhje me procedimin penal nr. {} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasit K. K.***

39. Në ankim, Komisioneri Publik ka parashtruar nevojën e hetimit të mëtejshëm në drejtim të faktit nëse është subjekti i rivlerësimit prokurori i çështjes së këtij procedimi penal dhe respektimin e afateve të hetimit në kuptim të neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale.
40. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në parashtrimet e datës 23.02.2024, pas njohjes me aktet e fashikullit penal, Komisioneri Publik parashtroi se në hetimin e këtij procedimi penal, të regjistruar më datë 27.06.2019 dhe dërguar kërkesa për pushimin e procedimit penal më datë 5.1.2022, subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore, por mbeten për t’u vlerësuar shkaqet e një kohëzgjatjeje të tillë. Në bisedimet përfundimtare të datës 04.03.2024, Komisioneri Publik ka parashtruar se në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e verifikimit të mangësive në raport me: (i) përballimin e ngarkesës në punë; (ii) kryerjen në mënyrë të efektshme të procedurave hetimore; (iii) kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit të përcaktuar, sipas nënindikatorëve të parashikuar nga neni 74, “Aftësitë organizative”, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
41. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj më datë 29.02.2024, ka sqaruar se në këtë procedim penal nuk ka qenë i shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale as emri i shtetasit K. K., as i ndonjë personi tjetër si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale dhe, në të tilla kushte, afati i parashikuar në nenet 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale, do të vlerësohet si një afat orientues, por që tejkallimi i tij nuk sjell *prima facie* tejkallim të afatit të arsyeshëm. Ai, ndër të tjera, është shprehur: [...] *fakti që shumësi i veprimeve është kryer në kohë, shkallën jo të vogël të kompleksitetit, fakti që ka pasur faktorë objektivë të përligjur, duke pasur parasysh edhe mungesën e ngutshmërisë nga perspektiva e interesat në lojë dhe ekzistenca e mjeteve efektive, arrihet në përfundimin se afati i hetimit të kësaj çështjeje është i arsyeshëm [...].* Edhe për këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji që duhet të mbajë në konsideratë ngarkesën e lartë në punë për shkak të mungesës së prokurorëve në organikën e prokurorisë, si dhe situatën e pandemisë Covid-19.
42. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, të referuar në ankim, nga aktet e administruara në Kolegj sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë Gjirokastër, trupi gjykues konstaton se:

42.1 Prokurori E. K., prokuror në Prokurorinë Gjyrokastër, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit A. Ll.²⁴, ka regjistruar më datë 7.7.2017, procedimin penal për veprën penale “Mashtrimi”, e parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit K. K., duke urdhëruar njëkohësisht dhe kryerjen e një sërë veprimesh hetimore²⁵.

42.2 Nga aktet në dosje, vihet re se më datë 10.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për shtetasin K. K.. Ndërsa, me vendim “Për ndarjen e çështjes penale”, të datës 27.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të ndajë çështjen penale nr. {***} të vitit 2017, duke e regjistruar këtë të fundit me nr. {***} të vitit 2017 dhe nr. {***} të vitit 2017. Referuar përmbajtjes së këtij vendimi, konstatohet se në përfundim të hetimeve paraprake të procedimit penal nr. {***}, datë 7.7.2017, në ngarkim të të pandehurit K. K., i akuzuar për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, ka rezultuar se shtetasi K.K. ka përfituar nëpërmjet mashtrimit nga shtetasi A. Ll. një shumë monetare dhe se ngrihen dyshime që punonjësit e ALUIZNI-t Gjyrokastër, duke shpërdoruar detyrën, kanë kryer deklaram të rremë, fakte që, sipas subjektit, duhen hetuar.

42.3 Sipas vërtetimit të datës 18.09.2019, të Prokurorisë Gjyrokastër, rezulton se procedimi penal nr. {***} i vitit 2017, është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër për veprën penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, ndërsa procedimi penal nr. {***} i vitit 2017 është regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

42.4 Në kuadër të hetimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) më datë 21.10.2019, janë marrë deklaramet e shtetasit A. Ll.; (ii) më datë 23.10.2019, janë marrë deklaramet e shtetasit A. K.; (iii) më datë 29.10.2019, janë marrë deklaramet e shtetasit A. H. (përmbarues) dhe është administruar dokumentacioni i paraqitur prej tij; (iv) më datë 29.10.2019, është kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Gjyrokastër, praktika e legalizimit dhe e regjistrimit të pasurisë nr. {***}, ZK {***} {***}, dokumentacioni i përcjellë nga ky institucion më datë 27.12.2019; (v) më datë 17.01.2020, janë marrë deklaramet e shtetasit Ll. K. (i biri i K. K.); (vi) më datë 24.02.2020, janë kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Gjyrokastër, gjeneralitetet e specialistit-jurist pranë ish-drejtorisë së ALUIZNI-t Gjyrokastër; (vii) më datë 18.9.2020, rikërkohen të dhënat e kërkuara më datë 24.2.2020; (viii) më datë 22.07.2021,

²⁴ Regjistruar me nr. {***}, datë 28.06.2017, përmes të cilit kallëzohet fakti se shtetasi K. K. ka vjedhur me anë të mashtrimit një shumë monetare. Po ashtu, ai ka kallëzuar për deklaram të rremë pranë zyrës së ALUIZNI-t Gjyrokastër, shtetasit O. dhe Ll. K. (fëmijët e shtetasit K. K.).

²⁵ Nga prokurori E. K. janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) më datë 11.10.2017, janë marrë deklaramet e kallëzuesit A. Ll., në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, dhe është administruar dokumentacioni i paraqitur prej tij; (ii) më datë 05.10.2017, është kërkuar informacion nga Zyra e ALUIZNI-t Gjyrokastër mbi vetëdeklaramet e shtetasit K. K. dhe familjarëve të tij; (iii) më datë 02.05.2019, janë këqyruar dhe janë marrë në cilësinë e provës materiale, dokumentet: akt ekspertimi nr. {***}, datë 16.11.2018 dhe CD me audion e seancave gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjyrokastër.

është administruar nga dosja e procedimit penal nr. {***}, viti 2019, procesverbali i deklarimit të shtetasit Ll. K. i datës 17.01.2020; (ix) më datë 29.09.2021, është urdhëruar pyetja e punonjësës së ALUIZNI-t L. B., deklarimet e së cilës janë marrë më datë 15.12.2021; (x) më datë 15.12.2021, është këqyruar dhe është administruar praktika dokumentare e aplikimit pranë zyrës së ish-ALUIZNI-t Gjirokastër për legalizimin e banesës së vetëdeklaruar për legalizim prej subjektit O. K. dhe Ll. K.; (xi) më datë 30.06.2021, janë kërkuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër të dhënat e sistemit TIMS për shtetasit O. K. dhe Ll. K..

42.5 Me kërkesën e datës 05.01.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, pasi nga hetimet nuk rezultuan elemente të figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, dhe as elemente të figurës së veprës penale të “Pengimit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 31.03.2022, ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorit për kryerje të hetimeve të mëtejshme lidhur me veprat penale “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 190/1/3 të Kodit Penal, si dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, sipas drejtimeve të përcaktuara nga gjykata. Në këtë vendim, gjykata ka orientuar organin procedues lidhur me: *1. Caktimin e një eksperti dhe kryerjen e një akti ekspertimi, me qëllim hetimin e faktit nëse nënshkrimi dhe firma në formularin e deklaratës për përfshirjen në procedurat e legalizimit nr. {***}, datë 3.11.2014, janë nënshkruar ose jo nga shtetasja O. K. dhe në rast se nuk janë nënshkruar prej saj, a është nënshkruar prej shtetasit K. Ko.? 2. Hetimin e faktit se kur janë hartuar realisht deklaratat nr. {***}, datë 03.11.2014, dhe procesverbali i verifikimit në terren me index {***} [...]. 3. Të hetohet lidhur me pronarin real të pasurisë mbi të cilën është ndërtuar banesa objekt procedimi penal dhe ka dalë leja e legalizimit, duke marrë informacionin përkatës nga ASHK Gjirokastër. 4. Të pyeten shtetasit O. K. dhe Ll. K., në cilësinë e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, pasi nga aktet, nuk rezulton që të jenë pyetur lidhur me faktet objekt procedimi penal. 5. Veç këtyre veprimeve, prokurori mund të kryejë dhe veprime të tjera procedurale të cilat i çmon të nevojshme, në funksion të hetimit të fakteve objekt procedimi penal.* Ndaj vendimit nr. {***}, datë 31.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit dhe referuar korrespondencës mes Prokurorisë Gjirokastër dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresat nr. {***} prot., datë 29.01.2024 dhe nr. {***} prot., datë 05.02.2024, administruar në dosje, procedimi penal nr. {***} i vitit 2017 ndodhet në gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

- 43.** Nga verifikimi i veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, trupi gjykues konstaton se hetimet paraprake të këtij procedimi penal, nga data e regjistrimit të tij, më 7.7.2017, e deri në datën e kërkesës për pushimin e çështjes, më 05.01.2022, janë shtrirë në një hark kohor prej 4 vjetësh 5 muajsh e 28 ditësh. Pavarësisht nga fakti se emri i të dyshuarve për kryerjen e veprës penale nuk është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, rrethanë që nuk kushtëzon respektimin e ndonjë afati procedural, hetimi i çështjes, edhe pse nuk mund t’i atribuohet tërësisht subjektit të rivlerësimit, sërish duket se ka

zgjatur tej një afati të arsyeshëm. Në mungesë të akteve mbi mënyrën dhe datën e saktë të caktimit të subjektit të rivlerësimit si prokuror në këtë çështje, edhe nëse si datë e nisjes së angazhimit të tij do të konsiderohej data 10.06.2019, që është data që mban akti i parë procedural i nënshkruar prej tij, kohëzgjatja e hetimeve të kryera deri më datë 5.1.2022, kur u kërkua pushimi i procedimit penal, përsëri do të ishte përtej një afati të arsyeshëm, duke u shtrirë në një hark kohor prej 2 vjetësh, 6 muajsh e 25 ditësh. Nga faktet e përmendura më sipër, trupi gjykues konstaton se veprimet e para hetimore pas ndarjes së çështjes më datë 27.06.2019, të kryera nga subjekti i rivlerësimit, janë kryer në muajin tetor, pra pas rreth katër muajsh, ndërkohë që veprimet hetimore të shtrira në disa vite (2019, 2020 dhe 2021), rezultojnë të jenë të rralla. Trupi gjykues vëren se këto veprime konsistojnë më së shumti në pyetje personash dhe në mbledhje dokumentacioni, e si të tilla vlerësohet që nuk kërkojnë një angazhim të atillë që të justifikojë shtrirjen e hetimeve në një hark të tillë kohor.

44. Veç sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore për zbardhjen e çështjes, por ato nuk kanë rezultuar të plota. Kjo pamjaftueshmëri, ndonëse sërish nuk mund t'i atribuohet vetëm subjektit të rivlerësimit, evidentohet në mungesën e kryerjes së një veprimi hetimor të nevojshëm në rastin e hetimit të veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, siç është kryerja e një akti ekspertimi për dokumentin që pretendohet i falsifikuar, veprim që duhet të ishte kryer nga subjekti i rivlerësimit përpara se të urdhërohej nga gjykata. Mungesa e veprimeve hetimore është konfirmuar, edhe pse në mënyrë jo përfundimtare nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që ka kontrolluar veprimtarinë hetimore, e cila ka urdhëruar organin e prokurorisë të vijojë hetimet duke i caktuar detyra konkrete.
45. Pretendimi i ngritur në parashtrime nga subjekti i rivlerësimit se, ndër faktorët që kanë ndikuar në këtë kohëzgjatje, ka qenë edhe ngarkesa e lartë në punë, trupi gjykues, referuar të dhënave të cituara në paragrafët 25 dhe 26 më sipër, vëren se në kohështrirjen e kësaj veprimtarie në tri vite, 2019, 2020 dhe 2021 (pa përfshirë vitin 2022, pasi në janar të vitit 2022 u kërkua pushimi i çështjes), subjekti i rivlerësimit në vitin 2020 ka pasur një ngarkesë pune mbi mesataren e ngarkesës për prokuror në Prokurorinë Gjirokastrë, ndërsa në vitet 2019 dhe 2021 kjo ngarkesë ka qenë e përafërt me ngarkesën mesatare për prokuror.
46. Në përfundim, lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, trupi gjykues konstaton kohëzgjatje të hetimeve tej një afati të arsyeshëm, e cila ka ardhur si pasojë e kryerjes së veprimeve hetimore me distanca kohore nga njëra-tjetra, dhe moskryerje e veprimtarisë së nevojshme hetimore, e konfirmuar edhe nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë që ka kontrolluar këtë veprimtari. Këto mangësi konsiderohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale që lidhen me aftësitë profesionale të prokurorit dhe aftësitë organizative sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 2 dhe në nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

***Në lidhje me procedimin penal për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”,
parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve E. L., F. L. dhe S. L.***

47. Në ankim, Komisioneri Publik ka kërkuar verifikim të mëtejshëm të ecurisë së procedimit penal për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit në drejtim të sekuestros së pasurisë dhe vendimmarrjes eventuale të gjykatës në kontrollin e këtij vendimi.
48. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në parashtrimet e datës 23.02.2024, Komisioneri Publik, pasi u njoh me aktet e dosjes së këtij procedimi penal, parashitroi se subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal me nr. {***} të vitit 2016 për kryerjen e veprës penale “Pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe vendimi për sekuestron preventive është marrë në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 25.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Në bisedimet përfundimtare të datës 04.03.2024, Komisioneri Publik ka parashtruar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e verifikimit të mangësive referuar nënindikatoreve të vlerësimit të aftësive të magjistratit, të parashikuara në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e magjistratëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përkatësisht: (i) kryerjen në mënyrë të efektshme të procedurave hetimore; (ii) kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit të përcaktuar.
49. Subjekti i rivlerësimit, si në parashtrimet e datës 28.02.2024, ashtu dhe në diskutimet përfundimtare të datës 04.03.2024, ka parashtruar se qëndrimi i tij për mospranimin e kërkesës së viktimës H. K. për vendosjen e sekuestros ndaj pasurisë me nr. {***}, ZK {***}, nuk ka marrë gjykim meritore në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, dhe se pavarësisht mendimit të tij profesional të shprehur, është mbajtur parasysh fuqia detyruese e vendimit të gjykatës, duke ndërmarrë veprimet e duhura dhe të shpejta në këtë drejtim. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit²⁶ në drejtim të kujdesit që duhet të tregojë vlerësuesi për të mos zëvendësuar bindjen e brendshme dhe logjikën e prokurorit, dhe opinionin e Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, të datës 17.12.2014, në Strasburg, sipas të cilit: *Në një shtet të së drejtës, shpallja i pafajshëm i një personi nuk mund të jetë shkak për ushtrimin e ndjekjes disiplinore të prokurorit.*
50. Lidhur me procedimin penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve E. L., F. L. dhe S. L., të referuar nga Komisioneri Publik në ankim, nga aktet e administruara në Kolegj sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë Gjirokastrë, trupi gjykues konstaton se:

²⁶ Vendim nr. 33 datë 27.09.2021, paragrafi 86 që i përket subjektit të rivlerësimit N. T., dhe vendim nr. 27, datë 06.07.2022, paragrafi 91.3 që i përket subjektit të rivlerësimit G. H.

50.1 Në kallëzimin penal të datës 05.11.2016²⁷, të shtetasit H. K., referohet se: [...] prej vitit 2009 e deri në vitin 2012, djali i tij, E. K., ka rënë pre e mashtrimeve nga disa persona dhe për këto fakte, ai ka bërë kallëzim penal dhe janë proceduar penalisht shtetaset E. L. dhe E. A.. [...] Shtetasja E. L. është dënuar me vendim të formës së prerë me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim, pasi ka përvetësuar përmes mashtrimit, nga djali i tij E., një shumë rreth 30.000.000 lekë. [...] lidhur me paratë që ka përfutuar shtetasja E. L., kam për të thënë se edhe kjo shtetase, nëpërmjet familjarëve të saj, ka blerë banesa dhe dyqane në Tiranë, dhe familjarët e saj ushtrojnë aktivitet kriminal. Prindërit e E. quhen F. dhe S..

50.2 Subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes, me vendimin e datës 05.11.2016, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, duke regjistruar fillimisht emrat e personave nën hetim, L. A., L. A., F. L., S. L., J. Zh. dhe A. Zh., e më pas, më datë 07.06.2017, edhe emrin e shtetasës E. L., e dyshuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

50.3 Gjatë periudhës së hetimeve paraprake, subjekti i rivlerësimit ka zgjatur afatin e hetimeve përmes 7 (shtatë) vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve²⁸, që u përkasin datave 05.02.2017, 05.05.2017, 05.08.2017, 05.11.2017, 05.02.2018, 05.05.2018 dhe 05.08.2018.

²⁷ Ky kallëzim penal është paraqitur gjatë procesit gjyqësor të çështjes penale në ngarkim të shtetasës E. L., e cila ishte deklaruar fajtores nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 12.05.2016, për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi” me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj përfundimisht me 12 vjet burgim. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. {***}, datë 28.07.2016. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 26.04.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. {***}, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

²⁸ **1.** Me vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 05.02.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve me 3 muaj, duke filluar nga data 05.02.2017 deri më datë 05.05.2017, argumentuar me faktin se për shkak të numrit të madh të veprimeve që duhet të kryheshin (transkriptimit të bisedave telefonike të përgjuara dhe kryerjes së veprimeve të tjera hetimore), nuk u arrit përfundimi i këtij procedimi penal në afat. Për hetimin e mëtejshëm, është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore si vijojnë: (i) të kryhet hetimi i plotë pasuror për të dyshuarit; (ii) të administrohen tërësisht bisedat telefonike të përgjuara dhe të kryhet transkriptimi i bisedave telefonike të përgjuara; (iii) të kryhen veprime të tjera hetimore. **2.** Me vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 05.05.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.05.2017 deri më datë 05.08.2017. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal, është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: (i) të merren përgjigjet e kompanisë OSHEE lidhur me kontratat e lidhura nga të dyshuarit e të analizohen; (ii) të kërkohet në gjykatë kryerja e kontrolleve të banesave për të cilat rezultojnë të lidhura kontratat me OSHEE; (iii) të kryhet kontrolli i banesave e të sekuestrohen dokumentacione që kanë të bëjnë me pasuri të paluajtshme të të dyshuarve. **3.** Me vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 05.08.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.08.2017 deri më datë 05.11.2017. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: (i) të bëhet kërkim në banka për shumat që disponojnë A. Zh. e J. Zh.; (ii) të bëhet verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar shtetasve F. e S. L.; (iii) të bëhet transkriptimi i bisedave të përgjuara të të dyshuarve S. L., F. L. dhe E. L. për ditën e ngjarjes. **4.** Me vendim “Për zgjatjen e afatit të hetimeve” të datës 05.11.2017,

50.4 Me kërkesë të datës 31.10.2018, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar gjykimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2016, me të pandehur E. L., F. L. e S. L., të akuzuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal dhe pushimin e pjesshëm të hetimeve për shtetasit J. Zh., A. Zh., L. A. e L. A. dhe A. Sh. për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal. Në përmbajtje të kësaj kërkesë, ndër të tjera, parashtrohet se: *Nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, është dërguar informacion lidhur me banesën me nr. pasurie {***}, e cila rezulton të jetë blerë nga të dyshuarit F. L. e S. L. me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.07.2012. Pala shitëse ka qenë shtetasi F. R. dhe banesa është blerë kundrejt shumës 4.334.850 lekë, vlerë e cila është likuiduar dhe banesa është 74,1 m². Rezulton se kjo pasuri është vendosur në hipotekë për sigurimin e një detyrimi prej 500.000 lekësh, që e dyshuara E. L. ka marrë nga Shoqëria e Parë e Zhvillimit Financiar “{***}” ShA. Rezulton se kjo banesë, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.01.2016, është shitur nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë të të dyshuarve F. e S. L., shtetasit K. A., te shtetasi E. B., për shumën 4.149.600 lekë.*

50.5 Më datë 05.12.2018, kallëzuesi H. K., ka kërkuar nga prokuroria të vendosë sekuestro të pasurisë nr. {***}, ZK {***} Tiranë, që sipas tij ishte shitur gjatë hetimeve të shtetasës E. L. me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., dhe është blerë me lekët e produktit të veprës penale. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, me vendimin e datës 19.12.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur rrëzimin e saj si të pambështetur në fakte dhe në ligj. Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: *[...] Në rastin konkret, rezulton se pasuria me nr. 299/190+1-23, ZK 3866, është shndërruar në shumë parash të përfutur nga të pandehurit. Sipas paragrafit të dytë të nenit 36 të*

subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.11.2017 deri më datë 05.02.2018. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: (i) të bëhet kërkim në banka për shumat që disponojnë A. Zh. e J. Zh.; (ii) të bëhet verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar shtetasve F. e S. L.; (iii) të bëhet transkriptimi i bisedave të përgjuara të të dyshuarve S. L., F. L. dhe E. L. për ditën e ngjarjes. 5. Me vendim “Për zgjatjen e afatit të hetimeve” të datës 05.02.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.02.2018 deri më datë 05.05.2018. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal, është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: (i) të bëhet kërkim në banka për shumat që disponojnë A. Zh. e J. Zh.; (ii) të bëhet verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar shtetasve F. e S. L.; (iii) të bëhet transkriptimi i bisedave të përgjuara të të dyshuarve S. L., F. L. dhe E. L. për ditën e ngjarjes. 6. Me vendim “Për zgjatjen e afatit të hetimeve” të datës 05.05.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.05.2018 deri më datë 05.08.2018. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: (i) të bëhet kërkim në banka për shumat që disponojnë A. Zh. e J. Zh.; (ii) të bëhet verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar shtetasve F. e S. L.; (iii) të bëhet transkriptimi i bisedave të përgjuara të të dyshuarve S. L., F. L. dhe E. L. për ditën e ngjarjes. 7. Me vendim “Për zgjatjen e afatit të hetimeve” të datës 05.08.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.08.2018 deri më datë 05.11.2018. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: (i) të bëhet kërkim në banka për shumat që disponojnë A. Zh. e J. Zh.; (ii) të bëhet verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar shtetasve F. e S. L.; (iii) të bëhet transkriptimi i bisedave të përgjuara të të dyshuarve S. L., F. L. dhe E. L. për ditën e ngjarjes.

Kodit Penal, parashikohet se nuk i nënshtrohet sekuestrimit pasuria që është shndërruar, por vetëm produkti final, që është ajo që përfitohet nga shndërrimi. Në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se sekuestro preventive mund të vendoset kur disponimi i lirë i një sendi mund të rëndojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale apo të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Qëllimi i këtij neni është që të mos rëndohen pasojat e veprës penale nga posedimi i sendit apo të mos kryhen vepra penale të tjera. Në këtë rast, bëhet fjalë për persona të përfshirë e të lidhur me veprimtarinë kriminale, e jo për persona të cilët posedojnë sende të përfituara në mënyrë të ligjshme.

50.6 Pas ankimit të kallëzuesit H. K., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 24.01.2019, vendosi prishjen e vendimit të prokurorit për rrëzimin e kërkesës së kallëzuesit dhe urdhërimin e tij për të nisur procedurën e vendosjes së sekuestros për pasurinë nr. {***} ZK {***}. Në këtë vendim, ndër të tjera, arsyetohet se: [...] *pavarësisht se vepra penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal nuk ka drejtpërdrejt subjekt të dëmtuar, i tillë do të konsiderohet viktimja e veprës penale fillestare, produktet e së cilës dyshohet se pastrohen nga autorët e dyshuar. Shtetasi H. K. konsiderohet nga gjykata, se ka interes dhe mund të paraqesë para prokurorit kërkesa procedurale dhe të ankohet në gjykatë kundër vendimeve të prokurorit. Rezulton se kërkohet vendosja sekuestro mbi një pasuri të paluajtshme, blerë nga e dënuara E. L. dhe familjarët e saj në vitin 2012, dhe tjetërsuar në fillim të vitit 2016, kohë në të cilën është dënuar personi i mësipërm për veprën penale “Mashtrimi”. Vetëm ky fakt të lind dyshimin për tjetërsim të pronës, për të mos u sekuestruar dhe konfiskuar si produkt i veprës penale. [...] Në rastin konkret, prokurori nuk duhet të nxjerrë përfundime mbi analizën e fakteve të pahetuara. Konkretisht, nuk mund të prezumohet se personi i tretë blerës i pasurisë së paluajtshme në vitin 2016, është në mirëbesim. Qenia ose jo në mirëbesim duhet të hetohet, ku duhet të merren në shqyrtim, ekzistenca ose jo e ndonjë marrëveshjeje për kalimin fiktiv të pasurisë. Duhet hetuar ndonjë lidhje e mundshme mes palëve ndërgjyqëse, si dhe fakti se ku i gjeti lekët për blerjen e pasurisë së paluajtshme, i treti në një moshë shumë të re. I përfshirë qoftë edhe rastësisht në një fakt të dyshuar kriminal, i treti ka detyrimin të tregojë burimin e të ardhurave, si dhe ligjshmërinë e tyre. Duhet hetuar edhe fakti se kontrata e porosisë është lidhur në emër të E. L. apo prindërve të saj. Si shpjegohet fakti që kjo pasuri në kushtet kur ishte lënë hipotekë për një kredi të marrë nga e dënuara, është tjetërsuar te persona të tretë. [...] Gjykata vlerëson se për sa kohë do të kryhen hetime mbi transaksionin dhe subjektet e përfshira në të, atëherë duhet që kjo pasuri të sekuestrohet me qëllim kufizimin e tjetërsimit të saj në vazhdimësi. Nëse kjo pasuri do të konfiskohet më pas ose jo, është vlerësim i gjykatës, e cila do të analizojë jo vetëm aspektin penal, por edhe atë civil për vlefshmërinë e një kontrate dhe rregullimin e pasojave të saj [...]. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria Gjirokastrë, duke kërkuar prishjen e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuarit H. K.. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 21.02.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga Prokuroria Gjirokastrë, argumentuar me faktin se nga ana e prokurorit A. A., në seancë gjyqësore, është deklaruar heqja dorë nga ankimi i bërë.*

50.7 Me kërkesë “Për vendosjen e sekuestros konservative” të datës 24.02.2019, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të vendoset sekuestro konservative mbi pasurinë e paluajtshme apartament banimi me nr. pasurie {***}, ZK {***}, ndodhur në {***}, Tiranë. Pas kërkesës së prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 25.02.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe vendosjen e sekuestros konservative mbi pasurinë e paluajtshme, apartament banimi me nr. pasurie {***} ZK, {***}, {***}, Tiranë. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim E. B. (shtetasi të cilit i ishte shitur pasuria më datë 12.01.2016) dhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 25.04.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 25.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

50.8 Në diskutimet përfundimtare drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar deklarinim fajtores të së pandehurës E. L. për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal dhe të dy të pandehurve të tjerë F. e S. L., për kryerjen e së njëjtës veprë penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 04.03.2021, ka vendosur deklarinim fajtores të së pandehurës E. L. për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 vit burgim dhe deklarinim e pafajshëm të shtetasve S. L. dhe F. L..

- 51.** Nga analiza e akteve të këtij procedimi penal, nga verifikimet e kryera në drejtim të vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit lidhur me sekuestron e pasurisë dhe vendimmarrjes eventuale të gjykatës, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka vendosur sekuestron konservative mbi pasurinë nr. {***}, ZK {***}, ndodhur në {***}, Tiranë, në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 25.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Trupi gjykues vëren se më parë, subjekti i rivlerësimit kishte disponuar me rrëzimin e kërkesës së kallëzuesit H. K. për vendosjen e saj, vendimmarrje e cila nuk u pranua nga Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë. Ndonëse pas vendimit të gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar vendosjen e sekuestros konservative, trupi gjykues, pa vlerësuar ligjshmërinë e veprimtarisë apo logjikën e hetimit, vlerëson se vetë subjekti i rivlerësimit duhet të kishte ndërmarrë një veprim të tillë që në fazën e hetimeve paraprake, kur u administrua informacioni mbi këtë pasuri dhe faktin e tjetërsimit të saj te të tretët në një periudhë që përkonte me periudhën e procesit gjyqësor ndaj shtetasve E. L.. Trupi gjykues konstaton se gjatë veprimtarisë hetimore të këtij procedimi penal, të shtrirë nga data 05.11.2016, kur u regjistrua procedimi penal, deri në datën 31.10.2018, kur çështja u dërgua për gjykim, pra në një hark kohor prej 1 viti, 11 muajsh e 25 ditësh, subjekti i rivlerësimit ka zgjatur afatin e hetimeve duke marrë vendime për zgjatje të afatit të hetimeve dhe, në pesë prej të cilave që u përkasin datave 05.08.2017, 05.11.2017, 05.02.2018, 05.05.2018 dhe 05.08.2018, vihet re se arsyet e zgjatjes së afatit të hetimit janë të njëjta dhe nuk argumentohet pamundësia për t’i përfunduar hetimet brenda afatit të zgjatur.
- 52.** Në përfundim, lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2016, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve

E. L., F. L. dhe S. L.”, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka disponuar me 7 (shtatë) vendime për zgjatje të afatit të hetimeve, të cilat rezultojnë të jenë të paargumentuara në raport me kërkesat e nenit 324, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale për të justifikuar zgjatjen e afateve të hetimit, si dhe mosnxjerrjen në momentin e duhur procedural të aktit për vendosjen e sekuestros konservative mbi një pasuri të paluajtshme. Këto mangësi konsiderohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, lidhur me aftësitë profesionale të prokurorit, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

B. Çështjet penale të referuara në denoncimet nga publiku

*Në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2020, të adresuar nga denoncuesja L. P., në denoncimin e regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 16.01.2024*

53. Denoncuesja L. P., në denoncimin e saj të paraqitur në Kolegj, referon procedimin penal nr. {***} të vitit 2020, për të cilin pretendon se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur pushimin e çështjes penale pa kryer hetim të plotë.
54. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, pas njohjes me këtë denoncim në parashtrimet e datës 26.01.2024, Komisioneri Publik parashtroi nevojën e hetimit të mëtejshëm lidhur me faktin nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer hetim të gjithanshëm e të plotë në zbatim të detyrave të lëna nga gjykata. Në vijim të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në parashtrimet e datës 23.02.2024, Komisioneri Publik u shpreh se veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit janë kryer në zbatim të vendimeve gjyqësore, ndërsa në bisedimet përfundimtare të datës 04.03.2024, Komisioneri Publik ka parashtruar se subjekti i rivlerësimit, në rastin konkret, gjendet në kushtet e verifikimit të mangësive në raport me: (i) përballimin e ngarkesës në punë; (ii) kryerjen në mënyrë të efektshme të procedurave hetimore; (iii) kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit të përcaktuar sipas nënindikatorëve të parashikuar nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
55. Subjekti i rivlerësimit, pas njohjes me këtë denoncim, si në parashtrimet e datave 26.01.2024 dhe 29.02.2024, ashtu dhe në diskutimet përfundimtare të datës 04.03.2024, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke parashtruar se për shkak të pasaktësive të evidentuara në kallëzimin penal të denoncueses, i ishte dashur të bënte një vlerësim tërësor të çështjes që në regjistrimin e saj dhe se gjyqtari i seancës paraprake që ka kontrolluar veprimtarinë e prokurorit, ka vendosur bazuar në gjykimin e tij. Më tej, ai ka parashtruar se hetimet janë kryer në një masë të madhe dhe se janë realizuar pothuaj detyrat kryesore, duke mbajtur parasysh edhe gjendjen e jashtëzakonshme të Covid-19 që reduktoi veprimtarinë e organit të prokurorisë dhe vakancat e lëvizjet e vazhdueshme të prokurorëve në organikën e saj, duke sjellë në vëmendje edhe për këtë rast, aktet normative të Këshillit të Ministrave mbi masat e marra gjatë kohëzgjatjes së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, si dhe shkresat që vërtetojnë ngarkesën, strukturën e kërkesat për shtim organike të Prokurorisë Gjyrokastër.

56. Për procedimin penal nr. {***} të vitit 2020, të referuar nga denoncuesja, nga aktet e administruara në Kolegj sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë Gjyrokastër, trupi gjykues konstaton se:

56.1 Në kallëzimin penal të regjistruar me nr. {***}, datë 06.02.2020, shtetasja L. P. ka kërkuar fillimin e ndjekjes penale për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal, ndaj funksionarëve publikë që kanë nxjerrë vendimin nr. {***}, datë 26.09.1996, të KKKP-së së Bashkisë Gjyrokastër, dhe personat e përfshirë në kryerjen e ekspertizës dhe gjykimin e çështjes gjyqësore për dhënien e vendimit nr. {***}, datë 03.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, me të cilin është vendosur pranimi i padisë së shtetasve I. dhe A. Xh..

56.2 Subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes, ka regjistruar më datë 06.02.2020, procedimin penal nr. {***}/2020, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

56.3 Me urdhrin “Për delegimin e veprimeve hetimore” të datës 20.02.2020, ai ka urdhëruar kryerjen e veprimeve procedurale si vijojnë: (i) të thirret e të pyetet kallëzuesja si person që ka dijeni për veprën penale; (ii) të merret vendimi i KKKP Bashkia Gjyrokastër; (iii) të merret kopje e akteve të çështjes civile ku është përdorur vendimi; (iv) të kryhen veprime të tjera që do të dalin të nevojshme gjatë hetimeve. Në zbatim të këtij vendimi janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) më datë 06.05.2020, është kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, kopje e akteve që gjenden në fashikullin gjyqësor të vendimit nr. {***}, datë 03.12.2018; (ii) më datë 05.06.2020, i është kërkuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP) kopje e shoqëruar me hartë e vendimit të KKKP Bashkia Gjyrokastër nr. {***}, datë 26.09.1996, informacion i përcjellë nga ky institucion më datë 12.06.2020; (iii) më datë 01.07.2020, janë marrë deklaratimet e kallëzueses L. P.; (iv) më datë 01.07.2020, janë kërkuar nga ATP Tiranë aktet mbi të cilat është marrë vendimi nr. {***}, datë 26.09.1996, i KKKP Bashkia Gjyrokastër, informacion i përcjellë nga ky institucion më datë 7.7.2020; (v) më datë 20.07.2020, është kërkuar dokumentacioni i arkivuar mbi të cilin është marrë vendimi nr. {***}, datë 26.09.1996, i KKKP Bashkia Gjyrokastër, informacion i përcjellë më datë 04.08.2020.

56.4 Me kërkesën e datës 13.11.2020, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga gjykata pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 06.02.2020, të regjistruar për veprën penale “Shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248, dhe për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, për shkak të mungesës së elementeve të këtyre dy veprave penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, me vendimin nr. {***}, datë 02.03.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, argumentuar me faktin se çështja ka nevojë për hetime të tjera, duke orientuar sa vijon: *Prokurori duhet të hetojë në lidhje me vërtetësinë e aktit “notë transkriptimi”. Hetimi duhet të jetë i plotë duke marrë informacion nga ATP për mënyrën e përdorimit të këtij akti në vendimmarrjet e KKK Pronave Bashkia Gjyrokastër. Të hetohet dhe të pyetet çdo person juridik ose fizik që ka dijeni apo ka përdorur këtë notë*

*transkriptimi; të merret informacion nga Arkivi Shtetëror lidhur me ekzistencën e ndonjë regjistri të mundshëm ku të jenë regjistruar ekstremitetet e notës së transkriptimit; të verifikohet vërtetësia e çdo dokumenti tjetër që ndodhet në dosjet e KKK Pronave që ka dhënë vendimin e kontestuar nr. {***}, datë 26.09.1996; të verifikohet koha e shtetëzimit të pronave të pretenduara dhe disponuara në këto vendime. Të verifikohet nëse janë konfiskuar pa shpërblim apo janë shtetëzuar nëpërmjet shpërblimit; të konstatohet ekzistenca e çdo kundërligjshmërie në vendimmarrjet e tjera të KKK Pronave. Duhet të verifikohet dhe evidentohet çdo kundërligjshmëri e mundshme, përdorimi i akteve të falsifikuara dhe të adresohet tek Avokatura e Shtetit për fillimin e procedimit civil për kthimin e pronësisë shtetit.*

56.5 Në zbatim të vendimit të gjykatës, me urdhrin “Për delegimin e veprimeve hetimore”, datë 10.04.2021, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e detyrave të përmendura në vendimin e gjykatës, si dhe veprime të tjera që do të dalin gjatë hetimeve. Bazuar në këtë urdhër, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) më datë 7.6.2021, janë pyetur shtetasit A. A. dhe I. Xh.; (ii) më datë 7.6.2021, janë marrë në cilësinë e provës materiale dokumentet: notë transkriptimi nr. {***}, datë 14.12.1932; notë transkriptimi nr. {***}, datë 10.04.1937; vendim i shtetëzimit i vitit 1949; kontratë e qirasë e vitit 1949; (iii) më datë 31.05.2021, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave lidhur me regjistrin e veçantë ku mund të regjistrohen notë transkriptimet dhe çdo informacion lidhur me notë transkriptimin e datës 14.2.1932.

56.6 Me kërkesën e datës 26.07.2021, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar sërish nga gjykata pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 06.02.2020, të regjistruar për veprën penale “Shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248 dhe për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, argumentuar me faktin se nga analiza e veprimtarisë hetimore, nuk rezultuan elemente të këtyre dy veprave penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 29.10.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorit për të vazhduar hetimet, duke arsyetuar se: *edhe pse Gjykata ka vendosur të kryheshin një sërë veprimesh hetimore, prokurori është mjaftuar vetëm me marrjen e deklarimeve të shtetasve A. A. dhe I. Xh.. Prokuroria duhet të kryejë ekspertim të vërtetësisë së notës së transkriptimit, duke marrë modele krahasuese të kohës. Ekspertimi duhet të kryhet edhe nëse akti nuk ndodhet në origjinal, por vetëm kopje e vërtetuar; vërtetimi i kopjeve u jep atyre vlerën e origjinalitetit dhe, si të tilla, duhet të jenë detyrimisht objekt ekspertimi, si në aspektin formal, ashtu dhe në aspektin material, duke ekspertuar çdo element përbërës të tij. Shkrimi i përdorur si dhe emrat dhe nënshkrimet e personave që kanë përpiluar aktin, mund të krahasohen lehtësisht me dokumente të ngjashme të kohës, të marra nga Arkivi Qendror, pavarësisht nëse akti është ose jo origjinal; të verifikohet dhe administrohet nota tjetër e transkriptimit e vitit 1937, sipas deklarimeve të deklaruesit I. Xh..* Më datë 09.02.2022, Prokuroria Gjirokastrë ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. {***}, datë 29.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 14.04.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 29.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke vlerësuar se ka një mungesë hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes: *nuk rezulton të jetë hetuar në*

*lidhje me dokumentin “Notë transkriptimi” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.12.1932, pretenduar si i falsifikuar dhe se ai duhet t’i ishte nënshtruar një ekspertimi në lidhje me vërtetësinë e tij; nuk rezulton të jetë hetuar nëse akti notë transkriptimi, për të cilin pretendohet se është i falsifikuar, është ose jo i falsifikuar dhe nëse ka shërbyer ose jo për njohjen dhe kthimin e pronës, a është përdorur për të provuar të drejtën e ish-pronësisë në proceset gjyqësore, në kushtet që vendimi i KKK Pronave është objekt i kundërshtimit civilisht. Mbi kërkesën e organit të akuzës, është kërkuar praktika për dhënien e vendimit me nr. {***}, viti 1996, i KKK Pronave, por nuk rezulton të jetë hetuar se kush e ka paraqitur këtë dokument në KKK Pronave, si është siguruar, nga cili institucion ka dalë, ku dhe kur është përdorur ky dokument, përveç njohjes dhe kthimit të pronës në KKK Pronave. Nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim hetimor për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.*

56.7 Në zbatim të detyrave të caktuara nga gjykata, janë kryer veprimet si vijojnë: (i) më datë 20.04.2023, subjekti i rivlerësimit ka vendosur sekuestrimin e dokumentit “Notë transkriptimi” nr. {***} rep., nr. 4303{***} kol., datë 14.12.1932; (ii) më datë 25.04.2023, i është dërguar Institutit të Policisë Shkencore, vendimi i datës 24.4.2023, për kryerje të ekspertimit grafik të dokumentit, ekspertim që është përcjellë nga ky institucion më datë 15.05.2023.

56.8 Me kërkesën e datës 23.05.2023, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar sërish nga gjykata pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 06.02.2020, të regjistruar për veprën penale “Shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248, si dhe për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, argumentuar me faktin se nga analiza e veprimtarisë hetimore, nuk u konstatuan elemente të këtyre dy veprave penale. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër, me vendimin nr. {***}, datë 26.06.2023, ka vendosur mospranimin e kësaj kërkesë dhe kthimin e akteve prokurorit për të vazhduar hetimet, duke arsyetuar si vijon: *Rezulton se prokurori ka kryer vetëm ekspertimin grafik të dokumentit i cili ka rezultuar pa ndërhyrje dhe i punuar në origjinal. Ndërkohë mbetet për t’u vërtetuar nëse ky dokument është prodhuar nga institucionet e kohës dhe punonjësit përkatës. Prokuroria duhet të hetojë nëse dokumenti është lëshuar nga institucione të kohës, duke krahasuar karakteristikat e tij me dokumente të tjera të ngjashme të së njëjtës periudhë, si për sa u përket personave përpilues apo vërtetues të tij, ashtu edhe institucionit që e ka lëshuar. Krahasimi duhet të kryhet me dokumente të tjera të kohës, të cilat do të provojnë si ekzistencën e personave pjesëmarrës në hartimin e dokumentit, vërtetësinë e funksioneve që ata kanë kryer në atë periudhë, duke dalë në përfundimin nëse dokumenti është prodhuar në kohën e pretenduar dhe nga institucionet kompetente. Gjithashtu, Gjykata konstaton se nuk është marrë informacion nga arkivi lidhur me kohën e shtetëzimit të pasurive objekt konflikti. Verifikimi i këtij fakti konsiderohet i rëndësishëm për gjykatën, në lidhje me dokumentacionin e përdorur nga pala e akuzuar. Objekt hetimi duhet të jetë edhe kontrata e qirasë e vitit 1949 që lidhet drejtpërdrejt me kohën e shtetëzimit të pronës. E rëndësishme është nëse shtetëzimi jo vetëm që ka ndodhur ose jo në periudhën e pretenduar, por edhe nëse është kryer me shpërblim ose jo.*

57. Në vlerësim të pretendimeve të denoncueses, se subjekti i rivlerësimit ka pushuar çështjen pa kryer një hetim të plotë, nga vëzhgimi i veprimtarisë hetimore, trupi gjykues, referuar katër vendimeve gjyqësore që kanë kontrolluar veprimtarinë hetimore të subjektit të rivlerësimit, vëren një veprimtari të pamjaftueshme hetimore në drejtim të zbardhjes së çështjes. Nga aktet e dosjes penale, vihet re se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka rrëzuar tri herë kërkesat e subjektit për pushimin e çështjes, duke kërkuar vazhdimin e hetimeve përmes caktimit të detyrave konkrete, madje në një rast, kjo veprimtari është kontrolluar edhe nga Gjykata e Apelit dhe është gjetur e paplotë. Ndonëse subjekti i rivlerësimit, pas çdo vendimi të gjykatës ka kryer një numër veprimesh hetimore, ato përsëri nuk janë gjetur të plota e të mjaftueshme nga ana e gjykatës. Trupi gjykues vlerëson se veprime hetimore, të tilla si pyetja e shtetasve A. dhe I. Xh. që ishin palë në procesin civil apo kryerja e ekspertimit grafik të notës së transkriptimit, ishin të mundura të kryheshin nga subjekti i rivlerësimit që në fillim të veprimtarisë hetimore dhe të arrihej një konkluzion lidhur me vërtetësinë ose jo të notës së transkriptimit. Veç kësaj, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte kryer veprime hetimore edhe në drejtim të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, për sa kohë ai kishte regjistruar procedimin penal edhe për këtë veprë penale. Sa i takon kohëzgjatjes së çështjes, trupi gjykues konstaton se nga regjistrimi i saj më datë 6.2.2020, deri në paraqitjen në gjykatë të kërkesës për pushimin e çështjes më datë 13.11.2020, çështja ka zgjatur 9 (nëntë) muaj e 7 (shtatë) ditë, kohëzgjatje që për shkak të faktit që nuk ka emër personi që i atribuohet vepra penale të shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, siç parashikon neni 287 i Kodit të Procedurës Penale, nuk kushtëzohet nga respektimi i ndonjë afati procedural.
58. Sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit se Kolegji në vlerësimin e tij duhet të mbajë në konsideratë ngarkesën e tij dhe situatën e pandemisë nga Covid-19, trupi gjykues edhe në këtë rast, referuar të dhënave të cituara në paragrafët 25 dhe 26 më sipër, konstaton se ngarkesa e subjektit të rivlerësimit për vitin 2020, në të cilin është shtrirë veprimtaria hetimore paraprake e subjektit të rivlerësimit, ka qenë mbi mesataren e ngarkesës për prokuror në Prokurorinë Gjirokastrë. Ndërkohë, trupi gjykues, sikurse arsyetuar në paragrafin 28 më sipër, ndonëse situata e pandemisë ka përkuar me periudhën e hetimit të këtij procedimi penal gjatë vitit 2020, nuk e gjen atë me një ndikim të tillë që të justifikojë pamjaftueshmërinë e veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit.
59. Në përfundim, lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2020, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të referuar nga denoncuesja L. P., nga verifikimi i veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi mungesë veprimesh hetimore, e konfirmuar edhe nga vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, përmes rrëzimit të tri kërkesave të subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal, vendimmarrje që në shumicën e rasteve nuk është kontestuar nga subjekti i rivlerësimit. Këto mangësi konsiderohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale lidhur me aftësitë profesionale të prokurorit, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në lidhje me procedimin penal nr. {} të vitit 2019, adresuar nga denoncuesja F. M., në denoncimin e saj të regjistruar në Kolegj me nr. {***}, datë 30.06.2023***

60. Denoncuesja F. M., në denoncimin e paraqitur në Kolegj, referon procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, për të cilin pretendon se po mbushen 4,5 vjet nga regjistrimi dhe nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, është dërguar 4 (katër) herë për pushim në gjykatë. I njëjti procedim penal referohet edhe në tri denoncime të shtetasit A. Ll.²⁹, të paraqitura në Kolegj, në të cilat ngrihen pretendime se subjekti i rivlerësimit ka pasur në hetim dhe ka zvarritur çështjen penale të kallëzueses F. M., në ngarkim të komisioneres së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit F. Sh., lidhur me falsifikimin e një akti noterial, duke e favorizuar këtë të fundit. Sipas denoncuesit, ky procedim penal është mbajtur padrejtësisht nga subjekti i rivlerësimit sepse, referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, kompetencën për hetimin e saj e ka pasur SPAK-u, për shkak të statusit të posaçëm të komisioneres.
61. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, pas njohjes me këtë denoncim, Komisioneri Publik parashtrroi nevojën e hetimit të mëtejshëm lidhur me faktin nëse është subjekti i rivlerësimit, prokurori i çështjes së këtij procedimi penal, si dhe veprimet procedurale të kryera. Në parashtrimet e datës 23.02.2024, Komisioneri Publik, pasi u njoh me aktet e dosjes së procedimit penal, parashtrroi që subjekti i rivlerësimit është prokurori që ka hetuar këtë procedim penal dhe veprimet e tij procedurale janë kryer në zbatim të vendimeve gjyqësore, ndërsa në bisedimet përfundimtare të datës 04.03.2024, Komisioneri Publik ka parashtruar se subjekti i rivlerësimit, në rastin konkret, gjendet në kushtet e verifikimit të mangësive në raport me (i) përballimin e ngarkesës në punë; (ii) kryerjen në mënyrë të efektshme të procedurave hetimore; (iii) kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit të përcaktuar sipas nënindikatorëve të parashikuar nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
62. Subjekti i rivlerësimit, pas njohjes me këtë denoncim, në parashtrimet e datës 26.01.2024, parashtrroi se nisur nga konkluzioni i ekspertëve, në rastin konkret, nuk mund të arrihej në përfundimin se shkrimi dhe nënshkrimi në dokument ish-in të falsifikuar. Ndërsa sa i takon kohëzgjatjes së çështjes, ai ka sqaruar se kjo ka ardhur për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 dhe vakancat apo ndryshimet e shpeshta në organikë të numrit të prokurorëve. Në vijim të shqyrtimit gjyqësor, në parashtrimet e datës 29.02.2024, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se hetimi i këtij procedimi penal është bërë pa shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrin e ndonjë personi nën hetim, për shkak të mungesës së të dhënave në këtë drejtim, referuar nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, kohës së gjatë të kaluar nga prodhimi i dokumentit që binte në afate parashkrimi të ndjekjes penale sipas nenit 66 të Kodit Penal. Në këto kushte, sipas subjektit të rivlerësimit, ka qenë e panevojshme që të interpretohej kompetenca sipas përcaktimeve të neneve 75/a dhe 80 të Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimit nr. 9, datë 10.12. 2019, të Prokurorit të

²⁹ Këto denoncime janë regjistruar në Kolegj me nr. {***}, datë 18.01.2024; nr. {***}, datë 18.01.2024 dhe nr. {***} prot., datë 02.02.2024.

Përgjithshëm, në lidhje me shtetasen F. Sh., me detyrë anëtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në mbështetje të parashtrimeve të datave 26.01.2024 dhe 29.02.2024, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj një sërë aktesh shkresore³⁰, cituar në poshtëshënim.

63. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, të referuar nga denoncuesja F. M. dhe denoncuesi A. Ll., nga aktet e administruara në Kolegj sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë Gjyrokastër, trupi gjykues konstaton se:

63.1 Në referimin e veprës penale të prokurori, të datës 15.09.2019, parashtrohet se: [...] Shtetasja F. M. ka në bashkëpronësi me bashkëshortin e saj A. M., një pasuri të paluajtshme objekt, me sipërfaqe 35 m², me nr. pasurie {***}, me adresë ZK nr. {***}, lagjja “{***}”, Gjyrokastër. Në lidhje me këtë pasuri, në datën 15.02.2005, në zyrën e noteres F. Sh., është përpiluar një kontratë shitjeje, me palë shitëse A. M. dhe blerës A. M.. Kallëzuesja pretendon se në këtë kontratë shitjeje, figuron emri dhe nënshkrimi i saj si person i pranishëm për përpilimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate, ndërkohë që nuk ka qenë e pranishme në momentin e përpilimit të saj, si dhe nuk ka firmosur asnjëherë përpara noteres F. Sh. për përpilimin e kësaj kontrate. [...] Pasuria me sipërfaqe 35 m², sipas kontratës së shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2005, e nënshkruar vetëm me palë shitëse shtetasin A. M., është regjistruar në regjistrin pranë ZVRPP Gjyrokastër në pronësi të A. e E. M.. Në përfundim, nga oficeri i policisë gjyqësore është sugjeruar regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A. M..

63.2 Mbi bazën e këtij materiali kallëzues, prokurori A. P., më datë 11.03.2019, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe regjistrimin e saj në regjistrin përkatës të veprave penale. Në zbatim të urdhrit

³⁰ 1. Kërkesat për pushimin e çështjes penale të datave 11.05.2020, 23.07.2021 dhe 03.02.2023; 2. aktet e ekspertimit nr. {***}, datë 19.07.2019; nr. {***}, datë 09.01.2020 dhe nr. {***}, datë 13.07.2021; 3. shkresa nr. {***}, datë 19.02.2024 e SPAK-ut, me anë të së cilës dërgohet vendimi për mospranimin e akteve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2021, të ardhur për kompetencë nga Prokuroria Gjyrokastër; 4. vendim për mospranimin e akteve, datë 23.06.2024, i SPAK-ut, si dhe shkresa nr. {***}, datë 26.06.2023, e kësaj prokurorie sipas së cilës, për procedimin penal nr. {***} të vitit 2021, i regjistruar nga Prokuroria Gjyrokastër, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, kryer në bashkëpunim, në ngarkim të personave nën hetim B. L., L. H., H. M., M. D., E. L. dhe G. N., është vendosur mospranimi i akteve të procedimit, argumentuar me faktin se: “[...] Prokuroria e Posaçme nuk mund të jetë kompetente për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e kryer nga një punonjës policie, gjatë kohës që ka ushtruar këtë funksion, pavarësisht funksionit që mund të ketë tani”; 5. shkresë nr. {***}, datë 07.02.2024, e SPAK-ut, përmes së cilës informohet subjekti i rivlerësimit se: “Për periudhën 2020-2023, SPAK ka vendosur mospranim të akteve dhe ridërgim për kompetencë pranë Prokurorisë të Rretheve Gjyqësore Gjyrokastër, Tiranë, Sarandë dhe Elbasan për 57 procedime penale [...]”, dhe shkresat nr. {***}, datë 13.06.2022, nr. {***}, datë 09.09.2022, nr. {***}, datë 06.09.2022, nr. {***}, datë 11.09.2023 dhe nr. {***}, datë 26.06.2023, që u përkasin rasteve të ridërguara për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Sarandë, Elbasan dhe Gjyrokastër.

“Për kryerjen e veprimeve hetimore” të datës 12.03.2019, nga prokurori A. P. janë kryer një sërë veprimesh hetimore³¹.

63.3 Subjekti i rivlerësimit është ngarkuar për hetimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, me vendim “Për caktimin e prokurorit” të datës 02.10.2019, të marrë prej tij në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë Gjirokastër. Me marrjen e çështjes, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) më datë 08.10.2019, janë marrë modele shkrimi e nënshkrimi të shtetasës F. M.; (ii) më datë 14.11.2019, është vendosur sekuestrimi i origjinalit të prokurës së posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.05.2018, pranë noterës G. K. dhe sekuestrimi i origjinalit të deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.10.2011, të noterës F. Sh., e ndodhur te noter B. Xh.; (iii) më datë 19.11.2019, janë sekuestruar provat pranë zyrës së noterës G. K.; (iv) më datë 26.11.2019, janë sekuestruar sendet pranë zyrës së noterit B. Xh.; (v) më datë 11.12.2019, është vendosur kryerja e ekspertimit tekniko-grafik, *me qëllim për të provuar pretendimet e shkrimit dhe nënshkrimit të shtetasës F. M., duke krahasuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.10.2011, notere F. Sh. Gjirokastër dhe prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., notere G. K. Gjirokastër, me modelet krahasuese të marra me procesverbalin e datës 08.10.2019, duke thirrur si specialistë, ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore Tiranë, akt ekspertim i cili është përcjellë nga IPSH-ja më datë 10.01.2020; (vi) më datë 21.01.2020, është vendosur kryerja e ekspertimit tekniko-grafik, *me qëllim provimin e pretendimeve se shkrimi dhe nënshkrimi i shtetasës F. M., duke krahasuar me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2005, notere F. Sh. Gjirokastër, dhe me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.12.2004, notere F. Sh., Gjirokastër, me modelet krahasuese të marra me procesverbalin e datës 08.10.2019, duke thirrur si specialistë, ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore Tiranë, akt ekspertim i cili është përcjellë nga IPSH-ja më datë 04.05.2020; (vii) më datë 11.05.2020, është urdhëruar kthimi i sendeve të sekuestruara në zyrat e noterëve B. Xh. dhe G. K..**

63.4 Me kërkesën e datës 11.05.2020, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga gjykata pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, të regjistruar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, duke vlerësuar se nuk rezultuan elemente

³¹ (i) Më datë 2.04.2019, janë marrë deklaratimet e shtetasve E. M. dhe A. M.; (ii) më datë 25.03.2019, janë këqyrrur dhe është marrë në cilësinë e provës materiale, fotokopje e librezës së verbërisë të A. M.; (iii) më datë 17.04.2019, është vendosur sekuestrimi në origjinal pranë ZVRPP Gjirokastër; i kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., depozituar pranë ZVRPP Gjirokastër për regjistrimin e pasurisë {***} ZK {***}, si dhe formulari i aplikimit për regjistrimin e pasurisë nr. {***} ZK {***} në emër të shtetasit A. M.; (iv) më datë 15.04.2019, është kërkuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, kopja e dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. {***}, datë 07.12.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, ankimuar nga F. M.; (v) në datat 21.03.2019; 9.04.2019 dhe 02.05.2019 janë marrë specimentet e shkrimit të shtetasve F. M., A. M. dhe A. M.; (vi) më datë 04.04.2019, janë sekuestruar nga zyra e noterit B. Xh. në cilësinë e provës materiale dy kontratat e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2005 dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.12.2004; (vii) më datë 11.06.2019, është vendosur kryerja brenda datës 30.06.2019, e ekspertimit teknik, duke thirrur ekspertë pranë Institutit të Policisë Shkencore Tiranë, akt ekspertim i cili është përcjellë nga ky institucion më datë 22.07.2019.

të kryerjes së kësaj vepre penale. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 19.01.2021, ka vendosur prishjen e vendimit të pushimit dhe kthimin e çështjes për plotësim hetimesh, duke orientuar hetimin lidhur me: [...] *kryerje të ekspertimit nga një grup ekspertësh të IPSh Tiranë, pasi ekspertimet e marra nuk janë kategorike. Të thirren dhe të pyeten noterja F. Sh. dhe shtetasit A. M. dhe E. M. lidhur me ekzistencën e dy kontratave të ndryshme, por që kanë një numër repertori, koleksioni dhe datë, por mungojnë nënshkrimet dhe forma është e ndryshme.* Këto veprime nga prokurori duhet të kryhen brenda një afati të arsyeshëm.

63.5 Në zbatim të vendimit të gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) më datë 22.04.2021, është vendosur sekuestrimi i praktikave të mbajtura në zyrat e noterëve B. Xh. dhe G. K., praktika të cilat janë sekuestruar më datë 27.04.2021; (ii) më datë 11.05.2021, janë sekuestruar dokumentet nga ASHK Gjirokastër; (iii) më datë 11.05.2021, janë marrë deklaratimet e shtetasve F. Sh.; (iii) më datë 11.05.2021, është vendosur kryerja e ekspertimit grafik nga ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore, i cili është përcjellë nga IPSh-ja më datë 13.07.2021; (iv) më datë 11.05.2021, është vendosur sekuestrimi i kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2005, të noterës F. Sh., Gjirokastër, e arkivuar me numër reference {***}, ZK {***} në ASHK Gjirokastër; (v) më datë 17.05.2021, janë marrë deklaratimet e shtetasve E. M. dhe A. M..

63.6 Me kërkesën e datës 23.7.2021, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar sërish nga gjykata pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, duke vlerësuar se nga tërësia e akteve hetimore të këtij procedimi penal, nuk rezultuan elemente të veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 26.01.2022, ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve të cilat duhet të përfundojnë brenda një afati prej dy muajsh, nga dita kur vendimi të marrë formë të prerë. Gjykata ka orientuar hetimin me: [...] *thirrjen e ekspertëve të IPSh Tiranë, për të dhënë sqarime mbi aktin, si dhe pyetje të bëra nga përfaqësuesja ligjore e kallëzueses në këtë proces dhe analizë më e plotë e rolit të noterës në këtë proces [...].* Ky vendim është ankimuar nga ana prokurorisë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila me vendimin nr. {***}, datë 19.5.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. {***}, datë 26.1.2022.

63.7 Në zbatim të detyrave të caktuara nga gjykata, më datë 31.01.2023, u pyetën ekspertët kriminalistë të Institutit të Policisë Shkencore, Sh. Xh., K. Gj. dhe D. Ç., lidhur me aktin e ekspertimit të përpiluar prej tyre.

63.8 Me kërkesën e datës 3.2.2023, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar sërish nga gjykata pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2019, argumentuar me faktin se nuk rezultuan veprime të kundërligjshme që të përbëjnë elemente të veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 12.5.2023, ka vendosur sërish mospranimin e kërkesës së prokurorit dhe kthimin e akteve për kryerjen e hetimeve të mëtejshme, sipas përcaktimeve në

pjesën arsyetuese të vendimit, duke kërkuar nga organi i akuzës, të procedohet me kërkimin e modeleve të lira të nënshkrimit të shtetases F.M., modele të cilat mundësisht të jenë sa më të afërta në kohë me kohën e nënshkrimeve të pretenduara.

64. Në vlerësim të pretendimeve të denoncueses, nga vëzhgimi i veprimtarisë hetimore, trupi gjykues vëren se referuar tri vendimeve gjyqësore që kanë kontrolluar këtë veprimtari, ajo ka rezultuar e pamjaftueshme në drejtim të zbardhjes së çështjes, edhe pse nuk mund t'i atribuohet tërësisht subjektit të rivlerësimit. Ndonëse subjekti është ngarkuar me trajtimin e çështjes rreth 7 muaj pas regjistrimit të saj dhe ka vijuar me kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, ato përsëri janë gjetur të paplota nga gjykata, e cila pas shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë të përsëritur ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve duke caktuar detyra konkrete për t'u kryer nga organi i prokurorisë. Trupi gjykues vlerëson se veprime hetimore, të tilla si: pyetja e noteres apo thirrja dhe pyetja e ekspertëve të IPSh-së, në kushtet kur nga aktet e ekspertimit grafik nuk mund të merrej një konkluzion i qartë, apo kërkimi i modeleve të lira të nënshkrimit të shtetases F. M. në një kohë sa më të afërt me nënshkrimet e pretenduara si të falsifikuara, ishte e mundur të kryheshin që në fillimet e veprimtarisë hetimore nga subjekti i rivlerësimit dhe të arrihej në një konkluzion prej tij. Sa i takon kohëzgjatjes së çështjes, trupi gjykues konstaton se nga regjistrimi i saj më datë 11.03.2019, deri në paraqitjen e kërkesës së parë për pushimin e procedimit penal më datë 11.05.2020, hetimet paraprake janë shtrirë në një hark kohor prej 1 (një) viti e 2 (dy) muajsh. Për shkak të faktit se emri i personit që i atribuohet vepra penale nuk është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, siç parashikon neni 287 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse të dyshuarit janë evidentuar që në referimin e veprës penale, kjo kohëzgjatje nuk kushtëzohet nga respektimi i ndonjë afati procedural. Edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit i ngritur gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, se hetimi i këtij procedimi penal është bërë pa shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrin e ndonjë personi nën hetim, për shkak të mungesës së të dhënave në këtë drejtim, referuar nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe kohës së gjatë të kaluar nga prodhimi i dokumentit që binte në afate parashkrimi të ndjekjes penale sipas nenit 66 të Kodit Penal, vlerësohet i pabazuar nga trupi gjykues, për sa kohë që në asnjë nga kërkesat për pushimin e procedimit penal, nuk përmendet ky argument, dhe në të gjitha rastet, pushimi i procedimit penal argumentohet me mungesën e elementeve të veprës penale.
65. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se ky procedim penal është mbajtur padrejtësisht nga subjekti i rivlerësimit sepse, referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, kompetencën për hetimin e saj e ka pasur Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për shkak të statusit të posaçëm të znj. F. Sh., nga aktet e fashikullit penal, nuk rezulton që emri i komisioneres të jetë regjistruar në cilësinë e personit që i atribuohet vepra penale, as në fillimet e veprimtarisë hetimore nga prokurori A. P. dhe as me vijimin e mëtejshëm të hetimeve nga subjekti i rivlerësimit. Për sa kohë që znj. Sh. nuk rezulton të ketë marrë cilësinë e personit ndaj të cilit

zhvillohen hetime apo të jetë marrë në përgjegjësi penale, vlerësohet se nuk aplikohen parashikimet e nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale³².

66. Sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, se Kolegji duhet të mbajë në konsideratë ngarkesën e tij dhe situatën e pandemisë nga Covid-19, trupi gjykues, edhe në këtë rast, referuar të dhënave të cituara në paragrafët 25 dhe 26 më sipër, konstaton se në kohështrirjen e hetimeve paraprake të këtij procedimi penal (2019, 2020) për vitin 2020, ngarkesa e subjektit të rivlerësimit ka qenë mbi mesataren e ngarkesës për prokuror në Prokurorinë Gjyrokastër. Ndërkohë, trupi gjykues, sikurse arsyetuar në paragrafin 28 më sipër, ndonëse situata e pandemisë ka përkuar me periudhën e hetimit të këtij procedimi penal gjatë vitit 2020, nuk e gjen atë me një ndikim të tillë që të justifikojë pamjaftueshmërinë e veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit.
67. Në përfundim, lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, të referuar nga denoncuesja F. M., nga verifikimi i veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit, u konstatua një veprimtari e pamjaftueshme hetimore, e konfirmuar edhe nga vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, përmes rrëzimit të tri kërkesave të subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal, vendimmarrje që nuk është kontestuar nga subjekti i rivlerësimit. Këto mangësi konsiderohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, që lidhen me aftësitë profesionale të prokurorit, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C. Çështjet e transferuara nga Komisioni për inspektim organit kompetent

68. Veç sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit ia nënshtroi vlerësimit të tij edhe dy çështjet penale të transferuara nga Komisioni, organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, që u përkasin përkatësisht procedimit penal nr. {***}, datë 1.10.2019, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal, si dhe procedimit penal nr. {***}, datë 16.7.2018, pezulluar me vendimin e datës 07.08.2020 të Prokurorisë Gjyrokastër.

Në lidhje me procedimin penal nr. {} të vitit 2019***

69. Procedimi penal nr. {***} i vitit 2019, i referuar pranë Komisionit nga denoncuesi F. D.³³, është referuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj nga denoncuesi A. Ll.³⁴. Ky procedim penal lidhet me kallëzimin penal të shtetasit Gj. B., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, ndaj djalit

³² Neni 75/a, germa c, përcakton se: “Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura, të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj”.

³³ Denoncim i regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 11.01.2021.

³⁴ Denoncim i regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 22.01.2024.

të tij I. B., ortak në të njëjtën shoqëri, për veprat penale “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, “Fshehje të ardhurash”, të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal dhe “Falimenti i provokuar”, të parashikuar nga neni 193 i Kodit Penal, kallëzim për të cilin prokurori i çështjes Juljan Çafka ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Në denoncimin e paraqitur në Kolegj, përveç pretendimit për mungesë objektiviteti dhe favorizim të palës së kallëzuar, pretendohet se subjekti i rivlerësimit e ka marrë këtë material kallëzues, pa u kryer procedura e shortit, në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, pasi në dosje nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë këtë fakt.

70. Komisioni, për këtë procedim penal, ka arritur në konkluzionin se: [...] *kthimi i çështjes për hetime të mëtejshme i atribuon subjektit mungesën e efektivitetit në përmbylljen e fashikullit hetimor në kohë dhe, për pasojë, duket se ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 96/2016, i aplikueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale, por edhe të kriterëve të përcaktuara në rregulloren për “Sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. 221, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, kundër kriteret dhe kërkesat e përcaktuara si bazë për vlerësimin e aftësive të subjektit të rivlerësimit, është edhe efektiviteti i ushtrimit të ndjekjes penale dhe administrimi i një procedimi penal.*
71. Në ankim, Komisioneri Publik ka parashtruar se gjetjet e Komisionit lidhur me këtë procedim penal, në varësi edhe të rezultateve të hetimit të kërkuara, do të ndikonin në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit. Ndërsa, në bisedimet përfundimtare të datës 04.03.2024, Komisioneri Publik, duke i pranuar si të drejta gjetjet e Komisionit, kërkoi transferimin e procedimit penal nr. {***}, datë 1.10.2019, të Prokurorisë Gjyrokastër, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
72. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 22.02.2024, ka kundërshtuar pretendimin e denoncuesit për mungesë objektiviteti ndaj të kallëzuarit, duke sqaruar fillimisht se për shtetasit Gj. B. dhe I. B., janë regjistruar një sërë procedimesh penale për shkak të kallëzimeve të tyre ndaj njëri-tjetrit, procedime që janë bashkuar në një të vetëm, atë me nr. {***} të vitit 2019. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se vendimi i mosfillimit është marrë duke u dhënë vlerën reale blloqeve të faturave të pamiratuara (të paraqitura nga kallëzuesi), duke i cilësuar ato si shënime të thjeshta, të cilat janë vlerësuar me evoluimin e hetimit të procedimeve penale të këtyre shtetasve. Sipas subjektit, qëndrimin objektiv të mbajtur në këtë çështje, e dëshmon kërkesa për dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të shtetasve Gj. B., I. B. dhe L. B., të depozituar prej tij në Kolegj³⁵. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur së bashku me

³⁵ Me parashtrimet e datës 26.01.2024, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet: (i) kërkesë për dërgimin e çështjes nr. {***} të vitit 2019 në gjyq, të datës 31.08.2021, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të të pandehurve: Gj. B., i akuzuar për veprën penale “Vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal; I. B., akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i kompetencave”, të parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal; dhe L. B., akuzuar për veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, e parashikuar nga neni 180 i Kodit

parashtrimet e datës 22.02.2024, vendimin për bashkimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, me procedimin penal nr. {***} të vitit 2020, në procedimin penal me numër {***} të vitit 2019, si dhe urdhrin e datës 20.05.2020, për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, e parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.

73. Në vijim të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, në parashtrimet e depozituara më datë 29.02.2024, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se kjo çështje është shpërndarë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 53, pika 2 e ligjit. Sipas tij, nuk është ndjekur vetëm procedura e caktimit paraprakisht të materialit kallëzues për tre prokurorë, pasi në prokurori në atë periudhë kanë ushtruar funksionin efektivisht vetëm dy prokurorë, subjekti i rivlerësimit dhe prokurori E. K. dhe se për shkak të numrit të prokurorëve të kësaj prokurorie, nuk kanë funksionuar seksione të ndara. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se prokurori E. K., për shkak të faktit që përfaqësuesi ligjor i kallëzuesit Gj. B. ka qenë avokati A. Ll., i ka kaluar subjektit të rivlerësimit materialin kallëzues nr. {***} të vitit 2019, i cili është pranuar nga subjekti i rivlerësimit, por që nisur nga ngarkesa dhe dinamika e punës, heqja dorë e prokurorit dhe zëvendësimi i tij me subjektin e rivlerësimit nuk është formalizuar me kërkesën për heqjen dorë të prokurorit E. K. dhe me vendimin për pranimin e kësaj kërkesë nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë. Lidhur me këtë fakt, subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit që mungesën e akteve të zëvendësimit të prokurorit, ta vlerësojë në kontekstin e vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese³⁶. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar me parashtrimet e datës 29.02.2024, një sërë aktesh në cilësinë e provës³⁷ dhe ka kërkuar nga Kolegji të mbajë në konsideratë ngarkesën e lartë në punë dhe

Penal; (ii) procesverbal me shkrim dore i mbajtur pranë Prokurorisë Gjyrokastër, më datë 23.01.2020, me objekt problematikat e hasura në lidhje me shtetasit I. dhe Gj. B. (atë e bir).

³⁶ *Vendimi nr. 2, datë 18.01.2017, i Gjykatës Kushtetuese përcakton se: “d) vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”.*

³⁷ *(i) Shkresë nr. {***}, datë 12.02.2024, e Prokurorisë Gjyrokastër, me anë të së cilës i përcillen subjektit të rivlerësimit aktet që pasqyrojnë caktimin e prokurorit me short elektronik për disa materiale kallëzuese dhe akte të tjera të kërkuara prej tij; (ii) akti i nxjerrë nga sistemi CAMS për shortimin e materialit kallëzues nr. {***}/2019, në të cilin evidentohet emri i prokurorit E. K., si prokuror i çështjes; (iii) kërkesë e datës 04.03.2019 për heqjen dorë të prokurorit E. K. nga procedimi penal nr. {***} i vitit 2017, që i përkiste të kallëzuarit K. K. (për veprën penale të mashtrimit), argumentuar me faktin se në datën 21.02.2019, avokati A. Ll. kishte kërkuar zëvendësimin e tij; (iv) vendim “Për shqyrtimin e kërkesës për heqjen dorë të prokurorit”, të drejtuesit të prokurorisë A. P., i datës 05.03.2019, sipas të cilit është miratuar kërkesa e prokurorit E. K. për heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal nr. {***} të vitit 2017; (v) shkresa nr. {***}, datë 27.01.2020, e prokurorisë drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjyrokastër, përmes së cilës është kërkuar të verifikohen fletëdaljet e sekuestruara te subjekti “{***}” ShPK; (vi) shkresa nr. {***}, datë 12.08.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjyrokastër, drejtuar prokurorisë, me anë të së cilës dërgohet “Raport kontrolli”, i mbajtur në subjektin “{***}” ShPK; (vii) urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore të datës 24.01.2020, i subjektit të rivlerësimit për procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, në të cilin përcaktohen për t’u kryer një sërë veprimesh hetimore; (viii) vendim sekuestrimi, datë 24.01.2020, i subjektit të rivlerësimit lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, sipas të cilit janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale, katër blloqet e fletëdaljeve, të cilat gjenden të sekuestruara te materiali kallëzues nr. {***}/2019; (ix) procesverbal sekuestrimi, datë 24.01.2020, i oficerit të policisë gjyqësore, sipas të cilit është ekzekutuar vendimi i sekuestrimit të prokurorit të datës 24.01.2020; (x) urdhër i subjektit të rivlerësimit për lënien në ruajtje të provave materiale (katër blloqe të fletëdaljeve), datë 24.01.2020, lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2019; (xi)*

vakancat në numrin e prokurorëve, cituar më sipër. Subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në diskutimet përfundimtare të datës 04.03.2024, duke kërkuar nga Kolegji të mos konsiderohet si shkelje, fakti i prishjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal nga Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë, ndërsa mungesa e akteve të zëvendësimit të prokurorit të vlerësohet si pasaktësi.

74. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, nga aktet e administruara në Komision gjatë hetimit administrativ dhe nga aktet e administruara në Kolegji sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë Gjirokastrë, trupi gjykues konstaton se:

74.1 Në kallëzimin penal të datës 28.09.2019, të shtetasit Gj. B., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, referohet se: *Gjatë inventarizimit, kam konstatuar që në të njëjtën seli (ambient) ku ushtronte aktivitetin shoqëria “{***}” ShPK, ishte krijuar edhe një shoqëri tjetër e titulluar “{***}”, me numër nipti {***}, me objekt aktiviteti “Tregti e përgjithshme import-eksport, prodhim të rrjetave të telit të thurura dhe të rrjetave të telit të salduara”. [...] kjo shoqëri ka si administrator bashkëshorten e ortakut tim, shtetasen L. B.. [...] gjatë inventarizimit, kam konstatuar se shoqëria “{***}” e ka ushtruar aktivitetin e saj në kundërshtim me ligjin për tatimet dhe Kodin Penal dhe konkretisht: ka shitur produkte të ndryshme objekt të veprimtarisë së shoqërisë “{***}” ShPK në emër të shoqërisë “{***}”, duke shmangur detyrimet tatimore dhe njëkohësisht duke realizuar vjedhje të produkteve të “{***}” ShPK, dhe dërgimin e kësaj shoqërie në gjendje falimenti. Ky fakt vërtetohet me katër blloqe faturash jotatimore, të quajtura “Fletëdalje”. Këto blloqe janë pa numra serie dhe të pamiratuara nga Drejtoria e Tatimeve në Gjirokastrë. [...] Gjithashtu, dua të sqaroj se administratorja e shoqërisë “{***}”, vjedhjet e mësipërme i ka realizuar në bashkëpunim me bashkëshortin e saj I. B., i cili është dhe ortak i shoqërisë “{***}” ShPK.*

74.2 Me marrjen e këtij kallëzimi, Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, pasi ka kryer një sërë veprimesh³⁸, i ka përcjellë më datë 01.10.2019, Prokurorisë Gjirokastrë, materialet procedurale për

*kërkesë për heqjen dorë të prokurorit E. K., e datës 08.01.2020, nga hetimi i procedimit penal nr. {***}/2019, që i përket kallëzuesit I. B., dhe të kallëzuarit, shoqërisë “{***}” ShPK, me përfaqësues ligjor A. Ll.; (xii) vendim i drejtuesit të prokurorisë Juljan Çafka, për shqyrtimin e kërkesës së heqjes dorë të prokurorit E. K. nga procedimi penal nr. {***}/2019, datë 09.01.2020, përmes të cilit ai ka vendosur miratimin e kërkesës së tij; (xiii) shkresa nr. {***}, datë 30.09.2019, e KLP-së, përmes së cilës njoftohet ndërprerja e caktimit në pozicion të përkohshëm e prokurorit S. B. nga Prokuroria Gjirokastrë dhe kthimi i tij në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; (xiv) kërkesë për pushimin e pjesshëm të akuzës në procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, të datës 31.08.2021, me anë të së cilës subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin e pjesshëm të akuzave për veprat penale “Vjedhja”, “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, “Shkatërrimi i pronës” dhe “Falsifikim i dokumenteve”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 134, 135, 155 dhe 186, pasi faktet të cilave këto vepra u referohen, përbëjnë elemente të figurës së veprës penale “Vetëgjyqësi”, të parashikuara nga neni 164 i Kodit Penal, si dhe pushimin e pjesshëm të akuzave për veprat penale “Kundërshtimi i punonjësit që kryen detyrë shtetërore”, “Mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik”, “Njoftim i rremë në organet e rendit publik” dhe “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuara nga nenet 235, 242, 272 dhe 320 të Kodit Penal.*

³⁸ (i) Janë marrë deklaratimet e shtetasit Gj. B., në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale; (ii) janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 4 blloqe “Fletëdalje”, të dorëzuara nga ky shtetas; (iii) janë marrë deklaratimet e shtetasit I. B. dhe L. B.; janë marrë deklaratimet e shtetasit L. B.; (iv) janë këqyruar dhe janë marrë

veprat penale: “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, “Faliment i provokuar” dhe “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuara nga nenet 135, 193 dhe 180 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit I. B., i cili është regjistruar në prokurori si kallëzimi penal nr. {***}/2019.

74.3 Me vendimin e datës 14.10.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se nuk ka elemente të veprës penale, por jemi përpara një marrëdhënieje juridiko-civile. Më tej, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar: [...] *personat e përfshirë në konflikt disa ditë më parë, kanë punuar së bashku në të njëjtat ambiente që nga viti 2002. Të njëjtin pretendim, për të njëjtat vepra penale, të ndodhura në të njëjtat ambiente të shoqërive, ka paraqitur në kallëzimin e tij edhe pala e kallëzuar, I. B. dhe bashkëshortja e tij L. B., të trajtuara në kallëzimin penal nr. {***}/2019. Kallëzimet penale respektive ndaj këtyre shtetasve, të cilët janë gjini e afërt (atë e bir), ka dyshime se janë bërë si kundërpërgjigje e kallëzimeve të palës tjetër.*

74.4 Pas ankimit të shtetasit Gj. B., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 26.02.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe urdhërimin e Prokurorisë Gjirokastrë të regjistrojë kallëzimin penal me nr. {***}, datë 01.10.2019, të ankuesit Gj. B.. Nga përmbajtja e këtij vendimi, vihet re se gjykata ka caktuar disa detyra që duhet të zbatohen nga organi i prokurorisë, konkretisht ajo urdhërohet të regjistrojë procedimin penal nr. {***} të vitit 2019 për veprat penale: “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal; “Falimentimi i provokuar”, parashikuar nga neni 193 i Kodit Penal; “Shpërdorimi i kompetencave”, parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal; “Falsifikimi i nënshkrimeve”, parashikuar nga neni 165 i Kodit Penal; “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal etj., në vlerësim të veprimeve hetimore që do të kryhen. Sipas gjykatës, Prokuroria Gjirokastrë duhet të hetojë në lidhje me kallëzimin penal të shtetasit Gj. B., duke kryer veprimet e nevojshme hetimore, si: *sekuestrimit i provave materiale, siç janë aktet shkresore dhe dokumentet ligjore të shoqërive tregtare, të kryera në kuadër të veprimtarisë tregtare me të tretë, veprimeve tregtare në kuadër të administrimit dhe veprimtarisë përfaqësuese të shoqërive apo çdo dokument tjetër të nevojshëm; të kërkojë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo çdo institucion/agjenci shtetërore; të kërkojë informacion nga bankat e nivelit të dytë; të pyesë administratorët, ortakët, punonjësit e shoqërisë; të marrë vendim për kryerjen e aktit të ekspertimit kontabël apo çdo akti tjetër; si dhe çdo veprim tjetër hetimor që vlerësohet i nevojshëm prej saj.* Në zbatim të këtij vendimi, me urdhrin e datës 20.05.2020, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, e parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.

74.5 Referuar vërtetimit të datës 7.6.2021, lëshuar nga Prokuroria Gjirokastrë, vërtetohet se mbi bazën e kallëzimeve penale të bëra nga shtetasit Gj. B. dhe I. B., janë regjistruar 26 procedime penale, të cilat janë bashkuar në një procedim penal të vetëm, me numër {***}, të vitit 2019, i cili gjendet në fazën e hetimeve paraprake dhe hetohet nga prokurori Juljan Çafka. Ndërsa referuar

*dokumentet e dorëzuara nga shtetasja L. B.: një fotokopje e QKB-së në emër të subjektit “{***}” dhe fotokopje e certifikatës së pronësisë në emër të shtetasit I. B..*

vërtetimit të datës 07.09.2021, lëshuar po nga kjo prokurori³⁹, vërtetohet se me kërkesën e datës 31.08.2021, nga Prokuroria Gjyrokastër, është kërkuar dërgimi në gjyq i çështjes penale nr. {***}, datë 14.10.2019, me të cilin janë bashkuar procedimet e tjera penale⁴⁰, në ngarkim të të pandehurve Gj. B., I. B. dhe L. B.. Me çështjen penale nr. {***}, datë 14.10.2019, ndërmjet të tjerave është bashkuar edhe procedimi penal nr. {***} i vitit 2020, i regjistruar në datën 20.05.2020.

75. Nga vëzhgimi i veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, trupi gjykues konstaton se vendimmarrja e tij për mosfillimin e procedimit penal, është bazuar vetëm në materialet procedurale të përcjella nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjyrokastër, pa u kryer verifikime të mëtijshme nga ana e subjektit të rivlerësimit. Kjo veprimtari është gjetur e mangët dhe e paplotë nga kontrolli gjyqësor i Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër, e cila e ka urdhëruar subjektin e rivlerësimit të regjistrojë procedimin penal, duke i caktuar detyra konkrete, të cilat vlerësohet se duhet të ishin veprimet hetimore bazë të prokurorit në verifikimin e veprave penale të referuara. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka vepruar më pas me regjistrimin e procedimit penal dhe në funksion të hetimit të çështjes, ka përmbushur detyrat e caktuara nga gjykata, ku ndër të tjera ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjyrokastër, lidhur me fletëdaljet e sekuestruara te subjekti “{***}” ShPK, duke disponuar në përfundim të hetimeve paraprake me dërgimin e çështjes në gjykim në ngarkim të të pandehurve, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit që në fillim duhet të kishte kryer verifikime më të plota për blloqet e faturave, të paraqitura nga kallëzuesi në cilësinë e provës materiale që me kallëzimin e tij.
76. Në lidhje me aktin që pasqyron hedhjen e shortit për materialet e kallëzimit penal nr. {***} të vitit 2019, nga dokumentacioni i administruar në Kolegj, trupi gjykues konstaton një fletë printim nga sistemi, në të cilën vihen re të dhëna mbi kallëzimin penal nr. {***}, të referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjyrokastër më datë 1.10.2019. Konkretisht, në rubrikën “emri i prokurorit” që nënkupton emrin e prokurorit të çështjes, rezulton i pasqyruar emri i prokurorit E. K. dhe jo emri i subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që nuk evidentohen akte të tjera mbi mënyrën e kalimit të çështjes te subjekti i rivlerësimit. Në vlerësim të kësaj situatë, trupi gjykues, referuar përcaktimeve të nenit 21, pika 1⁴¹ dhe nenit 53⁴², pika 2 e ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin e prokurorisë në

³⁹ Nënshkruar nga zv/drejtuesi i Prokurorisë Gjyrokastër E. K..

⁴⁰ Procedimet penale nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***} të vitit 2019; nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***} të vitit 2020; si dhe nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***} të vitit 2021.

⁴¹ Në nenin 21, pika 1 përcaktohet: “1. Në çdo prokurori, për kategori të caktuara veprash penale, kur është e mundur dhe e nevojshme, drejtuesi i prokurorisë krijon seksione me jo më pak se tre prokurorë, pasi ka marrë mendimin e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve. Ngritja e tyre bazohet, ndër të tjera, në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin, përhapjen dhe kategoritë e veprave penale, subjekteve, si dhe në rekomandimet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit [...]”.

⁴² Në nenin 53, përcaktohet se: “1. Prokurori i Përgjithshëm përcakton rregulla të detajuara për: a) procedurat e shpërndarjes së çështjeve, të cilat sigurojnë transparencë dhe mundësi të mjaftueshme verifikimi; b) kriteret për shpërndarjen e çështjeve, bazuar në ngarkesën e çështjeve dhe specializimin e prokurorëve; c) rastet dhe kriteret për rishpërndarjen e çështjeve; ç) mënyrën e monitorimit dhe dokumentimit të tyre. 2. Rregullat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, parashikojnë që çështja t’u caktotet paraprakisht të paktën tre prokurorëve, ndërsa caktimi përfundimtar

Republikën e Shqipërisë”, vëren se për organizimin e procedurës së shortit, nevojiteshin të paktën 3 prokurorë. Ndërkohë, referuar të dhënave të cituara në paragrafin 25 më sipër, trupi gjykues vëren se në datën e administrimit të materialit kallëzues nr. {***}, të referuar më datë 01.10.2019 nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, në Prokurorinë Gjirokastër ushtronin efektivisht detyrën vetëm dy prokurorë, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë dhe prokurori E. K. në cilësinë e zv/drejtuesit të prokurorisë⁴³. Në kontekstin e këtyre rrethanave, mungesa e akteve formale lidhur me mënyrën e kalimit të këtij procedimi penal nga prokurori i mëparshëm te subjekti i rivlerësimit, u vlerësua nga trupi gjykues pa ndikim në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

77. Në përfundim, lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, të referuar në Kolegj, jo vetëm përmes ankimit të Komisionerit Publik si një nga dy gjetjet e Komisionit të transferuara pranë organit kompetent, por edhe nga denoncuesi A. Ll., nga verifikimi i veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit u konstatua një vlerësim sipërfaqësor që çoi në vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal, në lidhje me kallëzimin penal nr. {***} të vitit 2019. Këto mangësi, konsiderohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, lidhur me aftësitë profesionale të prokurorit sipas nënindikatoreve të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në lidhje me procedimin penal nr. {} të vitit 2018***

78. Në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2018, të referuar në Komision nga denoncuesja M. Sh., Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar përkushtimin e duhur në drejtim të zbardhjes së situatës në kohë, nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin për mbledhjen e provave dhe nuk ka interpretuar ligjin sipas pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
79. Në ankim, Komisioneri Publik ka parashtruar se gjetjet e Komisionit lidhur me këtë procedim penal, në varësi edhe të rezultateve të hetimit të kërkuara, do të ndikonin në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit. Ndërsa, në bisedimet përfundimtare të datës 04.03.2024, Komisioneri Publik, duke i vlerësuar të drejta gjetjet e Komisionit, kërkoi transferimin e procedimit penal nr. {***}, datë 16.7.2018, të Prokurorisë Gjirokastër, organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
80. Subjekti i rivlerësimit, si në parashtrime, ashtu dhe në diskutimet përfundimtare, ka mbajtur qëndrimin se përkushtimi i tij në këtë procedim penal, ka qenë në nivel optimal. Sipas tij, duhet të konsiderohet se pasaktësia e orës së kërimit të marrjes së pamjeve filmike, është urdhëruar në

të kryhet me short, në mënyrë elektronike. 3. Drejtuesi drejton dhe mbikëqyr procesin e shpërndarjes së çështjeve, bazuar në rregullat e miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm”.

⁴³ *Sipas shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 08.01.2024, të Prokurorisë Gjirokastër drejtuar subjektit të rivlerësimit, në vitin 2019, nga data 27.09.2019 deri më datë 11.02.2020, në këtë prokurori kanë ushtruar detyrën 2 prokurorë.*

mirëbesim (sipas referimit të kryer nga policia gjyqësore), janë ndërmarrë një sërë veprimesh pa neglizhuar dhe pa marrë të mirëqenë thëniet e kallzueses, dhe se pavarësisht mënyrës së kryerjes së veprimeve, mungojnë pasojat (pohimi i denoncueses).

80.1 Nga verifikimi i akteve të procedimit penal nr. {***}, datë 16.07.2018, të administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues, referuar materialeve procedurale të përcjella nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, si dhe “Largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal, konstaton si vijon.

(i) Në informacionin “Për referimin e veprës penale te Prokurori” të datës 13.07.2018, referohet se: *Më datë 12.07.2018, rreth orës 12:00, jam njoftuar nga Salla Operative e Drejtorisë Vendore Gjirokastër se në Spitalin Rajonal Gjirokastër është paraqitur një shtetase për ndihmë mjekësore, e cila pretendon se është goditur nga një automjet. Menjëherë shkoi në spital punonjësi i policisë rrugore për të kontaktuar me shtetasen e dëmtuar, e cila ishte L. Sh.. [...] e cila deklaroi se një automjet i paidentifikuar, me drejtim lëvizjeje nga rrethrotullimi “{***}” për tek {***}, në vendin e quajtur para lokalit të shtetases Z. Ç., e kishte goditur me pasqyrë në krah”.*

(ii) Nga procesverbali i marrjes së të dhënave të shtetases së dëmtuar L. Sh., të datës 12.07.2018, rezulton se shoferi i automjetit e kishte pyetur atë 2-3 herë për gjendjen shëndetësore dhe i kishte ofruar ndihmë për në spital, por ajo ishte përgjigjur se nuk kishte nevojë për ndihmë, ndërkohë që nuk i kujtohej automjeti që i kishte sjellë dëmtime në krah.

(iii) Nga procesverbali i marrjes së të dhënave nga shtetasja S. C. (motra e së dëmtuarës) të datës 12.07.2018, e cila kishte qenë së bashku me motrën e saj kur kishte ndodhur aksidenti, rezulton se shoferi i ishte afruar së dëmtuarës dhe i kishte ofruar ndihmë, por motra e saj nuk kishte pranuar, duke u përgjigjur se nuk kishte nevojë.

(iv) Nga aktndëshmia mjeko-ligjore nr. {***}, datë 12.07.2018, rezulton se nga ekzaminimi i kryer shtetases L. Sh. në urgjencën e spitalit në datën 12.07.2018, ora 11:40, pas mjekimit, gjendja e saj paraqitej e përmirësuar dhe se dëmtimet hyjnë në kategorinë e atyre që sjellin humbje të aftësisë deri në 9 (nëntë) ditë.

80.2 Subjekti i rivlerësimit ka regjistruar më datë 16.07.2018, procedimin penal për veprën penale “Largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal, dhe ka ndërmarrë në vijim veprimet procedurale si vijojnë: (i) me vendime të datave 24.07.2018 dhe 31.07.2018, është vendosur të këqyren dhe të merren pamjet filmike që ndodhen në serverat (DVR) në ABI Bank ShA, në Zyrën Postare të filialit Gjirokastër, në firmën private “{***}” dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër, të ndodhura në lagjen “{***}”, Gjirokastër, për datën 12.07.2018, në orarin 11:30 - 12:30; (ii) më datë 01.08.2018, janë administruar pamjet filmike në orarin 11:30 – 12:30 të Filialit Posta Shqiptare Gjirokastër, ndërsa ABI Bank ShA ka informuar më datë 11.12.2018, se nuk disponoheshin pamje filmike të regjistruara për vitin 2018.

80.3 Në zbatim të urdhrit “Për delegimin e veprimeve hetimore”⁴⁴ të datës 03.09.2018, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) në datën 09.10.2018, janë marrë deklaratimet e shtetasës M. Sh. (e bija e shtetasës L. Sh.); (ii) në datën 17.10.2018, janë marrë deklaratimet e shtetasit B. F.; (iii) në datën 22.10.2018, janë marrë deklaratimet e shtetasit A. Ç., i cili ushtron profesionin e berberit në një lokal pranë vendit të aksidentit dhe deklaratimet e shtetasit K. M., specialist i Policisë Rrugore; (iv) në datën 18.10.2018, janë marrë deklaratimet e shtetasit A. B., shitës ambulant në një lokal pranë vendit të aksidentit; (v) në datën 14.12.2018, janë marrë deklaratimet e shtetasit D. M., punonjësi i Policisë Rrugore; (vi) në datën 03.01.2019, janë marrë deklaratimet e shtetasit E. Xh., përdorues i një automjeti “Mercedes Benz”; (viii) në datën 19.12.2018, janë ballafaquar shtetasit M. Sh. dhe K. M.; (ix) në datën 03.01.2019, janë ballafaquar shtetasit M. Sh. dhe A. Ç.; (x) në datën 13.12.2018, është këqyrur dhe është marrë në cilësinë e provës “{***}” në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë, ku evidentohet njoftimi i orës 11:43 nga Urgjenca e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

80.4 Më datë 10.07.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pezullimin e procedimit penal, me arsyetimin se: *Nga studimi i materialeve të administruara në këtë procedim penal, nuk rezulton se mbetet të kryhet ndonjë veprim tjetër hetimor nga ana jonë, ndonëse nuk është zbuluar autori i kryerjes së veprës penale “Largimi nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal e, për rrjedhojë, çështja penale duhet të pezullohet.* Pas ankimit të shtetasës L. Sh., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 10.09.2019, ka vendosur prishjen e vendimit, datë 10.07.2019, për pezullimin e hetimeve dhe rifillimin e hetimeve. Referuar pjesës arsyetuese të këtij vendimi, gjykata i ka gjetur pjesërisht të gabuar dhe jo saktësisht të zbatuar urdhrat e datave 24.07.2018 dhe 31.07.2018 të Prokurorisë për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve filmike që ndodhen në serverat (DVR) e Abi Bank ShA; firmës private “{***}”; Postës Shqiptare, filiali Gjirokastrë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë, për disa arsye: (i) intervali kohor i cilësuar në to nuk ka asnjë interes për hetimin, sepse i përket kohës rreth 10-15 minuta pas ndodhjes së aksidentit; (ii) përveç procesverbalit për marrjen e pamjeve filmike nga Posta Shqiptare më datë 01.08.2018, i cili edhe në këtë rast është pa një rezultat, nuk gjenden në dosje procesverbale për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve sipas urdhërimit të prokurorit; (iii) nuk rezulton që veprimet e kërkuara të jenë kryer në afatin e përcaktuar nga prokurori, deri më datë 30.07.2018; (iv) nuk është zbatuar plotësisht urdhri i datës 03.09.2018, për marrjen e pamjeve filmike të ambienteve përreth vendit ku ka ndodhur aksidenti, si pamjet e ADISA-s apo NBG Bank ShA, pyetja e shtetasës Z. Ç. apo veprime të tjera që duhet të kryheshin brenda datës 30.10.2018, të cilat jo vetëm brenda kësaj date, por nuk janë kryer asnjëherë. Gjykata ka lënë si detyrë që gjatë

⁴⁴ Përmes këtij urdhri është urdhëruar kryerja e veprimeve procedurale si vijojnë: (i) të administrohet akti i ekspertimit mjeko-ligjor për shtetasen L. Sh.; (ii) të merren pamjet filmike të ambienteve përreth vendit ku ka ndodhur aksidenti; (iii) pas marrjes së pamjeve filmike, të këqyren ato me qëllim identifikimin e mjetit dhe të drejtuesit të tij; (iv) të kryhet ekspertim autoteknik për të përcaktuar shkakun e aksidentit; (v) të pyetet personi që do të identifikohet si drejtues i mjetit që shkaktoi aksidentin; (vi) të pyetet shtetasja Z. Ç.; (vii) të administrohet certifikata personale dhe ajo e gjendjes gjyqësore të të dyshuarit; (viii) të kryhen veprime të tjera që do të dalin gjatë hetimeve, këto veprime të kryhen brenda datës 30.10.2018;

rihetimit të merren pamjet filmike të datës 12.07.2018, ora 11:00 - 11:30, që ndodhen në serverat e Abi Bank ShA, Dega Gjirokastër; Postës Shqiptare, filiali i lagjes “{***}”; Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër; dyqaneve të shtetas Z. Ç.; të ripyeten shtetasit A. Ç., A. B., B. F., K. M.; të pyetet shtetasja Z. Ç., si dhe punonjësit e sigurisë së Postës Shqiptare, Abi Bank ShA dhe ADISA-s, që kanë qenë në shërbim në këto institucione në datën 12.07.2018, ora 11:00 - 11:30, si dhe të identifikohet e të pyetet si person që ka dijeni për ngjarjen, lustraxhiu që punon përpara dyqaneve të shtetas Z. Ç..

80.5 Në zbatim të detyrave të gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprimet si vijojnë: (i) në datat 06.12.2019 dhe 19.02.2020, është kërkuar përkatësisht nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër dhe ABI Bank ShA informacion mbi gjeneralitetet e punonjësve të sigurisë të këtyre institucioneve, që kanë qenë në shërbim në datën 12.07.2019, nga ora 11:00 deri në orën 12:00; (ii) në datën 06.12.2019, janë kërkuar nga Abi Bank ShA, Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër dhe Posta Shqiptare, pamjet filmike të ambientit të jashtëm të këtyre institucioneve të datës 12.07.2018, ora 11:00 - 11:30, dhe për Postën Shqiptare janë kërkuar me të njëjtën shkresë edhe gjeneralitetet e punonjësit të sigurisë më datë 12.07.2018, në orarin 11:00 - 12:00; (iii) janë marrë deklarime nga disa shtetas⁴⁵.

80.6 Më datë 07.08.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur sërish pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2018, me arsyetimin se: *Nga studimi i materialeve të administruara në këtë procedim penal, nuk rezulton se mbetet të kryhet ndonjë veprim tjetër hetimor nga ana jonë, ndonëse nuk është zbuluar autori i kryerjes së veprës penale të “Largimit nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal e, për rrjedhojë, çështja penale duhet të pezullohet.* Pas ankimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin {***}, datë 09.10.2020, ka vendosur rrëzimin e ankimit të ankueses L. Sh. dhe se ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim. Referuar pjesës arsyetuese të këtij vendimi, gjykata ka vlerësuar se nga ana e prokurorisë, janë kryer të gjitha veprimet procedurale dhe për sa kohë nuk është bërë e mundur gjetja e autorit, prokurori me të drejtë ka vendosur pezullimin e procedimit penal.

- 81.** Nga vëzhgimi i veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore për zbardhjen e çështjes, por që fillimisht, sikurse konfirmuar edhe nga vendimi i gjykatës që kontrolloi veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit dhe caktoi detyra konkrete, ato nuk kanë qenë të plota dhe efektive. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se pasaktësia në orën e kërkimit të pamjeve, është urdhëruar në mirëbesim sipas referimit të policisë, nuk e shmang atë nga

⁴⁵ Më datë 05.06.2020, janë marrë deklaratimet e shtetasve Z. Ç., A. Ç., B. F., A. B.; më datë 07.07.2020, janë marrë deklaratimet e shtetasit A. I., roje sigurie tek Abi Bank ShA; më datë 05.08.2020, janë marrë deklaratimet e shtetasit P. L., punonjës i sigurisë fizike të shoqërisë “{***}”; më datë 14.02.2020, janë marrë deklaratimet e shtetasit A. T., punonjës sigurie pranë Postës Shqiptare; më datë 19.02.2020, janë marrë deklaratimet e shtetasit S. D., punonjës sigurie pranë Postës Shqiptare; më datë 17.02.2020, janë marrë deklaratimet e shtetasit E. C., lustraxhi pranë vendit të aksidentit; më datë 28.2.2020, janë marrë deklaratimet e shtetasit K. M.; më datë 26.05.2020, janë marrë deklaratimet e shtetasit T. Z., punonjës sigurie pranë Postës Shqiptare.

përgjegjësia për të analizuar të gjitha materialet procedurale të dërguara nga Drejtoria e Policisë, si p.sh., dëshmia mjeko-ligjore në të cilën referohej një orar i ndryshëm, i cili mund të orientonte më shumë mbi orarin e saktë të aksidentit. Megjithatë, në tërësinë e akteve të procedimit penal, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht faktit se e dëmtuara që në deklarin e parë pohoi se personi që e kishte aksidentuar kishte ndaluar dhe e kishte pyetur për gjendjen e saj, dhe ajo i ishte përgjigjur që nuk kishte nevojë për ndihmë, deklarim i cili është konfirmuar edhe nga motra e saj që e shoqëronte në momentin e ndodhjes së aksidentit, nuk ka neglizhuar, por ka kryer një numër të madh veprimesh hetimore. Gjithashtu, vihet re se pas kthimit të çështjes për hetime të mëtejshme në organin e prokurorisë, subjekti i rivlerësimit ka përmbushur të gjitha detyrat e udhëzuara nga gjykata dhe përsëri ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke kërkuar pezullimin e çështjes, vendimmarrje e cila është gjetur e drejtë edhe nga shqyrtimi gjyqësor pas ankimit të shtetas L. Sh..

82. Në përfundim, në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2018, nga vëzhgimi i veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit, mangësitë e evidentuara në veprimet paraprake hetimore u konsideruan jorelevante në veprimtarinë tërësore të kryer nga subjekti i rivlerësimit për zbardhjen e çështjes.
83. Në vlerësim të trupit gjykues, mangësitë e konstatuara në aspektin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, kryesisht të lidhura me aftësitë organizative dhe të ndërthurura me veprime të pamjaftueshme hetimore, kanë ardhur si rrjedhojë e një sërë faktorësh, të tillë si: (i) numrit të kufizuar të prokurorëve që kanë ushtruar efektivisht detyrën në Prokurorinë Gjyrokastër; (ii) ngarkesës së punës mbi mesataren për prokuror të kësaj prokurorie në vite të caktuara, referuar të dhënave statistikore zyrtare të raportit vjetor “Mbi ngarkesën e punës së prokurorive” të Prokurorit të Përgjithshëm për vitet 2021 dhe 2022; (iii) kompleksitetit dhe veçorive të çështjeve në raste të caktuara dhe detyrat e shtuara për shkak të ushtrimit të funksionit të drejtuesit të Prokurorisë; (iv) kohëzgjatjes së veprimtarisë hetimore që nuk i atribuohet tërësisht subjektit të rivlerësimit, por në disa raste edhe prokurorëve të tjerë të Prokurorisë Gjyrokastër. Këto mangësi nuk duket të kenë cenuar liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve apo, në tërësinë e saj, ushtrimin e ndjekjes penale në emër të interesave shtetërorë, sa kohë procedimet penale përkatëse i janë nënshtruar kontrollit gjyqësor, duke u plotësuar nga subjekti i rivlerësimit detyrat e caktuara e duke vijuar ushtrimi i ndjekjes penale nën mbikëqyrjen gjyqësore.
84. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues konsideron të drejtë konkluzionin e Komisionerit Publik se problematikat e mësipërme, të lidhura vetëm me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, konsiderohen si mangësi që nuk e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm nga pikëpamja e aftësive profesionale, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por janë të një niveli të tillë që mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, brenda një viti. Ky konkluzion ka në konsideratë edhe faktin se referuar vendimit nr. 442, datë 14.09.2021, nga shqyrtimi i çështjes në Komision, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e kontrollit të figurës.

85. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, për situatën faktike dhe ligjore, trupi gjykues çmon se ankimi i Komisionerit Publik duhet të pranohet, me pasojë ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 442, datë 14.09.2021.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin Ë, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 44, shkronja “b” dhe në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 442, datë 14.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka.
2. Pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
3. Ky vendim ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 05.04.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, jam kundër vendimit (JR) nr. 13, datë 05.04.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur: *Ndryshimi i vendimit nr. 442, datë 14.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka. Pezullimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës. Më konkretisht:*

2. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 5.6.2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të adresuar nga Komisioneri Publik:

2.1. Nga aktet e administruara në Kolegj sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastrë, konstatohet se:

2.2. Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë⁴⁶ ka përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë materialet procedurale për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, bazuar në kallëzimin e shtetasit P. V. të datës 31.05.2017⁴⁷.

2.3. Me urdhrin e datës 05.06.2017, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Shpërdorim detyrë”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (*pa emër personi të regjistruar në regjistrin e veprave penale*). Referuar përmbajtjes së këtij urdhri, vihet re se subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në të faktet e kallëzuar në kallëzimin penal të shtetasit P. V., të datës 31.05.2017, si vijojnë: [...] në kallëzimin e tij, shtetasi P. V. dyshon se shefi i INUV Gjirokastrë ka shpërdoruar detyrën me mosveprimet e tij, pasi ka lejuar fillimin dhe vazhdimin e punimeve duke mos marrë asnjë masë për ndalimin e tyre. Arkitekti i cili ka punuar për llogari të Bashkisë Gjirokastrë, duke hartuar planvendosjen e zhvillimit të objektit “Ndërtim i tregut industrial”, në planvendosje ka falsifikuar hartën duke fshirë objekte të ndërtuara dhe duke i pasqyruar ato jo në gjendjen reale, por si rrugë kalimi. Bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet falsifikimit dhe duke shpërdoruar detyrën, ka arritur të miratojë kontraktimin e marrjes me qira të një prone private dhe më pas tenderimin dhe miratimin e ndërtimit të tregut industrial, duke shkelur çdo rregull urbanistik dhe duke kryer procedura tenderimi në mënyrë të dyshimtë [...]. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe nëpunësit e saj kanë ndryshuar hartat duke i falsifikuar ato në favor të pronarit të truallit dhe Bashkisë Gjirokastrë. Gjithashtu, kallëzuesi ka dyshime për miratimin e dhënë nga PMNZSH dhe Ujësjellësi i Gjirokastrës, të cilët, në kundërshtim me ligjin, kanë dhënë miratimin duke treguar se ndërtimi i tregut i plotëson kriteret si nga ana e sigurisë dhe rregullat për mbrojtjen nga zjarri, ashtu edhe kriteret për pajisje dhe furnizime ujë [...].

⁴⁶ Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë ka përcjellë me shkresën nr. {***}, datë 02.06.2017, materialet procedurale mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit P. V.

⁴⁷ Shtetasi P. V. ka vijuar edhe më tej të paraqesë kallëzime penale lidhur me këtë çështje, konkretisht Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë i ka përcjellë Prokurorisë Gjirokastrë materiale procedurale në ngarkim të shtetasit Ll. B., me shkresat nr. {***} prot., datë 05.06.2017, nr. {***} prot., datë 12.06.2017, nr. {***} prot., datë 02.06.2017 dhe nr. {***} prot., datë 13.06.2017, bazuar në kallëzimet në vijim të shtetasit P. V.. Më datë 10.06.2017, ky shtetas ka paraqitur kallëzim penal për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal për shtetasin Ll. B. (pronari i truallit mbi të cilin po kryhej ndërtimi). Më datë 11.06.2017, ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasve K. T., me detyrën e shefit të Policisë Ndërtimore, Bashkia Gjirokastrë; si dhe shtetasit F. Ll. me detyrën e shefit të Policisë Bashkiake, Bashkia Gjirokastrë, për faktin se po lejojnë në mënyrë të kundërligjshme shtetasin Ll. B. të kryejë ndërtim pa leje. Më datë 12.06.2017, ka paraqitur një tjetër kallëzim penal në të cilin kërkon nisjen e hetimeve për z. K. T., me detyrë kryeinspektor i ndërtimit, Bashkia Gjirokastrë dhe për Bashkinë Gjirokastrë.

2.4. Me urdhër “Për delegimin e veprimeve hetimore” të datës 10.06.2017, subjekti i rivlerësimit ka deleguar kryerjen brenda datës 30.09.2017, të veprimeve si vijojnë: (i) të këqyret vendi ku po ndërtohet tregu i qytetit; (ii) të këqyret dhe të merret gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor i ndërtimit; (iii) të kryhet ekspertimi topografik për të përcaktuar pronësinë e objekteve, distancat urbane dhe rrugët e kalimit; (iv) të pyeten kryetari i KKT-së në Bashkinë Gjirokastrë; (v) të pyetet pronari i tokës ku bëhet investimi; (vi) të kryhen veprime të tjera hetimore që do të dalin të nevojshme gjatë hetimeve.

2.5. Në zbatim të këtij urdhri, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: më datë 10.06.2017, janë marrë deklaratimet e shtetasit Ll. B., në cilësinë personit ndaj të cilit zhvillohen hetime për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal; më datë 10.06.2017, janë marrë deklaratimet e shtetasit P. V. (kallëzuesi) dhe është administruar dokumentacioni i paraqitur prej tij; në datat 11.06.2017, 05.07.2017 dhe 28.07.2017, janë marrë gjithashtu deklaratime nga shtetasi P. V.; me vendime “Për kryerjen e këqyrjes” të datës 29.06.2017, është vendosur kryerja e këqyrjes së kopjes së fragmentit të hartës HTR pranë ZVRPP Gjirokastrë për dy pasuritë në pronësi të shtetasit Ll. B. dhe kryerja e këqyrjes së dosjes së plotë për ndërtimin e tregut industrial pranë Bashkisë Gjirokastrë; referuar procesverbaleve “Për këqyrje dhe marrje të dokumenteve” të datës 29.06.2017, janë administruar dokumente (kërkesa për aplikim, relacione, projektvendim për marrjen me qira të truallit me destinacion ndërtimin e tregut, studim për ndërtimin e tregut, planvendosje etj.) nga Bashkia Gjirokastrë; më datë 30.06.2017, janë këqyruar dhe janë marrë dokumente në zyrën e prokurimeve publike pranë Bashkisë Gjirokastrë; më datë 03.07.2017, janë këqyruar dhe janë marrë dokumente nga ZVRPP Gjirokastrë; më datë 17.07.2017, u këqyr vendi i ngjarjes në lagjen “{***}” në qytetin e Gjirokastrës; më datë 28.07.2017, është marrë nga shtetasi P. V., leja e zhvillimit nr. {***}, datë 22.06.2017.

2.6. Veprimtaria hetimore në kuadër të këtij procedimi penal, është shtrirë në vitin 2018, përmes kryerjes së veprimeve hetimore si vijojnë: me vendim “Për kryerjen e këqyrjes” të datës 11.01.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të kryhet këqyrje dhe marrje e akteve në PMNZSH⁴⁸ Gjirokastrë, për dokumentacionin e dorëzuar nga Bashkia Gjirokastrë. Ky vendim është përcjellë në PMNZSH në po këtë datë dhe në zbatim të këtij vendimi, më datë 12.01.2018, është administruar dokumentacioni përkatës pranë PMNZSh-së; me vendim “Për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve filmike” të datës 15.01.2018, është vendosur të këqyren dhe të merren pamjet filmike të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Gjirokastrë. Ky vendim i është përcjellë Televizionit Gjirokastra në po këtë datë; më datë 15.01.2018, është kërkuar nga Bashkia Gjirokastrë lista emërore e anëtarëve të Këshillit Bashkiak Gjirokastrë për legjislaturën 2015-2019, administruar në organin e prokurorisë më datë 18.01.2018; me vendim “Për kryerjen e ekspertimit topografik”, të datës 23.01.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur kryerjen deri më datë 31.01.2018, të ekspertimit topografik, duke thirrur si ekspertë: K. M. dhe Xh. Ll.. Akti i ekspertimit topografik i administruar në dosje mban datën 10.12.2018; më datë 16.04.2018, është sekuestruar harta e punës

⁴⁸ Akronim për “Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”.

e ndodhur në ZVRPP Gjirokastrë, në të cilën ndodhet tregu i ri industrial në lagjen “{***}” dhe me vendim të datës 17.04.2018, subjekti i rivlerësimit ka kryer vleftësimin e sekuestros; më datë 18.04.2018, është urdhëruar kthimi i hartës së punës së ndodhur në ZVRPP Gjirokastrë, e sekuestruar me procesverbalin e datës 16.04.2018; më datë 18.04.2018, u këqyr dhe u mor kopje e fragmentit të hartës kadastrale me indeks harte F8, ku u pasqyrua pasuria nr. {***} ZK {***}, lagjja “{***}”, Gjirokastrë.

2.7. Përgjatë vitit 2019, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: më datë 01.08.2019, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Bashkia Gjirokastrë dokumentacionin e procedurës së tenderimit të truallit të marrë me qira për ndërtimin e tregut. Ky informacion është përcjellë në organin e prokurorisë më datë 16.08.2019; me vendim “Për kryerjen e ekspertimit tekniko-vlerësues”, të datës 15.09.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur kryerjen brenda datës 20.10.2019, të ekspertimit tekniko-vlerësues, duke thirrur ekspertët: A. Ç. dhe L. B.. Në zbatim të këtij vendimi, rezultoi i administruar aktekspertimi i ekspertës L. B., datë 10.06.2020 dhe aktekspertimi i ekspertës A. Ç., datë 7.12.2019.

2.8. Më datë 27.10.2020, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 05.06.2017, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi ka arritur në konkluzionin se nuk ndodhemi përpara kryerjes së veprës penale “Shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ndër të tjera, në këtë vendim, arsyetohet se: *Bashkia Gjirokastrë, duke vlerësuar rëndësinë e ndërtimit të një tregu të ri industrial në një vend sa më afër banorëve, shfrytëzoi atë sipërfaqe truallit e cila ishte bosh në lagjen “{***}”, Gjirokastrë. Në lidhje me çmimin që është vendosur në kontratën e qirasë, sipas ekspertëve, nuk sjell shpërdorim të fondeve publike, apo vlera e vendosur të sjellë përfitime jashtë vlerës së tregut. [...] Lidhur me zhvillimin e pronës, kallëzuesi dhe qiradhënësi kanë lidhur marrëveshje mes tyre për zhvillimin e pronave respektive. Nëse kjo marrëveshje nuk respektohet nga palët, është gjykata civile e cila duhet të shprehet për të.*

2.9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 25.02.2021, ka vendosur mosmiratimin e kërkesës së prokurorit dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve. Në këtë vendim, ndër të tjera, arsyetohet se: *Gjykata vlerëson se ndryshe nga Prokurori, personat të cilët kanë inicuar, lejuar, referuar dhe miratuar procedurën e marrjes me qira të truallit për ndërtimin e tregut të qytetit mbi pasurinë nr. {***}, në pronësi të z. Ll. B., kanë kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokurori duhet të hetojë përgjegjësinë e gjithsecilit, punonjës i Bashkisë Gjirokastrë, i përfshirë në këtë procedurë të kundërligjshme dhe ta vendosë përpara përgjegjësisë penale. Nëse konstatohet veprimtari e kundërligjshme e Kryetarit të Bashkisë, atëherë çështja duhet të referohet për kompetencë në prokurorinë përkatëse, kompetente. Përpara përgjegjësisë ligjore penale, të vihen të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak, të cilët kanë votuar “pro” vendimit për lidhjen e kontratës së qirasë. [...] gjykata konstaton veprime abuzive dhe të kundërligjshme nga administrata e Bashkisë dhe*

ekspertët e kontraktuar apo të referuar nga organi i akuzës, me qëllim fshehjen dhe manipulimin e së vërtetës dhe ndërtimin e tregut me paracaktueshmëri, në pronën e z. Ll. B. [...] grupi i punës i caktuar me vendim të Kryetarit të Bashkisë, nuk ka kryer asnjë procedurë informimi publik dhe dokumentimi të çmimit të tregut, njoftimin, marrjen dijeni dhe dhënien e ofertave nga personat fizikë. Akti i ekspertimit të ekspertit B. A., administruar nga prokuroria, jep të dhëna të ndryshme nga ekspertimet e ekspertëve K. M. dhe Xh. Ll., të verifikohet në terren vërtetësia e këtyre akteve dhe të vihen përpara përgjegjësisë penale ekspertët, të cilët, haptazi dhe me qëllim, kanë bërë ekspertim të rremë, duke dhënë të dhëna jo të vërteta. Arkitekti F. Ç. dyshohet se ka kryer falsifikim dokumentesh, pasi nuk ka treguar në planvendosje, ndërtesën e z. R. B., duke treguar në mënyrë të pavërtetë se në vend të ndërtimit, është rrugë kalimi automjetesh. Ky ekspertim ka shërbyer për dhënien e lejes së shfrytëzimit të pronës, pasi më parë ishte refuzuar nga Kryetari i Bashkisë. Ekspertja vlerësuese A. Ç., vlerësohet nga gjykata se ka kryer një ekspertim jo të saktë, me qëllim mbulimin e së vërtetës dhe të tregohet se çmimi i qirasë së kontraktuar nga Bashkia ishte brenda çmimit të tregut dhe, si pasojë, nuk ka dëm të shkaktuar nga veprimet e Bashkisë Gjirokastër. Veprimet e mësipërme, të dyshuara të kundërligjshme, duhet të hetohen nga prokurori, në funksion të veprimtarisë së çdo personi, i cili, drejtpërdrejt apo në mënyrë indirekte, ka ndikuar, miratuar ose përpjekur të fshehtë, veprimtarinë e kundërligjshme të Bashkisë Gjirokastër në lidhjen e kontratës së qirasë me z. Ll. B..

2.10. Në zbatim të detyrave të caktuara nga gjykata, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore si vijojnë: me vendimin “Për kryerjen e ekspertimit topografik” të datës 02.11.2021, është vendosur të kryhet riekspertimi topografik, ku u caktua ekspert topograf R. B., i cili duhet të paraqesë materialin brenda datës 15.12.2021. Akti i ekspertimit të ekspertit topograf R. B., i administruar në dosje, mban të shënuar datën *dhjetor 2021*; me vendim “Për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve filmike” të datës 02.11.2021, është vendosur këqyrja dhe marrja e pamjeve filmike të mbledhjes së Këshillit Bashkiak Gjirokastër të datës 04.10.2016, pamje të cilat u këqyrën dhe u morën përmes CD-së po në këtë datë; më datë 02.11.2021, u kërkua informacion nga Bashkia Gjirokastër mbi anëtarët e Këshillit Bashkia të cilët kanë votuar “pro” ndërtimit të tregut industrial në lagjen “{***}” etj. Informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar u përcollën më datë 22.11.2021; më datë 16.11.2021, u morën deklaratimet e shtetasit F. Ç., në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale. Veç sa më sipër, në përgjigje të kërkesës së SPAK me nr. {***} prot., datë 1.11.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, ka informuar se pranë kësaj prokurorie është regjistruar procedimi penal nr. {***}, datë 5.6.2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pa autor, dhe se aktualisht ky procedim penal është në fazën e hetimeve shtesë, të lëna detyrë nga gjykata.

2.11. Me kërkesën e datës 16.05.2022, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 05.06.2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi ka arritur në konkluzionin se nga tërësia e akteve hetimore të këtij procedimi penal, nuk rezulton të jetë kryer vepra penale

“Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, dhe duke mos evidentuar elemente të figurës së kësaj vepre penale nga ana e organit të akuzës, nuk janë shtrirë më tej hetimet në drejtim të veprimtarisë së personave konkretë funksionarë apo këshilltarë të kësaj njësie vendore.

2.12. Nga analiza e veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, rezulton se hetimet paraprake lidhur me këtë procedim penal, nga data e regjistrimit të tij më datë 05.06.2017 e deri në datën e kërkesës për pushimin e çështjes të datës 27.10.2020, kanë zgjatur 3 vjet, 4 muaj e 22 ditë. Ndonëse procedimi penal është regjistruar pa emër personi që i atribuohet vepra penale në regjistrin e njoftimit të veprave penale, rrethanë që nuk kushtëzon respektimin e ndonjë afati, edhe pse kallëzuesi ka identifikuar që në kallëzimin e veprës penale disa funksionarë të Bashkisë (shefi i INUV Gjirokastrë, arkitekti) si autorë të dyshuar të veprës penale, duket se subjekti i rivlerësimit e ka zgjatur tej afateve të arsyeshme hetimin e kësaj çështjeje. Nga faktet e përmendura më lart, konstatohen disa periudha kohore, disamujore (28.7.2017 – 11.01.2018; 23.01.2018 – 17.04.2018; 18.4.2018 – 10.12.2018; 10.12.2018 – 1.8.2019 dhe 15.09.2019 – 7.12.2019 dhe 7.12.2019 – 10.06.2020), brenda të cilave nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Po kështu, konstatohet se nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk janë respektuar afatet e caktuara në urdhrat apo vendimet e nxjerra prej tij. Konkretisht, me urdhrin “Për delegimin e veprimeve hetimore” të datës 10.06.2017, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore brenda datës 30.09.2017, ndër të cilat edhe kryerjen një aktekspertimi topografik, ndërkohë që vendimi për kryerjen e këtij aktekspertimi është marrë prej tij më datë 23.01.2018, pra pas katër muajsh, ndërsa aktekspertimi i kryer i përket datës 10.12.2018, pra pas rreth një viti. Një tjetër rast të ngjashëm përbën moskryerja në afat e ekspertimit tekniko-vlerësues, parashikuar për t’u kryer brenda datës 15.09.2019, ndërkohë që këto akte (duke qenë se ekspertët nuk ranë dakord për një akt të vetëm, përgatitën dy akte të veçanta) mbajnë përkatësisht datat 7.12.2019 dhe 10.06.2020.

2.13. Mosveprimi në kohë i subjektit të rivlerësimit ka vijuar edhe pas shpalljes së vendimit të datës 25.02.2021 nga ana e gjykatës, për kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve. Kështu, edhe nëse do të konsideronim të provuar faktin se dosja gjyqësore mbërriti në prokurori më datë 11.05.2021 (sipas kopjes së faqes së parë të fashikullit të gjykatës), duket se subjekti i ka nisur veprimet hetimore me vonesë (më datë 02.11.2021, me marrjen e vendimit për kryerjen e aktit të ekspertimit), pra pas rreth 6 muajsh.

2.14. Për sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kompleksitetin e këtij procedimi penal si në drejtim të volumit të provave dhe fakteve, ashtu dhe në drejtim të aspekteve ligjore që duheshin analizuar, vlerësohet se një pretendim i tillë nuk mbështetet në prova dhe në fakte. Dosja e procedimit penal përbëhet nga tre fashikuj, me një volum të konsiderueshëm fletësh që vjen edhe për shkak të dokumentacionit të përsëritur⁴⁹ (edhe më shumë se dy herë), që i përket procedurës

⁴⁹ Relacioni “Mbi marrjen me qira të një sipërfaqeje trualli 1000 m², me destinacion ndërtimin e tregut të qytetit Gjirokastrë, studimi “Ngritja e tregut të qytetit Gjirokastrë”, vendimi nr. {***}, datë 04.10.2016, për marrjen me qira

së ndërtimit të tregut të ri në Gjirokastrë. Veprimet hetimore të kryera kanë konsistuar më së shumti: *së pari*, në mbledhje dokumentacioni përmes këqyrjes dhe marrjes së informacionit lidhur me procedurën e ndërtimit të tregut të ri Gjirokastrë nga institucione të tilla, si: ZVRPP Gjirokastrë, Bashkia Gjirokastrë, PMNZSh dhe Televizioni i Gjirokastrës, dokumentacion i cili është administruar në organin e prokurorisë brenda një kohe të shpejtë; *së dyti*, në kryerjen e dy akteve të ekspertimit – topografik dhe tekniko-vlerësues (nga dy ekspertë të ndryshëm), të cilat janë kryer përkatësisht në vitet 2018 dhe 2021, si dhe 2019 e 2020; *së treti*, pyetje personash, ku përgjatë gjithë veprimtarisë hetimore, janë marrë deklaratimet e shtetasve P. V. (kallëzuesi), Ll. B. (pronari i truallit mbi të cilin po ndërtohej tregu) dhe shtetasi F. Ç., ky i fundit pas kthimit të çështjes nga gjykata për hetime të mëtejshme. Nisur nga natyra e këtyre veprimeve, vlerësohet se ato nuk përbëjnë veprime që mund të konsiderohen komplekse, për të cilat mund të nevojiten teknika hetimi të veçanta apo të vështira dhe, si të tilla, nuk kërkojnë një angazhim të atillë që të justifikojnë shtrirjen e hetimit në këtë kohëzgjatje.

2.15. Unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se në periudhën e kohëzgjatjes së hetimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, ka pasur një ngarkesë të konsiderueshme pune, nuk e përlligjin mungesën e veprimeve hetimore në periudha të caktuara, mospërbushjen e afateve në kryerjen e detyrave të caktuara prej vetë subjektit të rivlerësimit në urdhrat apo vendimet e nxjerra prej tij, apo nisjen e zbatimit me vonesë të detyrave të caktuara nga gjykata. Edhe lidhur me pretendimin se ka qenë periudhë e COVID-19, rezulton se në periudhën fundore të hetimeve paraprake që përkon me vitin 2020, nuk rezulton të jenë kryer veprime hetimore. Megjithatë, edhe nëse do ta konsideronim situatën e pandemisë si shkak për tejzgjatjen e hetimit të këtij procedimi penal, kjo do të mbulonte vetëm muajt e fundit të kohështirjes së këtij hetimi që i përkasin vitit 2020 deri në muajin tetor të këtij viti, kur u kërkua pushimi i procedimit penal, por gjithsesi kjo nuk mund të justifikojë shtrirjen e hetimeve në një hark kohor prej 3 vitesh, 4 muajsh e 22 ditësh.

2.16. Veç sa më sipër, lidhur me këtë procedim penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale, as në fillimet e veprimtarisë hetimore dhe as me zhvillimin e hetimeve. Sa i takon zbatueshmërisë së përcaktimeve ligjore lidhur me regjistrimin e subjekteve të cilëve u atribuohet vepra penale, referuar nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: *Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale* – nga aktet e dosjes së procedimit penal konstatohet se kallëzuesi ka identifikuar që në fillimet e veprimtarisë hetimore, por edhe gjatë zhvillimit të saj, emrat e disa funksionarëve të Bashkisë, si autorë të dyshuar të veprës penale. Duke mbajtur në konsideratë vendimin nr. 2, datë 20.06.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka elaboruar nocionin “person të cilit i atribuohet vepra penale”, sipas të cilit:

*të truallit me destinacion ndërtimin e tregut të qytetit, leja e zhvillimit nr. {***}, datë 09.06. 2017, dokumente hipotekore etj.*

emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur ai është i njohur, por mund të ketë edhe raste kur, shpeshherë, kallëzuesi apo autoriteti referues nuk është akoma në gjendje të tregojë se kush mund të mendohet si autor i mundshëm i një vepre penale në fillimin e hetimeve dhe se atribuimi i faktit që përbën vepër penale ndaj një personi, nuk do të thotë se personi ka realisht lidhje me veprën penale, duket se subjekti i rivlerësimit mund të kishte regjistruar krahas veprës penale të kallëzuar apo të referuar, edhe emrin e personave të identifikuar nga kallëzuesi, rrethanë që do të kishte kushtëzuar respektimin e një afati procedural. Ndërkaq, nga aktet e dosjes, nuk rezulton që Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të ketë marrë cilësinë e personit që i atribuohet vepra penale, cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime apo të jetë marrë në përgjegjësi penale etj.

2.17. Në konkluzion të analizës së mësipërme, unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se problematika të tilla, si: mungesa e veprimeve hetimore të subjektit të rivlerësimit për periudha të gjata dhe pa arsye të përligjura, mosrespektimi i afateve të caktuara prej tij në aktet procedurale dhe nisja e zbatimit me vonesë të detyrave të caktuara nga gjykata, afektojnë rëndë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit në drejtim të aftësive organizative, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 74, pikat 2 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi gjitha kur bëhet fjalë për një çështje penale, të një natyre jokomplekse në qytetin e vogël të Gjirokastër, dhe mundësia e nxjerrjes së dokumentacionit, pyetjes së dëshmitarëve, si dhe e kryerjes së veprimeve hetimore të tjera, maksimumi mund të zgjaste pak muaj, por jo me vite siç ka vepruar subjekti i rivlerësimit.

3. Lidhur me çështjen e ekzekutimit të dy vendimeve penale në ngarkim të shtetasit K. K., adresuar nga Komisioneri Publik:

3.1. Nga aktet e administruara në Kolegj që i përkasin dy praktikave të referuara nga Komisioneri Publik, sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër, konstatohet se:

3.2. *Me vendimin nr. {***}, datë 26.10.2017*, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit K. K., për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimit gjyqësor”, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 (katër) muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 7.3.2018, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Subjekti i rivlerësimit, me urdhrin nr. {***}, datë 08.5.2018, ka urdhëruar ekzekutimin e këtij vendimi. Mbi këtë urdhër evidentohet vula e protokollit me mbishkrimin: “Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, datë 08.05.2018”. Ky urdhër iu përcoll Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër me shkresën nr. {***} prot., datë 08.05.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër.

3.3. Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.05.2019, i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, materialet për shpalljen në kërkim ndërkombëtar. Kjo e fundit, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.05.2019, pasi ka konstatuar se

bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 14.05.2019, nuk ishte bashkëngjitur praktika për shpalljen në kërkim kombëtar, si procesverbali për kontrollin e vendeve dhe banesës së shtetasit K. K., dhe referuar faktit që në procesverbal shkruhej se “nuk u gjet asnjë send apo provë materiale” e nuk përmendej kërkimi i të dënuarit K. K., i ka kërkuar Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë, që në zbatim të udhëzimit të përbashkët, t’i përcjellë praktikën e ndjekur për shpalljen në kërkim ndërkombëtar, procesverbalet për kërkimet e bëra në shkallë kombëtare me qëllim lokalizimin dhe arrestimin e të dënuarit K. K. etj. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, me shkresën nr. {***} prot., datë 18.06.2019, me lëndë: “Dërgohen materialet për shpalljen në kërkim ndërkombëtar”, i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, materialet përkatëse për shpalljen në kërkim ndërkombëtar. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të ekzekutimit më datë 25.06.2019, ka lëshuar urdhër kërkimi ndërkombëtar për shtetasin K. K.. Ky urdhër është përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme me shkresën nr. {***} prot., datë 25.06.2019.

3.4. Nga praktika dokumentare e vendimit nr. {***}, datë 19.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 19.06.2019, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, të shtetasit nën hetim K. K., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Mashttrimit”, vepër e parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit, me urdhrin e datës 24.06.2019, “Për ekzekutimin e vendimit penal të gjykatës”, në cilësinë e prokurorit të ekzekutimit, ka urdhëruar ekzekutimin e këtij vendimi duke e shpallur shtetasin K. K. në kërkim kombëtar dhe ka ngarkuar për ekzekutimin e tij shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë.

3.5. Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.11.2019, me lëndë: “Njoftim për shpalljen në kërkim ndërkombëtar”, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, ka informuar se nga kërkimet e bëra, nuk është bërë e mundur gjetja e shtetasit K. K. brenda territorit kombëtar, si dhe nga informacionet që disponohen, ky shtetas ndodhet jashtë shtetit shqiptar. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.12.2019, pasi ka konstatuar se shkresës me nr. {***} prot., datë 27.11.2019, nuk i është bashkëngjitur procesverbali për kërkimet e bëra për gjetjen dhe kapjen e tij, në zbatim të udhëzimit të përbashkët, ka kërkuar të vihet në dispozicion praktika e ndjekur për kërkimet e bëra në shkallë kombëtare. Nga aktet në dosje, nuk evidentohet se kur i janë vendosur në dispozicion këto akte Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë. Megjithatë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, më datë 11.12.2019, ka lëshuar “Urdhrin për kërkim ndërkombëtar”, për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit për caktimin e masës së sigurimit në ngarkim të shtetasit K. K..

3.6. Nga analizimi i akteve të mësipërme, konstatohet se për të dyja praktikatat e referuara nga Komisioneri Publik, veprimet procedurale janë kryer nga subjekti i rivlerësimit Julian Çafka, në cilësinë e prokurorit të ekzekutimit. Në drejtim të verifikimit të zbatueshmërisë së legjislacionit në

fuqi, referuar nenit 13 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, vihet re se nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit është atribut i prokurorit. Ky ligj përcakton gjithashtu afatet e nxjerrjes së urdhrin të ekzekutimit dhe vënien e tij në ekzekutim. Më konkretisht, në nenin 22 përcaktohet se: *Vendimet me burgim, me marrjen formë të prerë, i dërgohen prokurorit nga gjykata menjëherë ose tërhiqen prej tij për vënien në ekzekutim.* Më tej, në nenin 23, përcaktohet se: *Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe të veprimeve sipas nenit 22 të këtij ligji, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit dhe ia dërgon Policisë së Shtetit të vendit ku ka vendbanimin, qëndrimin e përhershëm ose vendqëndrimin e të dënuarit.* Ndërsa në nenin 49, pika 2, si afat për kryerjen e veprimeve paraprahe nga ana e prokurorit dhe lëshimin e urdhrin të ekzekutimit në rastin e dënimeve me burgim për të gjykuar në gjendje të lirë, përcaktohet: *jo më vonë se 72 orë nga ardhja e vendimit.* Neni 50 ka parashikuar afatet e fillimit të ekzekutimit, sipas të cilit: *Për urdhrat e ekzekutimit me dënime ose urdhërime të tjera ekzekutimi duhet të fillojë menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga marrja e saj.* Në procedurën e parë, që i përket ekzekutimit të vendimit penal nr. {***}, datë 26.10.2017, i cili është një vendim dënimi me burgim që ka marrë formë të prerë më datë 7.03.2018, konstatohet se urdhri i ekzekutimit të prokurorit Juljan Çafka është lëshuar në të njëjtën datë (08.05.2018) që është administruar vendimi i gjykatës dhe brenda së njëjtës datë, i është përcjellë nga ky i fundit për ekzekutim Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, në përputhje me dispozitat ligjore të mësipërme. Në procedurën e dytë, që i përket ekzekutimit të vendimit penal nr. {***}, datë 19.06.2019, duke qenë se me anë të këtij vendimi është miratuar kërkesa e prokurorit për masën e sigurimit arrest me burg, ekzekutimi i të cilit sipas nenit 21, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998, është i menjëhershëm dhe gjykata i njofton menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit, konstatohet që urdhri i ekzekutimit të këtij vendimi nga ana e prokurorit Juljan Çafka, është lëshuar brenda 5 (pesë) ditëve nga data e vendimit të gjykatës, dhe brenda afatit 15-ditor të parashikuar në nenin 50, paragrafi i dytë i ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar.

3.7. Veprimet e prokurorit lidhur me shpalljen në kërkim ndërkombëtar, afatet dhe institucionet e përfshira në këtë proces, rregullohen nga ligji nr. 10193, datë 03.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar, si dhe gjen rregullim të posaçëm e të detajuar në akte nënligjore, si udhëzimi i përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***} prot., datë 03.06.2010, dhe Ministrisë së Brendshme me nr. {***}, datë 03.06.2010, “Për shpalljen në kërkim ndërkombëtar” (në vijim “udhëzimi i përbashkët”). Në nenin 48 të ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009, në pikat 1, 2 dhe 4 të tij përcaktohet se: *1. Prokurori i ekzekutimit, nëse ka të dhëna se i dënuari nuk gjendet brenda territorit shqiptar, mund të nxjerrë urdhrin për kërkimin ndërkombëtar të tij për qëllime të ekzekutimit të vendimit penal me burgim të formës së prerë. 2. Prokurori i çështjes, nëse ka të dhëna se personi i kërkuar nuk gjendet brenda territorit shqiptar, mund të nxjerrë urdhrin për kërkimin ndërkombëtar të tij për qëllim të ekzekutimit të masës së sigurimit për kufizimin e lirisë personale. [...] 4. Prokurori ia dërgon menjëherë urdhrin e kërkimit ndërkombëtar Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ia përcjell Zyrës së Interpolit për komunikimin ndërkombëtar të urdhrin.* Në udhëzimin e përbashkët përcaktohet se: *6. Drejtoritë e*

Policive në Qarqe ose Komisaritet e Policisë, nga momenti i marrjes së urdhrin të ekzekutimit nga prokurori, garantojnë që strukturat përkatëse të policisë, brenda 3 muajve, duhet të përfundojnë të gjitha veprimet për kërkimin në shkallë kombëtare, me qëllim lokalizimin dhe arrestimin e personit në kërkim. 7. Në përfundim të afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij udhëzimi dhe kur rezulton se personi i kërkuar nuk gjendet brenda territorit kombëtar, drejtoritë e Policisë në qarqe ose Komisaritet e Policisë njoftojnë prokurorin, i cili urdhëron për shpalljen e personit në kërkim ndërkombëtar. [...] Prokurori urdhëron shpalljen e personit në kërkim ndërkombëtar edhe përpara përfundimit të afatit 3-mujor të kërkimit kombëtar, kur strukturat e policisë së shtetit njoftojnë të dhëna mbi lokalizimin jashtë vendit të këtyre personave apo disponojnë informacion mbi largimin e tyre nga Shqipëria. 10. Prokurori i çështjes, apo prokurori i ekzekutimeve penale, brenda 5 ditëve nga marrja e dokumentacionit të plotësuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut apo Komisaritetit të Policisë, materialet bashkëlidhur ia dërgon Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë.

3.8. Në praktikën e parë që lidhet me vendimin gjyqësor nr. {***}, datë 26.10.2017, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të ekzekutimit, ka përcjellë urdhrin e ekzekutimit të këtij vendimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë në të njëjtën datë që ka administruar vendimin gjyqësor, më datë 08.05.2018. Pasi ka marrë dijeni mbi njoftimin për shpallje në kërkim ndërkombëtar më datë 14.05.2019, dhe ka administruar materialet përkatëse nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë më datë 18.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhrin për kërkimin ndërkombëtar më datë 25.06.2019 dhe, në po këtë datë, ky urdhër i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, pra 2 (dy) ditë me vonesë nga afati 5- (pesë-) ditor, i parashikuar në pikën 10 të udhëzimit në fjalë. Në këtë rast, duket se veprimet nga ana e organit të policisë, janë kryer pas 1 (një) viti e 6 (gjashtë) ditësh, pra në tejkalim të afatit 3-mujor, të parashikuar në pikën 6 të udhëzimit të cituar më sipër. Sa i takon praktikës së dytë, që i përket vendimit nr. {***}, datë 19.06.2019, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit më datë 24.06.2019. Ndonëse në dosje nuk evidentohet data e dërgimit të këtij urdhri pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë, konstatohet se kjo e fundit ka përcjellë në prokurori njoftimin mbi faktin që personi nuk gjendet brenda territorit të vendit më datë 27.11.2019. Më datë 05.12.2019, nga organi i prokurorisë, është kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni i plotësuar, dhe referuar kësaj date (në pamundësi të evidentimit të datës se kur është administruar dosja e plotësuar në prokurori), rezulton që urdhër kërkimi ndërkombëtar është nxjerrë nga subjekti i rivlerësimit më datë 11.12.2019, pra 1 (një) ditë me vonesë nga afati 5- (pesë-) ditor dhe, në po këtë datë, i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme.

3.9. Në përfundim të analizës së mësipërme, unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se vonesat 1- (një-) dhe 2- (dy-) ditore, të konstatuara në veprimet për shpalljen në kërkim ndërkombëtar të shtetasit K. K., nga subjekti i rivlerësimit, kanë bërë të mundur, minimalisht, largimin e të kërkuarit nga territori i vendit tonë. Këto afate të tejkaluara nuk mund të krahasohen në numër me afatin e zbardhjes së vendimeve etj., por specifika e rastit në fjalë, kërkon zbatimin e këtyre afateve edhe në

minutat e caktuara, prandaj e çmoj si tendencë të subjektit, për t'i dhënë mundësi të kërkuarit për t'u larguar.

4. *Për procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasit K. K., adresuar nga Komisioneri Publik:*

4.1. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, të referuar në ankimin e Komisionerit Publik, nga aktet e administruara në Kolegj, sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, konstatohet se:

4.2. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, është regjistruar me nr. {***}, datë 28.06.2017, kallëzimi penal i shtetasit A. Ll., në të cilin kallëzohet fakti se shtetasi K. K. ka vjedhur me anë të mashtrimit, një shumë monetare. Po ashtu, ai ka kallëzuar për deklaram të rremë pranë zyrës së ALUIZNI-t Gjirokastër, shtetasit O. dhe Ll. K., me qëllim kalimin e një pasurie nëpërmjet procedurës së legalizimit nga babai i tyre K. K., tek ata.

4.3. Mbi bazën e këtij kallëzimi penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, me urdhër “Për regjistrimin e procedimit penal”, datë 7.7.2017, të prokurorit E. K., ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Mashtrimi”, e parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit K. K.. Me urdhër “Për kryerjen e veprimeve hetimore”, datë 7.7.2017, ky prokuror ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore. Në funksion të hetimit të këtij procedimi penal, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: më datë 11.10.2017, janë marrë deklaramet e kallëzuesit A. Ll., në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale dhe është administruar dokumentacion i paraqitur prej tij; më datë 05.10.2017, është kërkuar informacion nga Zyra e ALUIZNI-t Gjirokastër mbi vetëdeklaramet e shtetasit K. K. dhe familjarëve të tij, që ka përcjellë informacionin e kërkuar më datë 10.10.2017; më datë 02.05.2019, janë këqyruar dhe janë marrë në cilësinë e provës materiale, dokumentet: akt ekspertimi nr. {***}, datë 16.11.2018 dhe CD-ja me audion e seancave gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastër.

4.4. Më datë 10.06.2019, prokurori Juljan Çafka ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për shtetasin K. K.⁵⁰. Në këtë kërkesë, prokurori Juljan Çafka ka arsyetuar se në lidhje me shtetasin Kristaq Kotro, ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e një mase sigurimi personal të karakterit shtrëngues, pasi për këtë person ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova, se ka kryer veprën penale “Mashtrimi” në bashkëpunim më shumë se një herë, i parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

⁵⁰ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 19.06.2019, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, të shtetasit nën hetim K. K., i dyshuar për veprën penale të “Mashtrimit”, vepër kjo e parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. Për ekzekutimin e këtij vendimi, prokurori Juljan Çafka, më datë 24.06.2019, ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal. Ndërsa më datë 11.12.2019, prokurori i ekzekutimit Juljan Çafka ka lëshuar urdhrin e kërkimit ndërkombëtar.

4.5. Më datë 27.06.2019, prokurori Juljan Çafka ka vendosur ndarjen e çështjes penale nr. {***} të vitit 2017 nga çështja, duke regjistruar procedimin penal me nr. {***} të vitit 2017 dhe nr. {***} të vitit 2017. Sipas këtij vendimi, në përfundim të hetimeve paraprake të procedimit penal nr. {***}, datë 7.7.2017, në ngarkim të të pandehurit K. K., i akuzuar për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, ka rezultuar se shtetasi K. K., nëpërmjet mashttrimit, i ka marrë shtetasit A. Ll. vlerën prej 15.000.000 lekësh. Ndërkaq, gjatë hetimeve, ka rezultuar se shtetasi K. K. ka shkuar tek ALUIZNI Gjirokastër dhe ka aplikuar për të legalizuar banesën e ndodhur në fshatin {***}, në emër të vajzës së tij O. K.. Nga ana e prokurorit, janë ngritur dyshime se punonjësit e ALUIZNI-t Gjirokastër, duke shpërdoruar detyrën, kanë kryer deklaram të rremë dhe, në këto kushte, duhet hetuar mbi këto fakte.

4.6. Me vërtetimin e datës 18.09.2019, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, vërtetohet se procedimi penal nr. {***} i vitit 2017 është dërguar me kërkesë për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për veprën penale të “Mashttrimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Gjithashtu, vërtetohet se procedimi penal nr. {***} i vitit 2017 është regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, ku ka dyshime se ALUIZNI Gjirokastër, në bashkëpunim me shtetasin K. K., kanë falsifikuar dokumentin “Vetëdeklarim për legalizim”.

4.7. Në kuadër të hetimit të këtij procedimi penal, gjatë periudhës që çështja është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: më datë 21.10.2019, janë marrë deklaramet e shtetasit A. Ll. në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale; më datë 23.10.2019, janë marrë deklaramet e shtetasit A. K.; më datë 29.10.2019, janë marrë deklaramet e shtetasit A. H. (përmbarues), i cili ka vendosur në dispozicion praktikën e plotë përmbarimore për ekzekutimin e detyrimeve të shtetasit K. K. ndaj A. Ll.; më datë 29.10.2019, është kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Gjirokastër, praktika e legalizimit dhe e regjistrimit të pasurisë nr. {***}, ZK {***} {***}. Dokumentacioni i kërkuar është përcjellë nga ky institucion më datë 27.12.2019; më datë 17.01.2020, janë marrë deklaramet e shtetasit Ll. K. (i biri i K. K.); më datë 24.02.2020, janë kërkuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Gjirokastër, gjenerealitetet e specialistit-jurist pranë ish-drejtorisë së ALUIZNI-t Gjirokastër; më datë 18.9.2020, rikërkohen të dhënat e kërkuara më datë 24.2.2020; ASHK-ja, Drejtoria Vendore Gjirokastër, më datë 31.08.2020, ka përcjellë praktikën dokumentare të vetëdeklarimit të kryer nga O. K. dhe K. K.; më datë 22.07.2021, për nevoja të hetimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, është marrë nga dosja e procedimit penal nr. {***}, viti 2019, procesverbali i deklaramit të shtetasit Ll. K., i datës 17.01.2020; më datë 15.12.2021, janë marrë deklaramet e shtetasit L. B. (punonjëse e ALUIZNI-t); më datë 15.12.2021, është këqyruar dhe është administruar praktika dokumentare e aplikimit pranë zyrës së ish-ALUIZNI-t, Gjirokastër për legalizimin e banesës së vetëdeklaruar për legalizim prej subjektit O. K. dhe Ll. K.; më datë 30.06.2021, janë kërkuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, të dhënat e sistemit TIMS për shtetasit O. K. dhe Ll. K.. Ky institucion ka kthyer përgjigje më datë 05.07.2021; më datë 29.09.2021, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar pyetjen e shtetasit L. B..

4.8. Me kërkesën e datës 05.01.2022, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, të regjistruar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

4.9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 31.03.2022, ka vendosur mospranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, si dhe kthimin e akteve prokurorit për kryerje të hetimeve të mëtejshme, lidhur me veprat penale “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 190/1/3 i Kodit Penal, si dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. Në vlerësimin e gjykatës, kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes nuk është e bazuar në ligj dhe në prova dhe, për këtë shkak, aktet duhet t’i kthehen prokurorit për plotësimin e hetimeve. Gjykata çmon se organi procedues duhet të procedojë lidhur me: *1. Caktimin e një eksperti dhe kryerjen e një akti ekspertimi, me qëllim hetimin e faktit nëse nënshkrimi dhe firma në formularin e deklaratës për përfshirjen në procedurat e legalizimit nr. {***}, datë 3.11.2014, janë nënshkruar ose jo nga shtetasja O. K. dhe në rast se nuk janë nënshkruar prej saj, a është nënshkruar prej shtetasit K. K.? 2. Hetimin e faktit se kur janë hartuar realisht deklaratat nr. {***}, datë 03.11.2014 dhe procesverbali i verifikimit në terren, me index {***}. Për këtë qëllim, përveç veprimeve hetimore që i çmon të nevojshme, organi procedues duhet të marrë informacion nëse deklaratat dhe procesverbali i mësipërm janë administruar në mënyrë digjitale ose fotokopje, nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë së Legalizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, duke marrë nga ky institucion kopje të akteve dhe informacion lidhur me datat e hartimit të këtyre akteve, si dhe subjektet që i kanë nënshkruar këto akte. Gjithashtu, në funksion të hetimit të faktit, organi procedues duhet të marrë nga institucioni përgjegjës nga një kopje të deklaratave dhe procesverbaleve të verifikimit në terren që i kanë paraprirë dhe pasuar në kohë deklaratës nr. {***}, datë 03.11.2014. 3. Të hetohet lidhur me pronarin real të pasurisë mbi të cilën është ndërtuar banesa objekt procedimi penal dhe ka dalë leja e legalizimit, duke marrë informacionin përkatës nga ASHK Gjirokastër. 4. Të pyeten shtetasit O. K. dhe Ll. K., në cilësinë e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, pasi nga aktet nuk rezulton që të jenë pyetur lidhur me faktet objekt procedimi penal. 5. Veç këtyre veprimeve, prokurori mund të kryejë dhe veprime të tjera procedurale të cilat i çmon të nevojshme, në funksion të hetimit të fakteve objekt procedimi penal.* Ndaj vendimit nr. {***}, datë 31.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit. Referuar korrespondencës mes Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresat nr. {***} prot., datë 29.01.2024 dhe nr. {***} prot., datë 05.02.2024, administruar në dosje, procedimi penal nr. {***} i vitit 2017 ndodhet në gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4.10. Nga analiza e veprimtarisë hetimore lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, nga data e regjistrimit të tij më 7.7.2017 deri më datë 5.1.2022 kur është kërkuar pushimi i tij, rezulton se hetimet paraprake janë shtrirë në një hark kohor prej 4 vjetësh, 5 muajsh e 28 ditësh. Pavarësisht nga fakti se emri i të dyshuarve për kryerjen e veprës penale të falsifikimit nuk është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale (edhe pse ka qenë i qartë që në kallëzimin e veprës nga kallëzuesi, që kanë qenë dy fëmijët e shtetasit K. K.), rrethanë që nuk kushtëzon respektimin e ndonjë afati procedural, hetimi i çështjes edhe pse nuk mund t'i dedikohet vetëm subjektit të rivlerësimit, vlerësohet se ka zgatur tej afateve të arsyeshme. Ndonëse në dosje nuk evidentohen akte mbi datën dhe mënyrën e caktimit të subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, nëse do të konsideronim si datë të nisjes së angazhimit të tij në këtë çështje datën 10.06.2019 (akti i parë procedural i nënshkruar prej tij), kohëzgjatja e hetimeve të kryera prej tij deri më datë 5.1.2022, kur u kërkuar pushimi i procedimit penal nr. {***} i vitit 2017, përsëri do të tejkalonte afatin e arsyeshëm, duke zgatur për një periudhë prej 2 vjetësh, 6 muajsh e 25 ditësh. Nga faktet e përmendura më sipër, rezulton se veprimet e para hetimore pas ndarjes së çështjes më datë 27.06.2019, të kryera nga subjekti i rivlerësimit, janë kryer në muajin tetor, pra pas rreth katër muajsh. Ndërkohë që veprimet hetimore të shtrira në tri vite rezultojnë të jenë të rralla dhe që nuk i kalojnë 4 veprime hetimore në një vit. Nga ana tjetër, këto veprime të cilat konsistojnë më së shumti në pyetje personash dhe në mbledhje dokumentacioni, janë të një natyre jokomplekse e të vështirë, që nuk kërkojnë një angazhim të atillë që të justifikojë shtrirjen e hetimeve në një hark kohor prej 2 vitesh, 6 muajsh e 25 ditësh. Për sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit se ndër faktorët që kanë ndikuar në këtë kohëzgjatje kanë qenë edhe ngarkesa në punë dhe pandemia e Covid -19, pavarësisht se (sikurse arsyetuar në analizën e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017) në vitet 2020 dhe 2021, përveç vitit 2019, në të cilat është shtrirë veprimtaria hetimore e këtij procedimi penal, referuar natyrës së veprimeve hetimore të kryera dhe densitetit të tyre, vlerësohet se ato nuk e përlligjin shtrirjen e hetimeve me këtë kohëzgjatje.

4.11. Veç sa më sipër, nga vëzhgimi i veprimtarisë hetimore, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore për zbardhjen e çështjes, por ato nuk kanë rezultuar të plota. Kjo pamjaftueshmëri evidentohet në mungesën e kryerjes së një veprimi hetimor të nevojshëm në rastin e hetimit të veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, siç është akti i ekspertimit, i cili duhet të ishte kryer nga subjekti i rivlerësimit përpara se të urdhërohej nga gjykata. Mungesa e veprimeve hetimore ndonëse nuk mund t'i dedikohet tërësisht subjektit të rivlerësimit, është konfirmuar, edhe pse në mënyrë jopërfundimtare nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që ka kontrolluar veprimtarinë hetimore, e cila ka urdhëruar organin e prokurorisë të vijojë hetimet duke i caktuar detyra konkrete.

4.12. **Në konkluzion të analizës së mësipërme**, unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se kohëzgjatja e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, përtej afatit të arsyeshëm dhe mungesa e një veprimtarie të plotë hetimore, afektojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pikat 2 dhe 3, si dhe në nenin 74, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5. *Për procedimin penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve E. L., F. L. dhe S. L., adresuar nga Komisioneri Publik:*

5.1. Lidhur me procedimin penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve E. L., F. L. dhe S. L., të referuar nga Komisioneri Publik në ankimin e tij, nga aktet e administruara në Kolegj sipas kërkesës drejtuar prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër, rezulton se:

5.2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, me vendimin nr. {***}, datë 12.05.2016, ka vendosur deklarinimin fajtores të së pandehurës E. L., për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi” me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj përfundimisht me 12 vjet burgim. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër me vendimin nr. {***}, datë 28.07.2016. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 26.04.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. {***}, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.

5.3. Në shqyrtim gjyqësor e sipër të çështjes penale në ngarkim të shtetasve E. L., më datë 05.11.2016, shtetasi H. K. ka paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër. Në kallëzimin e tij, ky shtetas parashtron se: *[...] prej vitit 2009 e deri në vitin 2012, djali i tij E. K. ka rënë pre e mashtremeve nga disa persona dhe për këto fakte ai ka bërë kallëzim penal dhe janë proceduar penalisht shtetaset E. L. dhe E. A.. [...] Shtetasja E. L. është dënuar me vendim të formës së prerë me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim, pasi ka përvetësuar përmes mashtimit, nga djali i tij E., një shumë rreth 30.000.000 lekësh. [...] lidhur me paratë që ka përfituar shtetasja E. L., kam për të thënë se edhe kjo shtetase, nëpërmjet familjarëve të saj, ka blerë banesa dhe dyqane në Tiranë dhe familjarët e saj ushtrojnë aktivitet kriminal. Prindërit e E. quhen F. dhe S..*

5.4. Mbi bazën e kallëzimit të shtetasit H. K., subjekti i rivlerësimit, më datë 05.11.2016, ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, dhe shënimin në regjistër të emrave të personave nën hetim: L. A., L. A., F. L., S. L., J. Zh. dhe A. Zh..

5.5. Më tej, me urdhër “Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, të datës 07.06.2017, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar që në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse, për procedimin penal nr. {***} të vitit 2016, të shënohet emri i personit nën hetim, shtetasve E. L., e dyshuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

5.6. Gjatë periudhës së hetimit të këtij procedimi penal, nga aktet e dosjes, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka zgjatur afatin e hetimeve përmes 7 (shtatë) vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve⁵¹.

5.7. Më datë 31.10.2018, subjekti i rivlerësimit ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. {***} të vitit 2016, me të pandehur E. L., F. L. e S. L., të akuzuar për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, dhe ka kërkuar pushimin e pjesshëm të hetimeve të procedimit penal nr. {***}, datë 5.11.2016, për shtetasit J. Zh., A. Zh.,

⁵¹ (i) Me vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 05.02.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve me 3 muaj, duke filluar nga data 05.02.2017 deri më datë 05.05.2017, argumentuar me faktin se për shkak të numrit të madh të veprimeve që duhet të kryheshin (transkriptimit të bisedave telefonike të përgjuara dhe kryerjes së veprimeve të tjera hetimore), nuk u arrit përfundimi i këtij procedimi penal në afat. Për hetimin e mëtejshëm, është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore si vijojnë: të kryhet hetimi i plotë pasuror për të dyshuarit; të administrohen tërësisht bisedat telefonike të përgjuara dhe të kryhet transkriptimi i bisedave telefonike të përgjuara; të kryhen veprime të tjera hetimore. (ii) Me vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 05.05.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.05.2017 deri më datë 05.08.2017. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal, është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: të merren përgjigjet e kompanisë OSHEE lidhur me kontratat e lidhura nga të dyshuarit e të analizohen; më pas, të kërkohet në gjykatë kryerja e kontroleve të banesave për të cilat rezultojnë të lidhura kontratat me OSHEE, të kryhet kontrolli i banesave e të sekuestrohen dokumentacione që kanë të bëjnë me pasuri të paluajtshme të të dyshuarve. (iii) Me vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 05.08.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.08.2017 deri më datë 05.11.2017. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: të bëhet kërkim në banka për shumat që disponojnë A. Zh. e J. Zh.; të bëhet verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar shtetasve F. e S. L.; të bëhet transkriptimi i bisedave të përgjuara të të dyshuarve S. L., F. L. dhe E. L. për ditën e ngjarjes. (iv) Me vendim “Për zgjatjen e afatit të hetimeve” të datës 05.11.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.11.2017 deri më datë 05.02.2018. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal, është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: të bëhet kërkim në banka për shumat që disponojnë A. Zh. e J. Zh.; të bëhet verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar shtetasve F. e S. L.; të bëhet transkriptimi i bisedave të përgjuara të të dyshuarve S. L., F. L. dhe E. L. për ditën e ngjarjes. (v) Me vendim “Për zgjatjen e afatit të hetimeve” të datës 05.02.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.02.2018 deri më datë 05.05.2018. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal, është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: të bëhet kërkim në banka për shumat që disponojnë A. Zh. e J. Zh.; të bëhet verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar shtetasve F. e S. L.; të bëhet transkriptimi i bisedave të përgjuara të të dyshuarve S. L., F. L. dhe E. L. për ditën e ngjarjes. (vi) Me vendim “Për zgjatjen e afatit të hetimeve” të datës 05.05.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.05.2018 deri më datë 05.08.2018. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal, është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: të bëhet kërkim në banka për shumat që disponojnë A. Zh. e J. Zh.; të bëhet verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar shtetasve F. e S. L.; të bëhet transkriptimi i bisedave të përgjuara të të dyshuarve S. L., F. L. dhe E. L. për ditën e ngjarjes. (vii) Me vendim “Për zgjatjen e afatit të hetimeve” të datës 05.08.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të zgjasë afatin e hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 05.08.2018 deri më datë 05.11.2018. Për hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal, është e domosdoshme të kryhen edhe veprime të tjera hetimore si vijojnë: të bëhet kërkim në banka për shumat që disponojnë A. Zh. e J. Zh.; të bëhet verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar shtetasve F. e S. L.; të bëhet transkriptimi i bisedave të përgjuara të të dyshuarve S. L., F. L. dhe E. L. për ditën e ngjarjes.

L. A. e L. A. dhe A. Sh. për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal. Në përmbajtje të kësaj kërkesë, ndër të tjera, parashitohet se: *Nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, është dërguar informacion lidhur me banesën me nr. pasurie {***}, e cila rezulton të jetë blerë nga të dyshuarit F. L. e S. L. me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.07.2012. Pala shitëse ka qenë shtetasi F. R. dhe banesa është blerë kundrejt shumës 4.334.850 lekë, vlerë e cila është likuiduar dhe banesa është 74,1m². Rezulton se kjo pasuri është vendosur në hipotekë për sigurimin e një detyrimi prej 500.000 lekësh që e dyshuara E. L. ka marrë nga Shoqëria e Parë e Zhvillimit Financiar “{***}” ShA. Rezulton se kjo banesë, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.01.2016, është shitur nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë të të dyshuarve F. e S. L., shtetasit K. A., te shtetasi E. B., për shumën 4.149.600 lekë.*

5.8. Më datë 05.12.2018, kallëzuesi H. K., i ka drejtuar organit të prokurorisë një memo, në të cilën i kërkon të vendosë sekuestro të pasurisë nr. {***}, ZK {***} Tiranë, që sipas tij është shitur gjatë hetimeve të shtetasës E. L. me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., dhe është blerë me lekët e produktit të veprës penale.

5.9. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, me vendimin e datës 19.12.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur rrëzimin e saj si të pambështetur në ligj dhe në fakte. Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se: *Së pari, në nenin 36 përcaktohen edhe sendet të cilat i nënshtrohen sekuestrimit e konfiskimit si dënim plotësues. Në këtë nen përcaktohet se çdo lloj pasurie, e cila rrjedh drejtpërdrejt ose tërthorazi nga vepra penale, i nënshtrohet sekuestrimit. Në rastin konkret, rezulton se pasuria me nr. {***}, ZK {***}, është shndërruar në shumë parash të përfituara nga të pandehurit. Sipas paragrafit të dytë të nenit 36 të Kodit Penal, parashikohet se nuk i nënshtrohet sekuestrimit pasuria që është shndërruar, por vetëm produkti final, që është ajo që përfitohet nga shndërrimi. Në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se sekuestro preventive mund të vendoset kur disponimi i lirë i një sendi mund të rëndojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale apo të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Qëllimi i këtij neni është që të mos rëndohen pasojat e veprës penale nga posedimi i sendit apo të mos kryhen vepra penale të tjera. Në këtë rast, bëhet fjalë për persona të përfshirë e të lidhur me veprimtarinë kriminale, e jo për persona të cilët posedojnë sende të përfituara në mënyrë të ligjshme.*

5.10. Ndaj vendimit të prokurorit Juljan Çafka të datës 19.12.2018, paraqiti ankim kallëzuesi H. K., për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 24.01.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së ankuesit, prishjen e vendimit të prokurorit për rrëzimin e kërkesës për vendosje sekuestroje preventive dhe urdhërimin e prokurorit të fillojë procedurën për vendosjen e sekuestros për pasurinë nr. {***} ZK {***}. Në këtë vendim, ndër të tjera, arsyetohet se: *[...] pavarësisht se vepra penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal nuk ka drejtpërdrejt subjekt të dëmtuar, i tillë do të konsiderohet viktima e veprës penale fillestare, produktet e së cilës dyshohet se pasqyrohen nga autorët e dyshuar. Shtetasi H. K. konsiderohet nga gjykata se ka interes dhe mund të paraqesë para prokurorit kërkesa procedurale dhe të ankohet në gjykatë*

kundër vendimeve të prokurorit. Rezulton se kërkohet vendosja sekuestro mbi një pasuri të paluajtshme, blerë nga e dënuara E. L. dhe familjarët e saj, në vitin 2012 dhe tjetërsuar në fillim të vitit 2016, kohë në të cilën është dënuar personi i mësipërm, për veprën penale “Mashtrimi”. Vetëm ky fakt të lind dyshimin për tjetërsim të pronës, për të mos u sekuestruar dhe konfiskuar si produkt i veprës penale. [...] Në rastin konkret, prokurori nuk duhet të nxjerrë përfundime mbi analizën e fakteve të pahetuara. Konkretisht, nuk mund të prezumohet se personi i tretë blerës i pasurisë së paluajtshme në vitin 2016 është në mirëbesim. Qenia ose jo në mirëbesim duhet të hetohet, ku duhet të merren në shqyrtim, ekzistenca ose jo e ndonjë marrëveshjeje për kalimin fiktiv të pasurisë. Duhet hetuar ndonjë lidhje e mundshme mes palëve ndërgjyqëse, si dhe fakti se ku i gjeti lekët për blerjen e pasurisë së paluajtshme, i tretë në një moshë shumë të re. I përfshirë qoftë edhe rastësisht në një fakt të dyshuar kriminal, i tretë ka detyrimin të tregojë burimin e të ardhurave si dhe ligjshmërinë e tyre. Duhet hetuar edhe fakti se kontrata e porosisë është lidhur në emër të E. L. apo prindërve të saj. Si shpjegohet fakti që kjo pasuri në kushtet kur ishte lënë hipotekë për një kredi të marrë nga e dënuara, është tjetërsuar tek persona të tretë. [...] Gjykata vlerëson se për sa kohë do të kryhen hetime mbi transaksionin dhe subjektet e përfshira në të, atëherë duhet që kjo pasuri të sekuestrohet me qëllim kufizimin e tjetërsimit të saj në vazhdimësi. Nëse kjo pasuri do të konfiksohet më pas ose jo, është vlerësim i gjykatës, e cila do të analizojë jo vetëm aspektin penal, por edhe atë civil për vlefshmërinë e një kontrate dhe rregullimin e pasojave të saj [...]. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke kërkuar prishjen e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuarit H. K.. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 21.02.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit të paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, argumentuar me faktin se nga ana e prokurorit A. A., në seancë gjyqësore, është deklaruar heqja dorë nga ankimi i bërë.

5.11. Me kërkesë “Për vendosjen e sekuestros konservative” të datës 24.02.2019, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të vendoset sekuestro konservative mbi pasurinë e paluajtshme apartament banimi me nr. pasurie {***}, ZK {***}, ndodhur në {***}, Tiranë. Pas kërkesës së prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 25.02.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe vendosjen e sekuestros konservative mbi pasurinë e paluajtshme, apartament banimi me nr. pasurie {***} ZK, {***}, {***} Tiranë. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim E. B. dhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 25.04.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 25.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

5.12. Në diskutimet përfundimtare drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar: *Deklarimin fajtorë të së pandehurës E. L., për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e saj me 1 vit burgim. Deklarimin fajtorë të së pandehurës S. L., për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe e pandehura S. L. të vihet në provë, në një afat prej 3 (tre) vjetësh, duke e detyruar të mbajë kontakte*

me Zyrën e Shërbimit të Provës së vendbanimit të saj. Deklarimin fajtor të të pandehurit F. L., për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe i pandehuri F. L. të vihet në provë, në një afat prej 3 (tre) vjetësh, duke e detyruar të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës së vendbanimit të tij.

5.13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 04.03.2021, ka vendosur: *Deklarimin fajtorë të së pandehurës E. L. për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, dhe dënimin e saj me 1 vit burgim. Deklarimin e pafajshme të së pandehurës S. L. për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal, pasi fakti penal nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit F. L. për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal pasi fakti penal nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.*

5.14. Nga analiza e akteve të këtij procedimi penal, nga verifikimet e kryera në drejtim të vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit lidhur me sekuestron e pasurisë dhe vendimmarrjes eventuale të gjykatës, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vendosur sekuestron preventive mbi pasurinë nr. {***}, ZK {***}, ndodhur në {***}, Tiranë, në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 25.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Përpara kësaj, subjekti i rivlerësimit kishte disponuar me rrëzimin e kërkesës së kallëzuesit H. K. për vendosjen e sekuestron mbi këtë pasuri, vendimmarrje e cila u rrëzua nga Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë. Referuar vendimit të kësaj të fundit, ka rezultuar një veprimtari e pamjaftueshme hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit në drejtim të pasurisë me nr. {***} ZK {***}, blerë nga e dënuara E. L. dhe familjarët e saj në vitin 2012 dhe tjetërsuar në fillim të vitit 2016, për të cilën kërkohej vendosja e sekuestron. Kjo pamjaftueshmëri konfirmohet nga detyrat që janë lënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, si vijojnë: *prokurori nuk duhet të nxjerrë përfundime mbi analizën e fakteve të pahetuara. [...] Qenia ose jo në mirëbesim duhet të hetohet, ku duhet të merren në shqyrtim, ekzistenca ose jo e ndonjë marrëveshjeje për kalimin fiktiv të pasurisë. [...] Duhet hetuar ndonjë lidhje e mundshme mes palëve ndërgjyqëse, si dhe fakti se ku i gjeti lekët për blerjen e pasurisë së paluajtshme, i treti në një moshë shumë të re. Duhet hetuar edhe fakti se kontrata e porosisë është lidhur në emër të E. L. apo prindërve të saj [...].* Ndonëse subjekti pas këtij vendimi ka kërkuar vendosjen e sekuestron konservative, vlerësohet se ai vetë duhet ta kishte kërkuar një gjë të tillë në kushtet kur nga hetimet, dyshimet që kjo pasuri ishte tjetërsuar te të tretët me qëllim fshehjen e produktit të veprës penale, që ishin lekët e përfituara me mashtrim nga djali i kallëzuesit, ishin të mëdha. Ky fakt u konfirmua më pas edhe nga gjykata, e cila pranoi vendosjen e sekuestron duke vlerësuar se sendi objekt shqyrtimi duhet të sekuestrohet pasi ekziston rreziku që nëpërmjet transaksioneve të mëtejshme të tij, të kryhen vepra të tjera penale, si dhe përfshihen persona të tretë me keqbesim apo me mirëbesim.

5.15. Lidhur me kohëzgjatjen e veprimtarisë hetimore për këtë procedim penal, konstatohet se hetimet paraprake lidhur me këtë procedim penal, kanë zgjatur nga data 05.11.2016 – 31.10.2018, pra në një hark kohor prej 1 viti, 11 muajsh e 25 ditësh, dhe se subjekti i rivlerësimit ka marrë 7 vendime për zgjatje të afatit të hetimeve. Në zbatim të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale⁵², referuar përmbajtjes së këtyre vendimeve, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar në asnjë prej tyre, se cila prej kërkesave të nenit 324, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale është përmbushur për të justifikuar zgjatjen e afateve të hetimit, në drejtim të argumentimit të kompleksitetit të çështjes, apo të pamundësisë objektive për të përfunduar hetimin brenda afatit të parë tremujor. Madje, në pesë vendimet e fundit, vihet re se arsyet e zgjatjes së afatit të hetimit janë të njëjtat (*copy paste*), dhe duket se janë plotësuar pa pasur ndonjë qëllim të qartë mbi hetimet e mëtejshme.

5.16. Në përfundim të analizës së mësipërme, unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se mungesa e veprimeve të plota hetimore dhe mungesa e arsytimit të vendimmarrjeve për zgjatjen e afatit të hetimeve, afekton aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenet 73, pika 3 dhe 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

6. *Për procedimin penal nr. {***} të vitit 2020, të adresuar nga denoncuesja L. P., në denoncimin e regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 16.01.2024:*

6.1. Denoncuesja L. P., në denoncimin e saj të paraqitur në Kolegj, referon procedimin penal nr. {***} të vitit 2020, për të cilin pretendon se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur pushimin e çështjes penale pa kryer një hetim të plotë.

6.2. Sipas materialeve të administruara, ka rezultuar se më datë 06.02.2020, L. P. ka paraqitur në Prokurorinë Gjyrokastër një kallëzim penal, me pretendimin se vendimi nr. {***}, datë 03.12.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, me të cilin është vendosur pranimi i padisë së shtetasve I. dhe A. Xh., është marrë mbi bazën e vendimit nr. {***}, datë 26.09.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Gjyrokastër, është një akt i falsifikuar. Ajo pretendon se eksperti i caktuar nga gjykata ka shpërdoruar detyrën duke kryer një akt ekspertimi fiktiv, pa u bazuar në asnjë dokument zyrtar dhe provë shkresore.

6.3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër, prokurori Juljan Çafka, më datë 06.02.2020 ka regjistruar procedimin penal nr. {***}/2020, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

⁵² Në nenin 324, përcaktohet se: “1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. 2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë dy vjet. Tej afatit 2-vjeçar, në raste të jashtëzakonshme, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit [...]”.

6.4. Me urdhër “Për delegimin e veprimeve hetimore”, datë 20.02.2020, subjekti i rivlerësimit, i ka urdhëruar/deleguar OPGj-së kryerjen e veprimeve hetimore si vijojnë: të thirret e të pyetet kallëzuesja si person që ka dijeni për veprën penale; të merret vendimi i KKKP Bashkia Gjirokastrë; të merret kopje e akteve të çështjes civile ku është përdorur vendimi; të kryhen veprime të tjera që do të dalin të nevojshme gjatë hetimeve. Këto veprime të kryhen brenda datës 30.06.2020.

6.5. Në zbatim të këtij vendimi, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: më datë 06.05.2020, është kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë kopje e akteve që gjenden në fashikullin gjyqësor për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka dalë me vendimin nr. {***}, datë 03.12.2018. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, më datë 8.5.2020, ka përcjellë aktin e ekspertimit dhe një kopje të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; më datë 05.06.2020, i është kërkuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave kopje e shoqëruar me hartë e vendimit të KKP Bashkia Gjirokastrë nr. {***}, datë 26.09.1996. Ky institucion ka përcjellë informacion më datë 12.06.2020; më datë 01.07.2020, janë marrë deklaratimet e shtetasës L. P. në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale; më datë 01.07.2020, janë kërkuar nga ATP Tiranë, aktet mbi të cilat është marrë vendimi nr. {***}, datë 26.09.1996, i KKK Pronave Bashkia Gjirokastrë, ndodhur në dosjen nr. {***} të vitit 1993. Ky institucion ka përcjellë informacionin e kërkuar më datë 7.7.2020; më datë 20.07.2020, është kërkuar dokumentacioni i arkivuar mbi të cilin është marrë vendimi nr. {***}, datë 26.09.1996, i KKK Pronave Bashkia Gjirokastrë. Ky institucion ka përcjellë dokumentacionin e disponuar më datë 04.08.2020.

6.6. Me kërkesën e datës 13.11.2020, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 06.02.2020, të regjistruar për veprën penale “Shpërdorim detyrë”, e parashikuar nga neni 248, dhe për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 02.03.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit Juljan Cafka, për pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 06.12.2020, të regjistruar për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, duke vlerësuar se çështja ka nevojë për hetime të tjera, duke orientuar: *Prokurori duhet të hetojë në lidhje me vërtetësinë e aktit “notë transkriptimi”. Hetimi duhet të jetë i plotë, duke marrë informacion nga ATP-ja për mënyrën e përdorimit të këtij akti në vendimmarrjet e KKK Pronave Bashkia Gjirokastrë; të hetohet dhe të pyetet çdo person juridik ose fizik që ka dijeni apo ka përdorur këtë notë transkriptimi; të merret informacion nga Arkivi Shtetëror lidhur me ekzistencën e ndonjë regjistri të mundshëm ku të jenë regjistruar ekstremitetet e notës së transkriptimit; të verifikohet vërtetësia e çdo dokumenti tjetër që ndodhet në dosjet e KKK Pronave që ka dhënë vendimin e kontestuar nr. {***}, datë 26.09.1996; të verifikohet koha e shtetëzimit të pronave të pretenduara dhe disponuara në këto vendime. Të verifikohet nëse janë konfiskuar pa shpërblim apo janë shtetëzuar nëpërmjet shpërblimit; të konstatohet ekzistenca e çdo kundërligjshmërie në*

vendimmarrjet e tjera të KK pronave. Duhet të verifikohet dhe evidentohet çdo kundërligjshmëri e mundshme, përdorimi i akteve të falsifikuara dhe të adresohet tek Avokatura e Shtetit për fillimin e procedimit civil për kthimin e pronësisë shtetit.

6.7. Me urdhër “Për delegimin e veprimeve hetimore”, datë 10.04.2021, subjekti i rivlerësimit i ka deleguar Oficerit të Policisë Gjyqësore kryerjen, brenda datës 30.06.2021, të detyrave të përmendura në vendimin e mësipërm të gjykatës, si dhe veprime të tjera që do të dalin gjatë hetimeve.

6.8. Në zbatim të këtij urdhri, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: më datë 7.6.2021, janë pyetur në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale, shtetasit A. A. dhe I. Xh. (palët paditëse në procesin civil); sipas procesverbalit “Për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve”, datë 7.6.2021, janë marrë në cilësinë e provës materiale dokumentet: notë transkriptimi nr. {***}, datë 14.12.1932; notë transkriptimi nr. {***}, datë 10.04.1937; vendim i shtetëzimit i vitit 1949; kontratë e qirasë e vitit 1949; me shkresën nr. {***} prot., datë 31.05.2021, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave lidhur me regjistrin e veçantë, ku mund të regjistrohen notë transkriptimet dhe çdo informacion lidhur me notë transkriptimin e datës 14.12.1932. Ky institucion ka kthyer përgjigje me shkresën nr. {***} prot., datë 10.06.2021.

6.9. Me kërkesën e datës 26.07.2021, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 06.02.2020, të regjistruar për veprën penale “Shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248, si dhe për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 29.10.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës dhe kthimin e akteve prokurorit për të vazhduar hetimet, duke arsyetuar se: *edhe pse gjykata ka vendosur të kryheshin një sërë veprimesh hetimore, prokurori është mjaftuar vetëm me marrjen e deklarimeve të shtetasve A. A. dhe I. Xh.. Prokuroria duhet të kryer ekspertim të vërtetësisë së notës së transkriptimit, duke marrë modele krahasuese të kohës. Ekspertimi duhet të kryhet edhe nëse akti nuk ndodhet në origjinal, por vetëm kopje e vërtetuar. Vërtetimi i kopjeve u jep atyre vlerën e origjinalitetit dhe, si të tilla, duhet të jenë detyrimisht objekt ekspertimi, si në aspektin formal, ashtu dhe në aspektin material, duke ekspertuar çdo element përbërës të tij. Shkrimi i përdorur, si dhe emrat dhe nënshkrimet e personave që kanë përpiluar aktin, mund të krahasohen lehtësisht me dokumente të ngjashme të kohës të marra nga Arkivi Qendror, pavarësisht nëse akti është ose jo origjinal; të verifikohet dhe administrohet nota tjetër e transkriptimit e vitit 1937, sipas deklarimeve të deklaruesit I. Xh..* Më datë 09.02.2022, Prokuroria Gjirokastrë ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. {***}, datë 29.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 14.04.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 29.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke vlerësuar se ka një mungesë hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes: *nuk rezulton të jetë hetuar në lidhje me dokumentin notë transkriptimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.12.1932, pretenduar si i falsifikuar dhe se ai duhet t’i ishte nënshtruar një ekspertimi në*

*lidhje me vërtetësinë e tij; nuk rezulton të jetë hetuar nëse akti notë transkriptimi për të cilin pretendohet se është i falsifikuar, është ose jo i falsifikuar dhe nëse ka shërbyer ose jo për njohjen dhe kthimin e pronës, a është përdorur për të provuar të drejtën e ish-pronësisë në proceset gjyqësore, në kushtet që vendimi i KKK Pronave është objekt i kundërshtimit civilisht. Mbi kërkesën e organit të akuzës, është kërkuar praktika për dhënien e vendimit me nr. {***}, viti 1996, i KKK Pronave, por nuk rezulton të jetë hetuar se kush e ka paraqitur këtë dokument në KKK Pronave, si është siguruar, nga cili institucion ka dalë, ku dhe kur është përdorur ky dokument, përveç njohjes dhe kthimit të pronës në KKK Pronave. Nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim hetimor për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.*

6.10. Në zbatim të detyrave të caktuara nga gjykata, janë kryer veprimet si vijojnë: me vendim të datës 20.04.2023, subjekti i rivlerësimit ka vendosur sekuestrimin e dokumentit “Notë transkriptimi” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.12.1932; më datë 25.04.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë i ka përcjellë Institutit të Policisë Shkencore vendimin e datës 24.4.2023 për kryerje të ekspertimit teknik të dokumentit; më datë 15.05.2023, Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka përcjellë aktekspertimiin tekniko-grafik nr. {***}, datë 12.05.2023.

6.11. Me kërkesën e datës 23.05.2023, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 06.02.2020, të regjistruar për veprën penale “Shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248, dhe për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 26.06.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 06.12.2020, dhe kthimin e akteve prokurorit për të vazhduar hetimet, duke arsyetuar si vijon: *Rezultoni se prokurori ka kryer vetëm ekspertimin grafik të dokumentit, i cili ka rezultuar pa ndërhyrje dhe i punuar në origjinal. Ndërkohë mbetet për t’u vërtetuar nëse ky dokument është prodhuar nga institucionet e kohës dhe punonjësit përkatës. Prokuroria duhet të hetojë nëse dokumenti është lëshuar nga institucione të kohës, duke krahasuar karakteristikat e tij me dokumente të tjera të ngjashme të së njëjtës periudhë, si për sa u përket personave përpilues apo vërtetues të tij, ashtu edhe institucionit që e ka lëshuar. Krahasimi duhet të kryhet me dokumente të tjera të kohës, të cilat do të provojnë si ekzistencën e personave pjesëmarrës në hartimin e dokumentit, vërtetësinë e funksioneve që ata kanë kryer në atë periudhë, duke dalë në përfundimin nëse dokumenti është prodhuar në kohën e pretenduar dhe nga institucionet kompetente. Gjithashtu, gjykata konstaton se nuk është marrë informacion nga arkivi lidhur me kohën e shtetëzimit të pasurive objekt konflikti. Verifikimi i këtij fakti konsiderohet i rëndësishëm për gjykatën, në lidhje me dokumentacionin e përdorur nga pala e akuzuar. Objekt hetimi duhet të jetë edhe kontrata e qirasë e vitit 1949, që lidhet drejtpërdrejt me kohën e shtetëzimit të pronës. E rëndësishme është nëse shtetëzimi jo vetëm që ka ndodhur ose jo në periudhën e pretenduar, por edhe nëse është kryer me shpërblim ose jo.*

6.12. Në vlerësim të pretendimeve të denoncueses, se subjekti i rivlerësimit ka pushuar çështjen pa kryer një hetim të plotë, referuar katër vendimeve gjyqësore që kanë kontrolluar veprimtarinë hetimore të subjektit të rivlerësimit, rezultojnë një veprimtari e pamjaftueshme hetimore e kryer prej tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka rrëzuar tri herë kërkesat e subjektit për pushimin e çështjes dhe ka kërkuar vazhdimin e hetimeve duke caktuar detyra konkrete, madje në një rast kjo veprimtari është kontrolluar edhe nga Gjykata e Apelit dhe është gjetur e paplotë. Ndonëse subjekti i rivlerësimit pas çdo vendimi të gjykatës, ka kryer një numër veprimesh hetimore, ato përsëri nuk janë gjetur të plota e të mjaftueshme nga ana e gjykatës. Sa i takon kohëzgjatjes së çështjes nga regjistrimi i saj më datë 6.2.2020 deri në paraqitjen e kërkesës së parë për pushim më datë 13.11.2020, rezultojnë se çështja ka zgjatur 9 muaj e 7 ditë. Për shkak të faktit që nuk ka emër të dyshuari të shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, siç parashikon neni 287/2 i Kodit të Procedurës Penale, hetimet në këtë rast nuk kushtëzohen nga respektimi i afateve procedurale sipas neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale. Pas vendimit të gjykatës, datë 29.10.2021, i cili mori formë të prerë më datë 14.4.2022, vendim i cili ka urdhëruar kryerjen e hetimeve të mëtejshme hetimore nga ana e subjektit, ndonëse nuk evidentohet data e administrimit të këtij vendimi në organin e prokurorisë, subjekti i rivlerësimit ka nisur kryerjen e veprimeve hetimore më datë 20.04.2023, pra pas rreth 1 viti, që duket një vonesë e konsiderueshme.

6.13. Në konkluzion të analizës së mësipërme, unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se pamjaftueshmëria në veprimtarinë hetimore, e konfirmuar disa herë nga kontrolli gjyqësor, dhe nisja me vonesë e zbatimit të detyrave të caktuara nga gjykata, afekton kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale sipas nënindikatorëve të parashikuar prej nenit 73, pikat 2 dhe 3 dhe nenit 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

7. Për procedimin penal nr. {*} të vitit 2019, adresuar nga denoncuesja F. M., në denoncimin e saj të regjistruar në Kolegj me nr. {***}, datë 30.06.2023:**

7.1. Denoncimi i referohet procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, që lidhet me falsifikimin e një kontrate shitjeje. Sipas denoncueses, po mbushen 4,5 vjet nga regjistrimi i saj dhe nga ana e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të ngarkuar për hetimin e kësaj çështjeje, është dërguar 4 (katër) herë për pushim në gjykatë. Ky procedim penal referohet edhe në tri denoncime të shtetasit A. Ll.⁵³, në të cilat ngrihen pretendime se subjekti i rivlerësimit ka pasur në hetim dhe ka zvarritur për gati 6 vjet çështjen penale të kallëzueses F. M., në ngarkim të komisioneres F. Shuli, lidhur me falsifikimin e një akti noterial, duke e favorizuar këtë të fundit. Sipas denoncuesit, ky procedim penal është mbajtur padrejtësisht nga subjekti i rivlerësimit sepse, referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, kompetencën për hetimin e saj e ka pasur Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për shkak të statusit të posaçëm të komisioneres.

⁵³ Këto denoncime janë regjistruar në Kolegj me nr. {***}, datë 18.01.2024, nr. {***}, datë 18.01.2024 dhe nr. {***} prot., datë 02.02.2024.

7.2. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, të cilit i referohet denoncuesja F. M. dhe denoncuesi A. Ll., nga aktet e administruara në Kolegj sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, konstatohet se:

7.3. Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër ka përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, materialet procedurale në ngarkim të shtetasit A. M., mbi bazën e kallëzimit të shtetasës F. M.. Referuar informacionit të OPGj-së “Mbi referimin e veprës penale te prokurori” të datës 15.01.2019: *shtetasja F. M. është paraqitur dhe ka bërë kallëzim në ngarkim të shtetasit A. M., si dhe bashkëshortes së tij E. M., që ka të bëjë me falsifikimin e një dokumenti, kontratë shitje [...] duke sqaruar se ka në bashkëpronësi me bashkëshortin e saj A. M., një pasuri të paluajtshme objekt me sipërfaqe 35 m², me nr. pasurie {***}, me adresë ZK {***}, lagjja “{***}”, Gjirokastër. Në lidhje me këtë pasuri, në datën 10.02.2005, në zyrën e noteres F. Sh., është përpiluar një kontratë shitjeje me palë shitëse A. M. dhe blerës A. M.. Kjo kontratë mban nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., e cila është e nënshkruar nga shitësi A. M. dhe blerësi A. M.. [...] F. M. pretendon se në këtë kontratë shitjeje figuron emri dhe nënshkrimi i saj si person i pranishëm për përpilimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate. Ndërkohë sqaron se nuk ka qenë e pranishme në momentin e përpilimit të kësaj kontrate, si dhe nuk ka firmosur asnjëherë përpara noteres F. Sh. për përpilimin e kësaj kontrate shitjeje. Referuar këtij informacioni nga oficeri i policisë gjyqësore, është sugjeruar regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar në nenin 186 të Kodit Penal në ngarkim të shtetasit A. M..*

7.4. Mbi bazën e këtij materiali kallëzues, prokurori A. P., më datë 11.03.2019, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe regjistrimin e saj në regjistrin përkatës të veprave penale. Në zbatim të urdhrin “Për kryerjen e veprimeve hetimore” të datës 12.03.2019 nga prokurori A. P., janë kryer një sërë veprimesh hetimore⁵⁴.

⁵⁴ Më datë 2.04.2019, janë marrë deklaratimet e shtetasve A. M., E. M. dhe A. M., në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale; më datë 25.03.2019, janë këqyrrur dhe është marrë në cilësinë e provës materiale fotokopje e librezës së verbërisë të A. M.; më datë 17.04.2019, është vendosur sekuestrimi në origjinal pranë ZVRPP Gjirokastër, i kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., depozituar pranë ZVRPP Gjirokastër për regjistrimin e pasurisë {***} ZK {***}, dhe formulari i aplikimit për regjistrimin e pasurisë nr. {***} ZK {***}, në emër të shtetasit A. M., sende të cilat janë marrë në po këtë datë pranë kësaj zyre; më datë 15.04.2019, është kërkuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, kopja e dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. {***}, datë 07.12.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, ankimuar nga ana e shtetasës F. M.; në datat 21.03.2019; 9.04.2019 dhe 02.05.2019, janë marrë specimentet e shkrimit të shtetasve F. M., A. M. dhe A. M.; më datë 04.04.2019, janë sekuestruar nga zyra e noterit B. Xh., në cilësinë e provës materiale, dy kontratat e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2005 dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.12.2004; me vendim “Për kryerjen e ekspertimit teknik” të datës 11.06.2019, është vendosur kryerja brenda datës 30.06.2019 e ekspertimit teknik, duke thirrur në cilësinë e ekspertit, ekspertë pranë IPSh Tiranë. Më datë 22.07.2019, Instituti i Policisë Shkencore i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër aktekspertimin grafik nr. {***}, të datës 19.07.2019.

7.5. Subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka është ngarkuar me hetimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, me vendimin “Për caktimin e prokurorit” të datës 02.10.2019, të marrë prej tij në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë Gjirokastër. Me marrjen e çështjes në ngarkim, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) më datë 08.10.2019, janë marrë modele shkrimi e nënshkrimi të shtetasës F. M.; (ii) me vendim “Për sekuestrimin e provës materiale” të datës 14.11.2019, është vendosur sekuestrimi i origjinalit “Prokurë e posaçme”, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.05.2018, pranë noterës G. K., si dhe sekuestrimi i origjinalit të “Deklaratës noteriale” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.10.2011, të noterës F. Sh., e ndodhur te noter B. Xh.; (iii) më datë 19.11.2019, janë sekuestruar provat pranë zyrës së noterës G. K.; (iv) më datë 26.11.2019, janë sekuestruar sendet pranë zyrës së noterit B. Xh.; (v) me vendim “Për kryerjen e ekspertimit tekniko-grafik”, të datës 11.12.2019, ka vendosur kryerjen e ekspertimit tekniko-grafik, *me qëllim për të provuar pretendimet se shkrimi dhe nënshkrimi i shtetasës F. M. duke krahasuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.10.2011, notere F. Sh. Gjirokastër dhe prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., notere G. K. Gjirokastër, me modelet krahasuese të marra me procesverbalin e datës 08.10.2019, duke thirrur si specialistë ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore Tiranë. Më datë 10.01.2020, Instituti i Policisë Shkencore i ka përcjellë Prokurorisë Gjirokastër aktin e ekspertimit grafik nr. {***}, datë 09.01.2020; (vi) me vendim “Për kryerjen e ekspertimit tekniko-grafik” të datës 21.01.2020, ka vendosur kryerjen e ekspertimit tekniko-grafik, *me qëllim provimin e pretendimeve se shkrimi dhe nënshkrimi i shtetasës F. M., duke krahasuar me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2005, notere F. Sh., Gjirokastër, dhe me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.12.2004, notere F. Sh., Gjirokastër, me modelet krahasuese të marra me procesverbalin e datës 08.10.2019, duke thirrur si specialistë ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore Tiranë. Nuk përcaktohet afat për kryerjen e aktit të ekspertimit. Më datë 04.05.2020, Instituti i Policisë Shkencore i ka përcjellë Prokurorisë Gjirokastër akt-ekspertimin grafik nr. {***}, datë 30.04.2020; me urdhrat e datës 11.05.2020, është urdhëruar kthimi i sendeve të sekuestruara në zyrat e noterëve B. Xh. dhe G. K..**

7.6. Me kërkesën e datës 11.05.2020 subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, të regjistruar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, duke vlerësuar se nuk ndodhemi përpara kryerjes së kësaj vepre penale.

7.7. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 19.01.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorit, prishjen e vendimit të pushimit dhe kthimin e çështjes për plotësim hetimesh ku, ndër të tjera, ka orientuar hetimin lidhur me: [...] kryerje të ekspertimit nga një grup ekspertësh të IPSH Tiranë, pasi ekspertimet e marra nuk janë kategorike. Të thirren dhe të pyeten noterja F. Sh. dhe shtetasit A. M. dhe E. M. lidhur me ekzistencën e dy kontratave të ndryshme, por që kanë një numër repertori, koleksioni dhe datë, por mungojnë nënshkrimet dhe forma është e ndryshme. Këto veprime nga prokurori duhet të kryhen brenda një afati të arsyeshëm.

7.8. Në zbatim të vendimit të gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore si vijojnë: (i) me vendim “Sekuestrimi” të datës 22.04.2021, është vendosur sekuestrimi i praktikave të mbajtura në zyrat e noterëve B. Xh. dhe G. K.. Këto praktika janë sekuestruar nga zyrat noteriale sipas procesverbaleve përkatëse më datë 27.04.2021, ndërsa më datë 11.05.2021 janë sekuestruar dokumentet nga ASHK Gjirokastër; (ii) më datë 11.05.2021, janë marrë deklaratimet e shtetasve F. Sh. në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale; (iii) me vendim “Për kryerjen e ekspertimit teknik grafik” të datës 11.05.2021, është vendosur kryerja e ekspertimit grafik nga grup ekspertësh duke thirrur si specialistë ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore”, që duhet të kryhet brenda një afati 20-ditor. Më datë 13.07.2021, Instituti i Policisë Shkencore i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjiroqësor Gjirokastër “Akt ekspertimi grafik” nr. {***}, datë 13.07.2021; (iv) me vendim “Sekuestrimi”, datë 11.05.2021, është vendosur sekuestrimi i kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.02.2005, notere F. S., Gjirokastër, kontratë e cila është arkivuar me numër reference {***}, ZL {***}, ndodhur në ASHK Gjirokastër; (v) më datë 17.05.2021, janë marrë deklaratimet e shtetasve E. M. dhe A. M. në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale.

7.9. Me kërkesën e datës 23.7.2021, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, duke vlerësuar se nga tërësia e akteve hetimore të këtij procedimi penal, nuk ndodhemi përpara veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

7.10. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 26.01.2022, ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve të cilat duhet të përfundojnë brenda një afati prej dy muajsh nga dita kur vendimi të marrë formë të prerë. Gjykata ka orientuar hetimin: *[...] thirrjen e ekspertëve të IPSh Tiranë për të dhënë sqarime mbi aktin, si dhe pyetje të bëra nga përfaqësuesja ligjore e kallëzueses në këtë proces dhe analizë më e plotë e rolit të noterës në këtë proces [...].* Ky vendim është ankimuar nga ana prokurorisë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila me vendimin nr. {***}, datë 19.5.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. {***}, datë 26.1.2022.

7.11. Në zbatim të detyrave të caktuara nga gjykata, më datë 31.01.2023, u pyetën ekspertët kriminalistë të Institutit të Policisë Shkencore Sh. Xh., K. Gj. dhe D. Ç., lidhur me aktin e ekspertimit të përpiluar prej tyre.

7.12. Subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës 3.2.2023, ka kërkuar sërish nga gjykata pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2019. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, me vendimin nr. {***}, datë 12.5.2023, ka vendosur sërish mospranimin e kërkesës së prokurorit dhe kthimin e akteve për kryerjen e hetimeve të mëtejshme sipas përcaktimeve në pjesën arsyetuese të vendimit: *duke kërkuar nga organi i akuzës të procedohet me kërkimin e modeleve të lira të nënshkrimit të shtetasve F. M., modele të cilat mundësisht të jenë sa më të afërta në kohë me kohën e nënshkrimeve të pretenduara.*

7.13. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit është ngarkuar me trajtimin e çështjes rreth 7 muaj pas regjistrimit të saj dhe ka vijuar me kryerjen e veprimeve hetimore, ato përsëri janë gjetur të paplota nga gjykata, e cila pas shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë të përsëritur ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve duke caktuar detyra konkrete për t'u kryer nga organi i prokurorisë. Edhe sa i takon kohëzgjatjes së çështjes, nga regjistrimi i saj më datë 11.03.2019 deri në paraqitjen e kërkesës së parë për pushim më 11.05.2020, hetimet janë shtrirë në një hark kohor prej 1 viti e dy muajsh. Kjo kohëzgjatje, për shkak të faktit se emri i të dyshuarit që ka kryer veprën penale nuk është shënuar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, siç parashikon neni 287, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse ka qenë e qartë që në referimin e veprës, se të dyshuarit ishin shtetasit A. M. dhe E. M., nuk kushtëzohet nga respektimi i ndonjë afati procedural. Ndërkaq vihet re se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar veprim të shpejtë në drejtim të përmbushjes së detyrave të caktuara nga autoriteti gjyqësor dhe brenda afatit. Kështu, pas vendimit gjyqësor të datës 26.01.2022, i cili ka marrë formë të prerë më datë 19.05.2022, që parashikonte një afat 2- (dy-) mujor për kryerjen e detyrave nga data që do të merrte formë të prerë, pavarësisht se nuk evidentohet data e administrimit të këtij vendimi në organin e prokurorisë, duket se subjekti i rivlerësimit i ka nisur veprimet hetimore më datë 31.01.2023, pra pas rreth 8 muajsh.

7.14. **Në përfundim të analizës së mësipërme**, unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se pamjaftueshmëria në veprimtarinë hetimore, e konfirmuar disa herë nga kontrolli gjyqësor dhe nisja me vonesë e zbatimit të detyrave të caktuara nga gjykata, afektojnë kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale sipas nënindikatoreve të parashikuar prej nenit 73, pikat 2 dhe 3 dhe nenit 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

8. *Për procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, të adresuar nga denoncuesi A. Ll. në denoncimin e tij të regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 22.01.2024:*

8.1. Denoncimi i referohet kallëzimit penal nr. {***} të vitit 2019 të shtetasit Gj. B., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, ndaj djalit të tij I. B., ortak në të njëjtën shoqëri, për veprat penale “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, “Fshehje të ardhurash”, të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal dhe “Falimenti i provokuar”, të parashikuar nga neni 193 i Kodit Penal, kallëzim për të cilin prokurori i çështjes Juljan Çafka ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Sipas denoncuesit, subjekti i rivlerësimit e ka marrë pa short këtë material kallëzues, në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, pasi në dosje nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë këtë fakt, dhe se ai ka arritur në konkluzionin e mungesës së elementeve të veprës penale pa kryer veprime hetimore, duke favorizuar të kallëzuarin.

8.2. Pretendimet e ngritura në këtë denoncim, përveç atyre që lidhen me shortimin e çështjes, të paraqitura për herë të parë në Kolegj, janë trajtuar edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, ku ky i fundit, pasi e ka gjetur si mangësi të subjektit të rivlerësimit mosregjistrimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin e shtetasit Gj. B., ka vendosur transferimin e çështjes pranë organit

kompetent për inspektim të shkeljeve të mundshme disiplinore.

8.3. Lidhur me materialin kallëzues nr. {***} të vitit 2019, të cilit i referohet denoncuesi, nga aktet e administruara në Kolegj, sipas kërkesës drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, konstatohet se Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, më datë 01.10.2019, i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër materialet procedurale për veprat penale “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, “Faliment i provokuar” dhe “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuara nga nenet 135, 193 dhe 180 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit I. B., nga të cilat rezulton se:

8.4. Më datë 28.09.2019, shtetasi Gj. B., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, ka paraqitur një kallëzim penal, në të cilin ka informuar se së bashku me djalin e tij I. B. janë ortakë në këtë shoqëri, objekti i së cilës është: “Tregti e përgjithshme import-eksport, prodhim i rrjetave të telit të thurura dhe i rrjetave të telit të salduara”. Më tej, ai shprehet se: *Gjatë inventarizimit, kam konstatuar që në të njëjtën seli (ambient) ku ushtronte aktivitetin shoqëria “{***}” ShPK, ishte krijuar edhe një shoqëri tjetër, e titulluar “{***}”, me numër nipti {***}, me objekt aktiviteti: “Tregti e përgjithshme import-eksport, prodhim i rrjetave të telit të thurura dhe i rrjetave të telit të salduara”. [...] kjo shoqëri ka si administrator bashkëshorten e ortakut tim, shtetasen L. B.. [...] gjatë inventarizimit, kam konstatuar se shoqëria “{***}” e ka ushtruar aktivitetin e saj në kundërshtim me ligjin për tatimet dhe Kodin Penal, dhe konkretisht: ka shitur produkte të ndryshme, objekt të veprimtarisë së shoqërisë “{***}” ShPK, në emër të shoqërisë “{***}”, duke shmangur detyrimet tatimore dhe njëkohësisht duke realizuar vjedhje të produkteve të “{***}” ShPK, dhe dërgimin e kësaj shoqërie në gjendje falimenti. Ky fakt vërtetohet me katër blloqe faturash jotatimore, të quajtura “Fletëdalje”. Këto blloqe janë pa numra serie dhe të pamiratuara nga Drejtoria e Tatimeve në Gjirokastër. Në këto katër blloqe, unë kam konstatuar shitje të produkteve të shoqërisë ku unë jam administrator, të cilat kapin vlerën e mbi 20.000.000 lekëve. [...] Gjithashtu dua të sqaroj se administratorja e shoqërisë “{***}”, vjedhjet e mësipërme i ka realizuar në bashkëpunim me bashkëshortin e saj I. B., i cili është dhe ortak i shoqërisë “{***}” ShPK. [...] kërkoj që shtetasja L. B. së bashku me ortakun e shoqërisë “{***}” ShPK të procedohen për veprat penale “Fshehje e të ardhurave”, “Faliment i provokuar” dhe “Vjedhje me anë të mashtrimit”, vepra këto të parashikuara nga nenet 180, 193 dhe 143/3 të Kodit Penal.*

8.5. Me marrjen e këtij kallëzimi, nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër janë kryer veprimet procedurale si vijojnë: janë marrë deklaratimet e shtetasit Gj. B., në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale; janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 4 blloqe “Fletëdalje”, të dorëzuara nga ky shtetas; janë marrë deklaratimet e shtetasit I. B. dhe L. B., në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale; janë marrë deklaratimet e shtetasës L. B.; janë këqyrur dhe janë marrë dokumentet e dorëzuara nga shtetasja L. B.: një fotokopje e QKB-së në emër të subjektit “{***}” dhe fotokopje e certifikatës së pronësisë në emër të shtetasit I. B..

8.6. Këto materiale procedurale i janë përcjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, më

datë 01.10.2019, Prokurorisë Gjirokastër, duke sugjeruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale: “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”, “Faliment i provokuar” dhe “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuara nga nenet 135, 193 dhe 180 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit I. B., i cili është regjistruar në prokurori si kallëzimi penal nr. {***/2019.

8.7. Me vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal” të datës 14.10.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. {***/2019, me arsyetimin se nuk ka elemente të veprës penale, por jemi përpara një marrëdhënieje juridiko-civile. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar: [...] *personat e përfshirë në konflikt disa ditë më parë, kanë punuar së bashku në të njëjtat ambiente që nga viti 2002. Të njëjtin pretendim për të njëjtat vepra penale, të ndodhur në të njëjtat ambiente të shoqërive, ka paraqitur në kallëzimin e tij edhe pala e kallëzuar I. B. dhe bashkëshortja e tij L. B., të trajtuara në kallëzimin penal nr. {***/2019. Kallëzimet penale respektive ndaj këtyre shtetasve, të cilët janë gjini e afërt (atë e bir), ka dyshime se janë bërë si kundërpërgjigje e kallëzimeve të palës tjetër.*

8.8. Në lidhje me shqyrtimin gjyqësor të çështjes penale, nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, konstatohet se pas ankimit të shtetasit Gj. B. ndaj vendimit për mosfillimin e procedimit penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. {***/2020, datë 26.02.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe urdhërimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër të regjistrojë kallëzimin penal me nr. {***/2019, datë 01.10.2019, të ankuesit Gj. B.. Nga përmbajtja e këtij vendimi, vihet re se gjykata ka caktuar disa detyra që duhet të zbatohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, konkretisht ajo urdhërohet të regjistrojë procedimin penal nr. {***/2019 të vitit 2019 për veprat penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, “Falimentimi i provokuar”, parashikuar nga neni 193 i Kodit Penal, “Shpërdorimi i kompetencave”, parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal, “Falsifikimi i nënshkrimeve”, parashikuar nga neni 165 i Kodit Penal, “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal etj., në vlerësim të veprimeve hetimore që do të kryhen. Sipas gjykatës, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër duhet të hetojë në lidhje me kallëzimin penal të shtetasit Gj. B., duke kryer veprimet e nevojshme hetimore, si: *sekuestrimi i provave materiale, siç janë aktet shkresore dhe dokumentet ligjore të shoqërive tregtare, të kryera në kuadër të veprimtarisë tregtare me të tretë, veprimeve tregtare në kuadër të administrimit dhe veprimtarisë përfaqësuese të shoqërive apo çdo dokument tjetër të nevojshëm; të kërkojë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo çdo institucion/agjenci shtetërore; të kërkojë informacion nga bankat e nivelit të dytë; të pyesë administratorët, ortakët, punonjësit e shoqërisë; të marrë vendim për kryerjen e aktit të ekspertimit kontabël apo çdo akti tjetër; si dhe çdo veprim tjetër hetimor që vlerësohet i nevojshëm prej saj.*

8.9. Me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, datë 20.05.2020, prokurori Julian Çafka, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nr. {***/2020, datë 26.02.2020, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, e parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.

8.10. Referuar vërtetimit të datës 7.6.2021, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë⁵⁵, vërtetohet se mbi bazën e kallëzimeve penale të bëra nga shtetasit Gj. B. dhe I. B., Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë ka regjistruar 26 procedime penale, të cilat janë bashkuar në një procedim penal të vetëm, me numër {***} të vitit 2019, i cili gjendet në fazën e hetimeve paraprake dhe hetohet nga prokurori Julian Çafka.

8.11. Referuar vërtetimit të datës 07.09.2021, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë⁵⁶, vërtetohet se me kërkesën e datës 31.08.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, është kërkuar dërgimi në gjyq i çështjes penale nr. {***}, datë 14.10.2019, me të cilën janë bashkuar procedimet e tjera penale⁵⁷, në ngarkim të të pandehurve Gj. B., I. B. dhe L. B. Me çështjen penale nr. {***}, datë 14.10.2019, ndërmjet të tjerave është bashkuar edhe procedimi penal nr. {***} i vitit 2020, i regjistruar në datën 20.05.2020.

8.12. Në përfundim të trajtimit të këtij denoncimi, Komisioni ka vlerësuar se: [...] çështja, objekt hetimi, është pasojë e disa procedimeve të njëpasnjëshme të regjistruara për shkak të kallëzimeve reciproke midis denoncuesit dhe familjarëve të tij, të cilët administrojnë biznese veçmas apo në ortakëri. Gjithsesi, rasti në fjalë, për të cilin subjekti fillimisht ka vendosur mosfillimin e çështjes, nën kontekstin e interpretimit të bërë prej tij se çështja ishte e lidhur me procedimet e mëparshme të cilat ishin regjistruar dhe për to kishte hetime të nisura, duket se nuk qëndron. Kjo për faktin se, përkundër këtij argumenti: (i) duke qenë një çështje që i përkiste një situatë të agravuar kryesisht me procedime nën akuzën e “vjedhjes” dhe “fshehjes së të ardhurave”, akuzat të cilat kërkojnë vëmendje në trajtimin e tyre, regjistrimi i procedimit, mbledhja, administrimi i provave dhe kryerja e hetimeve të nevojshme, duhet të ishin konsideruar si domosdoshmëri në favor të zbardhjes së çështjes. Ky vlerësim i trupit gjykues vjen si rezultat edhe i pasojave të pariparueshme që mund t’i shkaktohen buxhetit të shtetit në rast të provueshmërisë së akuzave. Në këto argumente, minimalisht do të duhej që çështja të ishte regjistruar dhe më tej të ishte vlerësuar bashkimi i saj me procedimet e tjera, duke shtuar në këtë mënyrë morinë e provave në favor të hetimit. Ndër detyrat e lëna nga gjykata në prishjen e vendimit, vërehet se detyra parësore ka qenë regjistrimi i procedimit dhe më tej janë renditur edhe detyrat e tjera. Nuk duket e arsyeshme ngarkesa në punë e pretenduar nga subjekti, në raport me akuzën e ngritur nga kallëzuesi. Nga ana tjetër, detyrat e lëna nga gjykata u përkasin disa veprimeve të rëndësishme hetimore për t’u kryer, të cilat kanë kërkuar padyshim kohën e nevojshme për t’u përmbushur.

8.13. Nga analiza e veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, konstatohet se vendimmarrja e tij për mosfillimin e procedimit penal, është bazuar vetëm në

⁵⁵ Nënshkruar nga zv/drejtuesi i Prokurorisë Gjirokastrë E. K. dhe për Zyrën e Regjistrimit nga sekretarja A. Sh..

⁵⁶ Nënshkruar nga zv/drejtuesi i Prokurorisë Gjirokastrë E. K.

⁵⁷ Procedimet penale nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***} të vitit 2019; nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***} të vitit 2020; dhe nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***}, nr. {***} të vitit 2021.

materialet procedurale të përcjella nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, pa u kryer verifikime të mëtejshme nga ana e subjektit të rivlerësimit. Kjo veprimtari është gjetur e mangët dhe e paplotë nga kontrolli gjyqësor i Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, e cila e ka urdhëruar subjektin e rivlerësimit të regjistrojë procedimin penal duke i caktuar detyra konkrete, të cilat janë ndër veprimet bazë të prokurorit në verifikimin e veprave penale të referuara nga kallëzuesi. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka vepruar më pas me regjistrimin e procedimit penal, dhe në funksion të hetimit të çështjes ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër lidhur me fletëdaljet e sekuestruara të subjekti “{***}” ShPK, ku më pas ka disponuar me dërgimin e çështjes në gjykim në ngarkim të të pandehurve, vlerësohet se ai që në fillim duhet të kishte kryer hetime për blloqet e paraqitura nga kallëzuesi në cilësinë e provës materiale që me kallëzimin e tij.

8.14. Në lidhje me aktin që pasqyron hedhjen e shortit për materialet e kallëzimit penal nr. {***} të vitit i 2019, nga aktet e vëna në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, rezulton vetëm një fletë printim nga sistemi, në të cilin referohen të dhëna mbi kallëzimin penal nr. {***}, të referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, më datë 1.10.2019, ku në rubrikën “Emri i prokurorit”, evidentohet emri i prokurorit E. K., dhe jo ai i subjektit të rivlerësimit, ndërkohë nuk evidentohen akte të tjera se si ka kaluar kjo çështje të subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, është i pabesueshëm pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kjo çështje është shpërndarë në përputhje me përcaktimet e nenit 53⁵⁸ të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, për më tepër që në rolin e drejtuesit të prokurorisë ka pasur detyrimin ligjor për të drejtuar dhe mbikëqyrur procesin e shpërndarjes së çështjeve. Gjithashtu, duket një arsye jo e qenësishme, edhe për sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, se çështja i ka kaluar atij për shkak se prokurori E. K. kishte hequr dorë nga çështja pasi kallëzuesi i saj ishte shtetasi A. Ll., me të cilin ai kishte pasur edhe dorëheqje të mëparshme, për sa kohë në aktet e dosjes nuk ka as kërkesë për heqjen dorë të tij dhe as vendim të drejtuesit të prokurorisë për pranimin e saj. Ndërkohë, referuar të dhënave të paraqitura në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me ngarkesën e punës, krahasuar me të dhënat sipas raporteve të Prokurorit të Përgjithshëm mbi ngarkesën e prokurorive të shkallës së parë, rezulton se për vitin 2019, ngarkesa e tij ka qenë më e ulët se mesatarja e ngarkesës për prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër.

8.15. Në përfundim të analizës së pretendimeve të denoncuesit lidhur me materialin kallëzues nr. {***} të vitit 2019, unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se mungesa e veprimeve hetimore që ka çuar

⁵⁸ Në nenin 53 përcaktohet se: “1. Prokurori i Përgjithshëm përcakton rregulla të detajuara për: a) procedurat e shpërndarjes së çështjeve, të cilat sigurojnë transparencë dhe mundësi të mjaftueshme verifikimi; b) kriteret për shpërndarjen e çështjeve, bazuar në ngarkesën e çështjeve dhe specializimin e prokurorëve; c) rastet dhe kriteret për rishpërndarjen e çështjeve; ç) mënyrën e monitorimit dhe dokumentimit të tyre. 2. Rregullat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, parashikojnë që çështja t’i caktohet paraprkisht të paktën tre prokurorëve, ndërsa caktimi përfundimtar të kryhet me short, në mënyrë elektronike. 3. Drejtuesi drejton dhe mbikëqyr procesin e shpërndarjes së çështjeve, bazuar në rregullat e miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm”.

në vendimin për mosfillimin e procedimit penal dhe procedura jo e rregullt e caktimit të çështjes për ndjekje nga subjekti i rivlerësimit, afektojnë kriterin e aftësive profesionale sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pikat 2 dhe 3, si dhe në nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

9. Mbi gjetjet e Komisionit në lidhje me procedimin penal nr. {*} të vitit 2018, që i përket denoncueses M. Sh.:**

9.1. Nga verifikimi i akteve të procedimit penal nr. {***}, datë 16.07.2018, të administruara në fashikullin e Komisionit, konstatohet se:

9.2. Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.07.2018, i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër materialet procedurale për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal dhe “Largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal, si vijojnë: (i) informacion “Për referimin e veprës penale te Prokurori”, datë 13.07.2018, i oficerit të policisë gjyqësore K. M., në të cilin referohet se: *Më datë 12.07.2018, rreth orës 12:00, jam njoftuar nga Salla Operative e Drejtorisë Vendore Gjirokastër se në Spitalin Rajonal Gjirokastër, është paraqitur një shtetase për ndihmë mjekësore, e cila pretendon se është goditur nga një automjet. Menjëherë shkoi në spital punonjësi i policisë rrugore për të kontaktuar me shtetasen e dëmtuar, e cila ishte L. Sh. [...], e cila deklaroi se një automjet i paidentifikuar, me drejtim lëvizjeje nga rrethrotullimi “{***}” për tek {***}, në vendin e quajtur para lokalit të shtetases Z. Ç., e kishte goditur me pasqyrë në krah; (ii) procesverbal “Për marrjen e të dhënave ndaj personit që ka dijeni për veprën penale”, datë 12.07.2018, i shtetases së dëmtuar L. Sh., sipas së cilës shoferi i automjetit e kishte pyetur 2-3 herë për gjendjen shëndetësore dhe i kishte ofruar ndihmë për në spital, por ajo ishte përgjigjur se nuk kishte nevojë për ndihmë, ndërkohë që nuk i kujtohej automjeti që i kishte sjellë dëmtime në bërrylin e krahut të djathtë; (iii) procesverbal “Për marrjen e të dhënave ndaj personit që ka dijeni për veprën penale”, datë 12.07.2018, i shtetases S. C. (motra e së dëmtuarës), sipas së cilës, ajo kishte qenë së bashku me motrën e saj kur kishte ndodhur aksidenti dhe se shoferi ishte afruar dhe kishte ofruar ndihmë, por motra e saj nuk kishte pranuar, duke u përgjigjur se nuk kishte nevojë; (iv) aktdëshmi mjeko-ligjore nr. {***}, datë 12.07.2018, nga ku rezulton se nga ekzaminimi i kryer kësaj shtetaseje në urgjencën e spitalit në datën 12.07.2018, ora 11:40, pas mjekimit, gjendja e saj paraqitej e përmirësuar dhe se dëmtimet hyjnë në kategorinë e atyre që sjellin humbje të aftësisë deri në 9 (nëntë) ditë.*

9.3. Më datë 16.07.2018, prokurori Juljan Çafka ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal. Në kuadër të hetimit të çështjes, janë ndërmarrë veprimet hetimore si vijojnë: (i) referuar vendimeve “Për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve filmike”, të datave 24.07.2018 dhe 31.07.2018, është vendosur të këqyren dhe të merren pamjet filmike që ndodhen në serverat (DVR) në ABI Bank ShA, në Zyrën Postare të filialit Gjirokastër, në firmën private “{***}” dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë

Gjirokastrë, të ndodhura në lagjen “{***}”, Gjirokastrë, për datën 12.07.2018, në orarin 11:30 - 12:30, veprime të cilat duhet të kryhen brenda datës 30.07.2018; (ii) referuar procesverbalit “Për këqyrjen dhe marrjen e provave materiale” të datës 01.08.2018, janë administruar pamjet filmike në orarin 11:30 - 12:30 të filialit Posta Shqiptare Gjirokastrë. Ndërsa ABI Bank ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.12.2018, ka informuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë se nuk disponohen pamje filmike të regjistruara për vitin 2018.

9.4. Me urdhrin e datës 03.09.2018, për delegimin e veprimeve hetimore, është urdhëruar kryerja e veprimeve si vijojnë: të administrohet akti i ekspertimit mjeko-ligjor për shtetasen L. Sh.; të merren pamjet filmike të ambienteve përreth vendit ku ka ndodhur aksidenti; pas marrjes së pamjeve filmike, të këqyren ato me qëllim identifikimin e mjetit dhe të drejtuesit të tij; të kryhet ekspertim autoteknik për të përcaktuar shkakun e aksidentit; të pyetet si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, personi që do të identifikohet si drejtues i mjetit që shkaktoi aksidentin; të pyetet si person që ka dijeni për veprën penale, shtetasja Z. Ç.; të administrohet certifikata personale dhe ajo e gjendjes gjyqësore të të dyshuarit; të kryhen veprime të tjera që do të dalin gjatë hetimeve, këto veprime të kryhen brenda datës 30.10.2018.

9.5. Në zbatim të këtij urdhri, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë: në datën 09.10.2018, janë marrë deklaratimet e shtetasës M. Sh., vajza e shtetasës L. Sh.; në datën 17.10.2018, janë marrë deklaratimet e shtetasit B. F.; në datën 22.10.2018, janë marrë deklaratimet e shtetasit A. Ç., i cili ushtron profesionin e berberit në një lokal pranë vendit të aksidentit; janë marrë deklaratimet e shtetasit K. M., me profesion specialist i Policisë Rrugore; në datën 18.10.2018, janë marrë deklaratimet e shtetasit A. B., me profesion shitës ambulant në një lokal pranë vendit të aksidentit; në datën 14.12.2018, janë marrë deklaratimet e shtetasit D. M., punonjës i Policisë Rrugore; në datën 03.01.2019, janë marrë deklaratimet e shtetasit E. Xh., përdorues i një automjeti “Mercedes Benz”; në datën 19.12.2018, janë ballafaquar shtetasit M. Sh., vajza e së aksidentuarës, dhe K. M., punonjës policie; në datën 03.01.2019, janë ballafaquar shtetasit M. Sh. dhe A. Ç., me profesion berber; në datën 13.12.2018, është këqyruar dhe është marrë në cilësinë e provës {***} në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë, ku evidentohet njoftimi i orës 11:43 nga Urgjenca e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

9.6. Në përfundim të veprimeve hetimore të kryera, më datë 10.07.2019, nga prokurori çështjes, është vendosur pezullimi i këtij procedimi me arsyetimin se: *Nga studimi i materialeve të administruara në këtë procedim penal, nuk rezulton se mbetet të kryhet ndonjë veprim tjetër hetimor nga ana jonë, ndonëse nuk është zbuluar autori i kryerjes së veprës penale “Largimi nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal e, për rrjedhojë, çështja penale duhet të pezullohet.*

9.7. Pas ankimit të shtetasës L. Sh., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. {***}, datë 10.09.2019, ka vendosur pranimin e ankimit të palës ankuese, prishjen e vendimit, datë 10.07.2019, të Prokurorisë, për pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}/2018 dhe

rifillimin e hetimeve. Referuar pjesës arsyetuese të këtij vendimi, gjykata i ka gjetur pjesërisht të gabuar dhe jo saktësisht të zbatuar urdhrat e datave 24.07.2018 dhe 31.07.2018 të Prokurorisë, për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve filmike që ndodhen në serverat (DVR) të ABI Bank ShA, firmës private “{***}”, Postës Shqiptare, filiali Gjirokastër dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, për disa arsye: (i) intervali kohor i cilësuar në to nuk ka asnjë interes për hetimin, sepse i përket kohës rreth 10 -15 minuta pas ndodhjes së aksidentit; (ii) përveç procesverbalit për marrjen e pamjeve filmike nga Posta Shqiptare më datë 01.08.2018, i cili edhe në këtë rast është pa një rezultat, nuk gjenden në dosje procesverbale për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve sipas urdhërimit të prokurorit; (iii) nuk rezulton që veprimet e kërkuara të jenë kryer në afatin e përcaktuar nga prokurori, datë 30.07.2018; (iv) nuk është zbatuar plotësisht urdhri i datës 03.09.2018, për marrjen e pamjeve filmike të ambienteve përreth vendit ku ka ndodhur aksidenti, si: pamjet e ADISA-s apo NBG Bank ShA, pyetjen e shtetases Z. Ç. apo veprime të tjera që duhet të kryheshin brenda datës 30.10.2018, të cilat jo vetëm brenda kësaj date por nuk janë kryer asnjëherë. Gjkata ka lënë si detyrë që gjatë rihetimit të merren pamjet filmike të datës 12.07.2018, ora 11:00 - 11:30, që ndodhen në serverat e ABI Bank ShA, Dega Gjirokastër, Posta Shqiptare, filiali i lagjes “{***}”, Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, dyqaneve të shtetases Z. Ç.; të ripyeten shtetasit A. Ç., A. B., B. F., K. M.; të pyetet shtetasja Z. Ç., si dhe punonjësit e sigurisë së Postës Shqiptare, ABI Bank ShA dhe ADISA-s, që kanë qenë në shërbim në këto institucione në datën 12.07.2018, ora 11:00 - 11:30, si dhe të identifikohet e të pyetet si person që ka dijeni për ngjarjen, lustraxhiu që punon përpara dyqaneve të shtetases Z. Ç.⁵⁹.

9.8. Në zbatim të detyrave të lëna nga Gjkata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, prokurori Juljan Çafka ka ndërmarrë veprimet si vijojnë: (i) në datat 06.12.2019 dhe 19.02.2020, është kërkuar përkatësisht nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër dhe ABI Bank ShA informacion mbi gjeneralitetet e punonjësve të sigurisë së këtyre institucioneve, që kanë qenë në shërbim në datën 12.07.2019, nga ora 11:00 deri në orën 12:00; (ii) në datë 06.12.2019, është kërkuar nga ABI Bank ShA, Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër dhe Posta Shqiptare marrja e pamjeve filmike të ambientit të jashtëm të këtyre institucioneve të datës 12.07.2018, ora 11:00 - 11:30 dhe, për Postën Shqiptare, janë kërkuar me të njëjtën shkresë edhe gjeneralitetet e punonjësit të sigurisë në datën, 12.07.2018 në orën 11:00 - 12:00. Në përgjigje të këtyre kërkesave, këto institucione kanë informuar si vijon: më datë 11.12.2019 dhe 04.03.2020, ABI Bank ShA ka informuar se nuk disponohen pamje filmike të regjistruara për vitin 2018, ndërsa mbi gjeneralitetet e punonjësit të sigurisë, ka informuar se më datë 12.07.2019, ka qenë me shërbim pranë saj z. A. Y.. *Nga kjo përgjigje, konstatohet se është kthyer përgjigje për punonjësën e sigurisë në detyrë një vit më pas nga ndodhja e aksidentit dhe jo në datën e aksidentit, pra më datë 12.07.2018; më datë 11.06.2020, Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër ka informuar Prokurorinë mbi gjeneralitetet e punonjësit të policisë në shërbim në datën 12.07.2018, i cili ka qenë inspektor T. Z., ndërkohë që sa u takon pamjeve filmike, informohet se kamera është vendosur në hyrjen e drejtorisë, te dera kryesore, dhe*

⁵⁹ Nuk është caktuar ndonjë afat nga gjykata për kryerjen e këtyre veprimeve.

një pjesë e vogël e saj drejtohet nga bulevardi, por që për shkak të kapacitetit të diskut, nuk disponohen pamje të vitit i 2018; më datë 09.07.2020, nga ADISA, informohet se nuk disponohet informacion mbi punonjësin e sigurisë i cili ka qenë në shërbim në datën 12.07.2018, nga ora 11:00 - 12:00, pasi ky shërbim për këtë institucion mbulohet nga shoqëria “{***}”, duke përcjellë edhe kontratën e shërbimit mes këtyre dy institucioneve; më datë 13.12.2019, Posta Shqiptare ka informuar Prokurorinë mbi gjeneralitetet e punonjësit të sigurisë në datën 12.07.2018, nga ora 11:00 - 12:00, i cili ka qenë A. T., ndërsa sa u takon pamjeve filmike, informohet se për shkak të kalimit të një kohe të gjatë, nuk disponohen pamje filmike të datës 12.07.2018; (iii) referuar procesverbaleve për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, janë marrë deklaratimet si vijojnë: më datë 05.06.2020, deklaratimet e shtetasve Z. Ç., A. Ç., B. F., A. B.; më datë 07.07.2020, deklaratimet e shtetasit A. I., roje sigurie tek ABI Bank ShA; më datë 05.08.2020, deklaratimet e shtetasit P. L., punonjës i sigurisë fizike të shoqërisë “{***}”; më datë 14.02.2020, deklaratimet e shtetasit A. T., punonjës sigurie pranë Postës Shqiptare; më datë 19.02.2020, deklaratimet e shtetasit S. D., punonjës sigurie pranë Postës Shqiptare; më datë 17.02.2020, deklaratimet e shtetasit E. C., i cili punon si lustraxhi pranë vendit të aksidentit; më datë 28.2.2020, deklaratimet e shtetasit K. M.; më datë 26.05.2020, deklaratimet e shtetasit T. Z., punonjës sigurie pranë Postës Shqiptare.

9.9. Me vendimin e datës 07.08.2020, prokurori Juljan Çafka ka vendosur pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2018, me arsyetimin se: *Nga studimi i materialeve të administruara në këtë procedim penal, nuk rezulton se mbetet të kryhet ndonjë veprim tjetër hetimor nga ana jonë, ndonëse nuk është zbuluar autori i kryerjes së veprës penale “Largimi nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal e, për rrjedhojë, çështja penale duhet të pezullohet.*

9.10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin {***}, datë 09.10.2020, ka vendosur rrezimin e ankimit të ankueses L. Sh. dhe se ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim. Referuar pjesës arsyetuese të këtij vendimi, gjykata ka vlerësuar se nga ana e prokurorisë, janë kryer të gjitha veprimet procedurale dhe, për sa kohë nuk është bërë e mundur gjetja e autorit, prokurori me të drejtë ka vendosur pezullimin e procedimit penal.

9.11. Në përfundim të shqyrtimit të denoncimit të shtetasës M. Sh. dhe akteve të dosjes së procedimit penal nr. {***} të vitit 2018, Komisioni në mënyrë të përmbledhur ka vlerësuar se: i) subjekti i rivlerësimit, pasi ka urdhëruar në datën 03.09.2018, delegimin e disa veprimeve hetimore, nuk e ka ndjekur në vijimësi kryerjen e tyre; (ii) intervali kohor për kërkimin e pamjeve filmike të vendit të aksidentit, nuk duhet t’i ishte referuar orës 12:00, si orë e përafërt e ndodhjes së aksidentit, por mund t’i referohej orarit të pasqyruar në dëshminë mjeko-ligjore nr. {***}, datë 12.7.2018, të Institutit të Mjekësisë Ligjore. Sipas Komisionit, referenca e gabuar e orarit ka krijuar vështirësi në kryerjen e detyrave të lëna nga gjykata pas kthimit të çështjes për shkak të kalimit të afatit dymujor të ruajtjes së tyre; (iii) subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota lidhur me çështjen, pasi nuk është pyetur shtetasja Z. Ç. dhe se çështja është pezulluar pas një viti nga

regjistrimi i procedimit penal, dhe pa prituri përgjigjet e pamjeve filmike të disa institucioneve, si: ABI Bank ShA, Drejtoria Vendore e Policisë Gjyrokastër dhe firma private “{***}”.

9.12. Nga analiza e veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh paraprake hetimore për zbardhjen e çështjes, por që rezultojnë të kenë qenë joefektive dhe të paplota. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se pasaktësia në orën e kërkimit të pamjeve është urdhëruar në mirëbesim sipas referimit të policisë, nuk e shmang atë nga përgjegjësia për të analizuar të gjitha materialet procedurale të dërguara nga Drejtoria e Policisë, si p.sh., dëshmia mjeko-ligjore ku referohej një orar i ndryshëm, i cili mund të orientonte më shumë mbi orarin e saktë të aksidentit. Veprimtaria e pamjaftueshme hetimore dhe pa efikasitet konfirmohet edhe nga qëndrimi i gjykatës që ka kontrolluar veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit, përmes caktimit të detyrave konkrete, si: *të merren pamjet filmike të datës 12.07.2018, ora 11:00 - 11:30, që ndodhen në serverat e ABI Bank ShA, dega Gjyrokastër, Posta Shqiptare, filiali i lagjes “{***}”, Drejtorisë Vendore të Policisë Gjyrokastër, dyqaneve të shtetases Z. Ç.; të ripyeten shtetasit A. Ç., A. B., B. F., K. M.; të pyetet shtetasja Z. Ç., si dhe punonjësit e sigurisë së Postës Shqiptare, ABI Bank ShA dhe ADISA-s, që kanë qenë në shërbim në këto institucione në datën 12.07.2018, ora 11:00 - 11:30, si dhe të identifikohet e të pyetet si person që ka dijeni për ngjarjen, lustraxhiu që punon përpara dyqaneve të shtetases Z. Ç..* Nga këto detyra, vihet re se gjykata ka udhëzuar organin e prokurorisë që informacioni të merret në një orar të ndryshëm nga ai që ishte kërkuar nga prokurori i çështjes. Ndonëse subjekti i rivlerësimit ka vepruar më pas, duke i kryer detyrat e caktuara si detyrë nga gjykata, vonesa e kërkimit në kohë të pamjeve filmike në orarin e caktuar, solli pamundësinë e administrimit si provë të pamjeve filmike të vitit 2018, pasi ato nuk disponoheshin më nga institucionet në fund të vitit 2019 dhe fillim i vitit 2020, duke passjellë moszbulimin e autorit të veprës penale dhe pezullimin e çështjes.

9.13. Në përfundim të analizës së mësipërme, unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se mungesa e një veprimtarie të plotë hetimore dhe kryerja e saj në mënyrë joefektive, e konfirmuar nga kontrolli gjyqësor, afekton kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale sipas nënindikatorëve të parashikuar prej nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

10. Lidhur me të gjitha rastet e analizuara më sipër, çmoj se subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka, me veprimet dhe mosveprimet e tij, si prokuror, ka cenuar dukshëm kërkesat e ligjit, duke i shkelur haptazi ato, lidhur me zbatimin e detyrave të caktuara me ligj për prokurorin, gjë e cila afekton kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale sipas nënindikatorëve të parashikuar nga neni 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
11. Në vlerësimin tim, konkluzioni i shumicës së trupit gjykues është i pambështetur në faktet e provuara përgjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes dhe në legjislacionin e zbatueshëm, e për këto

arsye, jam kundër vendimmarrjes së tyre. Pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, e vlerësoj të gabuar, pasi problematikat e konstatuara për këtë subjekt rivlerësimi, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, nuk janë të asaj natyre që mund të ndreqen nga Shkolla e Magjistraturës. Për sa më sipër, vlerësoj se shumica e trupit gjykues duhet të kishte disponuar me ndryshimin e vendimit nr. 442, datë 14.09.2021, të Komisionit dhe shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi